



**Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë**

Contact: *Tel/fax:* + 355 4 2245078; *Mob.* + 355(0)692469393; (0)682039297;
E-mail: info@zgjedhie.al; *Website:* www.zgjedhie.al;

ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

21 QERSHOR 2015

**RAPORT I NDËRMJETËM
MONITORIMI II**

27 Mars – 21 Maj 2015

Tiranë, më 4 Qershor 2015

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë falënderon:

Programin e Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci pranë Ambasadës së SHBA-së në Tiranë dhe Agjencinë Austriake për Zhvillim për mbështetjen financiare të ofruar,

si dhe të gjithë aktivistët e të 33 organizatave të Koalicionit për kontributin e tyre vullnetar në realizimin e objektivave të monitorimit përgjatë periudhës që përfshihet në këtë Raport.

Mendimet e shprehura në këtë raport janë të KVV-së dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht edhe ato të donatorëve!

PËRMBAJTJA

	<i>Faqe</i>
I. Përmbledhje ekzekutive	5
II. Konstatime	7
A. Situata politike	7
B. Kuadri ligjor	9
C. Administrimi i zgjedhjeve	15
C.1. Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	15
C.2. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor	24
C.3. Komisionet e Qendrave të Votimit Zgjedhor	30
C.4. Vendet dhe Grupet e Numërimit të Votave	31
D. Institucione të tjera të angazhuara në ndërtimin e procesit zgjedhor	33
D.1. Kuvendi i Shqipërisë	33
D.2. Ministria e Punëve të Brendshme	34
D.3. Njësitë e Qeverisjes Vendore	35
E. Listat e zgjedhësve	36
F. Regjistrimi i subjekteve politike dhe i kandidatëve	41
G. Fushata e parakohshme zgjedhore	45
H. Media	49
K. Pjesëmarrja e grave	54
L. Vëzhguesit dhe e drejta për informim	56
M. Ankesa dhe apeline	62
III. Rekomandime	65

	<i>Faqe</i>
IV. Aksioni i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë	68
V. Fjalorth	68
SHTOJCA	69
Shtojca 1: Deklaratë - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mungesë transparence dhe ndryshime të paligjshme të akteve të miratuara më parë! – dt. 16.04.2015	70
Shtojca 2: Deklaratë - Realizimi i standardeve për ecurinë e procesit zgjedhor në periudhën e mbetur deri ditën e zgjedhjeve, kërkon kontributin e të gjithë aktorëve institucionalë si edhe të vetë subjekteve elektorale! – dt. 06.05.2015.	73

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Pavarësisht vullnetit të shprehur nëpërmjet Rezolutës së Dhjetorit 2014¹, ngritjes së Komisionit Parlamentar Ad-Hoc dhe angazhimit përpara qytetarëve e partnerëve ndërkombëtarë për bashkëpunim, *de facto* vullneti politik, komunikimi mes forcave politike dhe, si rrjedhojë, konsensusi i nevojshëm për ndërmarrjen e ndryshimeve të duhura dhe të rëndësishme ligjore ka munguar dhe vazhdon të mungojë².
- Në thelb, angazhimi i partive politike për dekriminalizimin e politikës deri në këtë moment është karakterizuar nga retorikë politike dhe iniciativa të cinguara, ndërmarrë nga opozita apo maxhoranca më vete. Fryma e dialogut dhe konsensusit për këtë çështje vazhdon të mungojë, ashtu siç kanë munguar iniciativa konkrete dhe serioze që të mundësojnë këtë proces kaq të rëndësishëm për shoqërinë shqiptare, ndërkohë që maxhoranca dhe opozita vazhdojnë të akuzohen respektivisht për mungesë vullneti dhe bllokim të procesit.
- Mosadresimi nga Parlamenti i Shqipërisë i të gjitha çështjeve që preken si pasojë e reformës administrativo-territoriale, siç ishte e drejta e kandidimit të të zgjedhurve aktuale, dhe lënia e kësaj çështjeje për tu zgjidhur nga KQZ-ja, e cila nga ana tjetër nuk arriti të kishte deri në fund një qëndrim ligjor, por u shtrëngua të zbardhte në mënyrë të paligjshme vendimin e vet, e futi procesin e kandidimit në një impas, i cili afektoi ndjeshëm të drejtën e të zgjedhurve aktualë për të kandiduar.
- Moszbardhja e vendimeve në kohë prej Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve është një element kyç për efektet që passjell dhe mosrespektimi i këtij detyrimi në mënyrë të vazhdueshme dhe të pajustificuar ka krijuar artificialisht çoroditje të procesit.
- Pabarazia para ligjit në gjykimet e ndryshme të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për dy çështje të ngjashme prek parimin e barazisë së normës përpara subjekteve apo çështjeve të ndryshme.
- Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor si struktura që nuk “ruajnë gjurmë” në punën e tyre, me problematika nga më të ndryshmet, deri tek mosfunksionimi në orar zyrtar, penalizon operatorët elektoralë sepse nuk arrijnë të shfrytëzojnë të drejtat që iu jep Kodi Zgjedhor dhe as nuk mund të bëjnë ankimim më tutje.

¹ Kuvendi i Shqipërisë (2014). Rezolutë e marrëveshjes politike mes maxhorancës qeverisëse dhe opozitës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. http://www.parlament.al/web/24_Dhjetor_2014_Rezolute_e_marreveshjes_politike_mes_mazhorances_qeverisese_dhe_opozites_18933_1.php.

² Më 14 prill 2015 Komisioni i Jashtëm të Parlamentit Europian miratoi amendamentet e draft-rezolutës së raportuesit Fleckenstein për Shqipërisë. Një nga shqetësimet e ngritur prej Fleckenstein gjatë prezantimit të raportit ishte tensioni dhe konfliktualiteti politik në vend. Për më shumë shih: <http://www.europarl.europa.eu/news/en/news-room/content/20150413IPR41661/html/Albania-and-Bosnia-Herzegovina-political-commitment-is-key-to-path-to-wards-EU>.

- Megjithëse institucion i ngarkuar nga ligji, për menaxhimin e procesit zgjedhor, KQZ ka patur një rol jo aktiv në procesin e monitorimit të hartimit të listave. Megjithatë KVV përgëzon vullnetin e shprehur prej këtij institucioni, në përmbushje të detyrimit që i njej ligji, për t'ia kaluar çështjen e lëvizjeve të dyshimta në listat e zgjedhësve organit të prokurorisë, pas raportimit të njërit prej auditëve teknikienë.
- Publikimi i listës finale të zgjedhësve u shoqërua edhe me problematika që kanë të bëjnë me mospërfshirjen në to të të gjithë të personave që vuajnë dënimin në institucionet e ekzekutimit të veprave penale.
- Fushata zgjedhore ka filluar prej të gjitha partive kryesore, në shkelje të plotë të afatit ligjor të parashikuar për fillimin e saj.
- Është vënë re ndjeshëm gjatë kësaj fushate të parakohshme përdorimi i burimeve publike, dhe i aktiviteteve të maxhorancës, si inaugurime etj., në favor të kandidatëve të saj.
- Megjithë publikimet në media të indicieve për forma të blerjes se votave nuk ka asnjë investim nga prokuroria, dhe asnjë organ tjetër, për të verifikuar dhe zbardhur deri në fund këto raste, të cilat rrisin në mënyrë artificiale tensionin si dhe ulin besimin e qytetarëve në proces.
- Pjesa më e madhe e mediave vazhdojnë të pasqyrojnë në mënyrë të pakuptimtë materialet e fabrikuara dhe të përgatitura nga partitë politike, dhe konkretisht jo vetëm filmime, por edhe zërin shoqëruës, përgjatë shfaqjes së kasetave.
- Partitë politike po bëjnë një fushatë të kushtueshme, duke përdorur gjerësisht median dhe transmetimin televiziv me regji qëndrore private, duke prekur një sërë principesh mbi objektivitetin dhe vërtetësinë e pasqyrimin të informacioneve për publikun e gjerë.
- Është për tu përhëndetur respektimi i kriterit gjinor në lista për anëtarët e këshillave të bashkive, megjithatë vihet re vetëm një numër i kufizuar kandidatësh për kryetare bashkie.
- Institucionet e administrimit zgjedhor, megjithë përmirësimet në performancën e tyre, kanë ende për të bërë për të ofruar një profesionalizëm sa më ta lartë të administratës dhe transparencë të plotë të procesit zgjedhor.
- Kolegji Zgjedhor, në vendimmarrjen përgjatë kësaj periudhe, rezulton se aplikon arsyetim jo të saktë dhe standard të dyfishtë në trajtimin e çështjeve të paraqitura.

II. KONSTATIME

A. SITUATA POLITIKE

Situata e konfliktualitetit politik në vend u përshkallëzua ndjeshëm pas akuzave publike të deputetit Tom Doshi në fund të muajit shkurt për një plan për eliminimin fizik të tij dhe të deputetit Mhill Fufi nga Kryetari i Parlamentit. Këto akuza, të cilat përfshinin zyrtarë në pozicionet më të larta të legjislativit, ekzekutivit dhe të organit të akuzës si të përsëritë drejtpërdrejt apo në dijëni të komplotit për eliminimin e tij fizik u përdorën nga opozita si shkak për të kërkuar publikisht dorëheqjen e Kryetarit të Kuvendit, Ministrit të Brendshëm dhe nxjerrjen e përgjegjësive.

Kjo solli një bojkotim de facto të punimeve të Kuvendit nga opozita pavarësisht deklaratave se Kuvendi nuk do të bojkotohej dhe protesta në qytetet të ndryshme të vendit, përfshi Tiranën.

Rikthim i opozitës në parlament në fund të dhjetorit 2014 dhe rinisja e komunikimit maxhorancë – opozitë u bë i mundur pas negociatave intensive nga të dërguarit e Parlamentit European dhe u kushtëzua me miratimin e një Rezolute, e cila në thelb përmban detyrime morale, politike e ligjore, një prej të cilave ishte angazhimi për të punuar së bashku me konsensus, me ndihmën e Bashkimit European, për çështjen e individëve me rekorde kriminale, të cilët mbajnë një post publik ose kërkojnë të zgjidhen apo të emërohen në një të tillë, bazuar në standardet europiane dhe me asistencën e Komisionit të Venecias³.

Me qëllim përmbushjen e marrëveshjes ndërmjet opozitës dhe maxhorancës u ngrit dhe një Komision Parlamentar Ad Hoc, Komisioni për Rezolutën për Marrëveshjen Maxhorancë-Opozitë, i cili ka kryer vetëm katër mbledhje gjatë periudhës 25 shkurt 15 prill 2015 gjatë të cilave ka marrë vetëm dy vendime⁴.

Pavarësisht vullnetit të shprehur nëpërmjet Rezolutës së sipërpërmendur, ngritjes së Komisionit Parlamentar Ad-Hoc dhe angazhimit përpara qytetarëve e partnerëve ndërkombëtarë për bashkëpunim, *de facto* ky vullnet politik, komunikimi mes forcave politike dhe, si rrjedhojë, konsensusi i nevojshëm për ndërmarrjen e ndryshimeve të duhura dhe të rëndësishme ligjore ka munguar dhe vazhdon të mungojë⁵.

Në thelb, angazhimi i partive politike për dekriminalizimin e politikës deri në këtë moment është karakterizuar nga retorikë politike dhe iniciativa të cinguara, ndërmarrë nga opozita apo maxhoranca më vete. Fryma e dialogut dhe konsensusit për këtë çështje

³ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2014). *Rezolutë e marrëveshjes politike mes mazhorancës qeverisëse dhe opozitës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, 24 Dhjetor 2014*. Për më shumë tek: http://www.parlament.al/web/pub/rezoluta_e_marreveshjesmazhorance_opozite_dt_24_12_2014_20557_1.pdf

⁴ I pari për caktimin e Sekretarit të Komisionit dhe I dyti për miratimin e planit të punës. Për më shumë shih: http://www.parlament.al/web/Komisioni_per_zbatimin_e_Rezolutes_per_Marreveshjen_Maxhorance_Opozite_19309_1.php.

⁵ Më 14 prill 2015 Komisioni i Jashtëm të Parlamentit European miratoi amendamentet e draft-rezolutës së raportuesit Fleckenstein për Shqipërisë. Një nga shqetësimet e ngritur prej Fleckenstein gjatë prezantimit të raportit ishte tensioni dhe konfliktualiteti politik në vend. Për më shumë shih: <http://www.europarl.europa.eu/news/en/news-room/content/20150413IPR41661/html/Albania-and-Bosnia-Herzegovina-political-commitment-is-key-to-path-towards-EU>.

vazhdon të mungojë ashtu siç kanë munguar iniciativa konkrete dhe serioze që të mundësojnë këtë proces kaq të rëndësishëm për shoqërinë shqiptare, ndërkohë që maxhoranca dhe opozita vazhdojnë të akuzohen respektivisht për mungesë vullneti dhe bllokim të këtij procesi⁶.

Kjo klimë tensioni dhe mungese konsensusi shpuri gjithashtu në vonesa me jo pak kosto për zhvillimet në tërësi e veçanërisht për ndërmarrjen e rregullimeve të rëndësishme ligjore si: amendimi i Kodit Zgjedhor, së paku, përse ai afektohet nga miratimi i ligjit të ri të ndarjes administrativo-territoriale, apo miratimi i ndryshimeve të nevojshme të ligjit për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, i cili do të bëjë minimalisht funksional qeverisjen e re vendore pas zgjedhjeve të 21 qershorit. Por që sërish ngelet problematike për miratimin e domosdoshëm të reformave ligjore që t'i japin funksionalitet të plotë bashkive të reja në spektrin e përgjegjësive, kompetencave dhe transferimit të detyrimeve nga njësitë aktuale në ato të reja.

Ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor u kryen përtej të gjitha afateve ligjore dhe u kufizuan vetëm në amendime që kishin të bënin me kuotat gjinore dhe në ndryshime teknike të cilat ishin të domosdoshme për sa i përket afektimit të Kodit Zgjedhor nga reforma territoriale-administrative

Vlen të theksohet se ndryshimet në lidhje me barazinë gjinore të votuara nga Kuvendi i Shqipërisë në datë 2 prill 2015, pavarësisht se meritojnë të përgëzohen për vullnetin e shprehur për rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, u kryen vetëm një muaj përpara afatit të fundit për paraqitjen e listave shumëemërore të partive politike, çka mund të kishte krijuar premisat për përjashtimin nga gara të subjekteve zgjedhore të cilat mund të mos kishin mundësi të plotësonin kriteret në një afat kaq të shkurtër. Një ndryshim i tillë thelbësor në ligjin zgjedhor kaq pranë ditës së zgjedhjeve është në kundërshtim me çka rekomandon Kodi i Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore i Komisionit të Venecias.

Një problem i mprehtë për demokracinë shqiptare është edhe mungesa e demokracisë së brendshme e partive, çka pasqyrohet në monopolizimin e listave të kandidatëve, qoftë për zgjedhjet parlamentare qoftë për ato lokale (listat për kandidatë për këshilltarë bashkiakë) nga partitë politike dhe veçanërisht nga vetë kryetarët e partive. Edhe në këto zgjedhje u evidentua i njëjti problem, listat u përgatitën me pak ose aspak input nga strukturat e partive duke mbetur një e drejtë ekskluzive e kryetarëve të partive politike.

Në këtë klimë mosbesimi të përgjithshëm dhe akuzash të ndërsjella për kriminalizim të jetës politike apo tentativash për dekriminalizim të saj, partitë kryesore nisën fushatën zgjedhore të parakohshme, në shkelje të plotë të ligjit, çka u shoqërua edhe me shkelje të ligjit përse i përket përdorimit të burimeve publike për fushatën e parakohshme zgjedhore.

⁶ Takimi i 8 i Komitetit Ndërparlamentar të Stabilizim/Asociimit mes Shqipërisë dhe Bashkimit Europian i zhvilluar nga 16 në 18 mars 2015 dështoi në daljen me një rezolutë të përbashkët pasi opozita refuzoi të nënshkruante rezolutën pas refuzimit të kërkesës së tyre për të përfshirë akuzat e deputetit Doshi ndaj Kryetarit të Kuvendit, Meta në të.

B. KUADRI LIGJOR

a) Ndarja e re incognito dhe jo sipas Kodit Zgjedhor e Zonave të Administrimit Zgjedhor (ZAZ)

Më datë 02/04/2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 74/2012”, i iniciuar nga katër deputetët e Kuvendit të Shqipërisë z. Blendi Klosi, z. Ulsi Manja, z. Vexhi Muçmata dhe z. Petrit Vasili.

Kodi Zgjedhor parashikon një procedurë të posaçme lidhur me marrjen e të dhënave për numrin e zgjedhësve me të drejtë vote për çdo Njësi të Qeverisjes Vendore (njësi administrative).

Më saktësisht kjo procedurë mbështet në nenin 27, pika 5 dhe 6 e Kodit Zgjedhor.

Nga shqyrtimi i ligjit rezulton se numri i zgjedhësve në njësitë përbërëse që figurojnë në listën e ZAZ-ve, nuk korrespondon me numrin e zgjedhësve në këto njësi as në ZAZ-të e miratuara me vendim të Kolegjit Zgjedhor në 03.01.2013 dhe as me numrin e tyre në listën finale të zgjedhësve të zgjedhjeve të 23 qershorit 2013.

Në relacionin e përgatitur nga deputetët nismëtarë thuhej se “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka adresuar këto propozime për ndryshime në Kodin Zgjedhor me shkresën zyrtare drejtuar Kuvendit me nr. 914/1 prot dt. 05.02.2015”.

Nga komunikimi zyrtar me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë u informua prej këtij institucioni për një kërkesë për të shpejtuar ndryshimet në Kodin Zgjedhor, dhe për një propozim të bërë prej tij për të ribërë ndarje të territorit në 89 Zona të Administrimit Zgjedhor⁷, pra me të njëjtin numër zonash sipas zgjedhjeve të vitit 2013.

Ndërsa amendimi ligjor në fjalë, në fakt parashikoi ndarjen e territorit në 90 ZAZ, dhe nuk parashikoi ndryshimin e kriterit ligjor të parashikuar në nenin 27 pika 2 gërma “ç” mbi numrin e përafërt të zgjedhësve.

Së pari, nuk u bë e ditur arsyeja përse Kuvendi, megjithëse u shpreh se ishte i shtyrë prej propozimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e rriti numrin e Zonave të Administrimit Zgjedhor nga 89 në 90.

Më e rëndësishmja është se ndarja në fund rezulton të ketë bashki ku Zonat e Administrimit Zonal përbërëse kanë diferenca të mëdha me njëra-tjetrën në numrin e zgjedhësve.

Kështu mund të përmendim shembujt si vijon:

1. në bashkinë Shkodër tre ZAZ kanë afërsisht 30 000 zgjedhës, ndërsa e katërta ka rreth 68 000 të tillë
2. në bashkinë Durrës 3 ZAZ kanë afërsisht 54 000 – 56 000 zgjedhës, ndërsa e katërta ka rreth 67 000 të tillë
3. në bashkinë Kamëz njëra ZAZ ka rreth 29 000 zgjedhës, ndërsa tjetra ka rreth 61 000 të tillë
4. në bashkinë Elbasan 3 ZAZ kanë afërsisht 32 000 – 35 000 zgjedhës, ndërsa e katërta ka rreth 60 000 të tillë
5. në bashkinë Lushnjë njëra ZAZ ka rreth 44 000 zgjedhës, ndërsa tjetra ka rreth 57 000 të tillë

⁷ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Shkresa me Numër Protokollit 914/1, datë 05/02/2015.

6. në bashkinë Korçë njëra ZAZ ka 34 000 zgjedhës, ndërsa tjetra ka rreth 73 000 të tillë.

Ky numër i lartë zgjedhësish në këto ZAZ dhe pamundësia e shtimit të numrit të tavolinave numëruese në Vendet respektive të Numërimit të Votave, do të bëjnë që në këto ZAZ procesi i numërimit të zgjatet më shumë se në ZAZ-të e tjera duke krijuar premisa për një tensionim artificial të situatës, pasi rezultati final i zgjedhjeve për atë bashki do të varet nga rezultati i shpallur nga kjo ZAZ.

Në këtë pikë, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë në “Letrën e Hapur” të datës 11 Mars 2015⁸ sugjeroi zbatimin e kriterit ligjor për numrin e përafërt të zgjedhësve për çdo ZAZ (pra duhej bërë rillogaritje në ndarjen e njësive administrative ose shtim të numrit të ZAZ-ve).

b) Vendimi nr. 88 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe problematika e krijuar

Procedimi administrativ i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në kuadër të përgatitjes institucionale për zgjedhjet e 21 qershorit është ndeshur me një sërë ankimesh nga ana e subjekteve zgjedhore, të cilat e kanë zanafillën në konfuzionin e krijuar si pasojë e reformës territoriale.

Përmendim procesin ankimor të nisur nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë ndaj vendimit të KQZ nr. 88, datë 07.04.2015 “Për miratimin e modeleve të kandidimit, që do të përdoren në zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015”.

Ankimi në fjalë, i paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor parashtrori pretendimin se:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbardhjen e vendimit të sipërcituar, ka ndryshuar përmbajtjen e aktit që ky organ ka diskutuar dhe miratuar në mënyrë përfundimtare gjatë mbledhjes përkatëse të zhvilluar më parë.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi detyrimin e mbledhjes së nënshkrimeve atyre kandidatëve që ishin kryebashkiakë ose anëtarë të Këshillave Bashkiakë të atyre njësive vendore (komunave) që me “Reformën Territoriale” u shkrinë.

Thelbi i problematikës konkrete është në faktin nëse kanë apo jo kryetarët aktualë të komunave, ose anëtarët e Këshillave të tyre, të drejtën sipas nenit 70 të Kodit Zgjedhor, për t’u përjashtuar nga detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve për efekt të kandidimit në këto zgjedhje.

Është e vërtetë se sipas përmbajtjes aktuale të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar së fundmi me ligjin nr. 31/2015, ai nuk përmban më përcaktime apo referenca ndaj komunave apo njësive të tjera “të vjetra” të qeverisjes vendore, në përputhje me ndarjen e re territoriale. Nuk duhet harruar se këto njësi të reja efektivisht do të marrin formën e tyre vetëm pas zgjedhjeve të këtij viti.

Deri në atë moment do të ekzistojnë ende njësitë tradicionale sipas ndarjes së vjetër administrative dhe për pasojë edhe organet e tyre përfaqësuese dhe ekzekutive, së bashku me personat që ushtrojnë detyra pranë tyre, do të kenë të gjitha cilësitë juridike, kompetencat dhe të drejtat që kanë zotëruar deri më tani. Të drejta, të cilat nuk shuhën për sa kohë ligji nuk ka parashikuar shprehimisht të kundërtën dhe për sa kohë këto organe nuk janë suprimuar ende.

⁸ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (2015). Deklaratë “Propozime të KVV-së lidhur me ndryshimet teknike të Kodit Zgjedhor”, datë 11 Mars 2015. Për më shumë tek: <http://www.zgjedhje.al/index.php?idart=84&gj=sh>

Rrjedhimisht, në vlerësimin e KVV, nuk ka asnjë përligje të arsyeshme, për mos t'u njohur të drejtën kryetarëve të komunave, apo anëtarëve të këshillave të këtyre njësive, për t'u trajtuar në përputhje me përcaktimet e nenit 70.

Kjo pasi dispozita në fjalë do të jetë e aplikueshme sipas ndarjes së re (për kryetarët e bashkive/ anëtarët e këshillave bashkiakë) vetëm pas materializimit të kësaj të fundit, me konstituimin e organeve të saj përfaqësuese dhe ekzekutive.

Deri atëherë të gjithë kryetarët dhe anëtarët e këshillave të njësive të qeverisjes vendore ekzistuese gëzojnë të drejta në mënyrë të barabartë.

c) Rritja e kuotave gjinore në prag të zgjedhjeve si penalitet i mundshëm për partitë e vogla

Koalicioni ka mbështetur në vazhdimësi dhe me forcë rritjen e përfaqësimit të grave dhe zbatimin e ligjit mbi kuotat gjinore të parashikuara.

Gjithashtu, KVV vlerësoi edhe objektivin politik të shprehur nga partitë kryesore për të zbatuar kuotën prej 50% në listat e këshillave vendore për këto zgjedhje. Një objektiv që edhe u normatizua edhe në një detyrim për tërë subjektet zgjedhore.

Megjithatë, duhet kujtuar se kjo kuotë në logjikën e vet dhe si praktikë e demokracive të brishta nuk ka interes në realizim sasior.

Është një prag për t'i dhënë mundësi përpjekjeve të politikanëve femra për t'u bërë pjesë e garimit elektoral.

Realizimi i një kuote 50% është me të vërtetë një sfidë dhe qëllim për demokracinë shqiptare, por nuk mund të shtrembërohet në një “çelje dere” e pa merituar në garimin politik.

Përpos cënimit të frymës së garimit elektoral, kjo nisëm e pa menduar mjaftueshëm mund të kishte gjeneruar edhe problematika zgjedhore për partitë e vogla.

Arsyet për këtë, ishin koha e shkurtër nga data e zgjedhjeve dhe rëndimi më tej i detyrimit për këto parti në përzgjedhjen e kandidaturave, një problematikë kjo që u kalua nga këto subjekte zgjedhore, por që parimisht mund t'iu ishte bërë pengesë.

d) Manuali i Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor

1) Në vazhden e Vendimit nr. 88, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e rëndon vendimmarrjen e saj edhe në hartimin e Manualit të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor. Një akt shumë i rëndësishëm në ecurinë e punës të kësaj trupe të përkohshme, e cila në çdo proces vuan prej mungesës së profesionalizmit dhe trajnimit. Ky akt është një mundësi orientimi në ato raste kur gjendet edhe përkushtimi nga anëtarët për t'iu referuar ligjit zgjedhor.

Evidentojmë këtu se sipas *Aneksit të Manualit* të miratuar, lehtësirat e parashikuar prej Kodit Zgjedhor për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit zvogëlohen akoma më shumë nga sa e bënte vendimi numër 88 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në Kreun IV “*Kandidimi, dokumentacioni, paraqitja, verifikimi, regjistrimi*”, në pikën 2 “*Dokumentacioni i kandidatit për Kryetar Bashkie të paraqitur nga partia politike*” për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit ndër të tjera kërkohet:

“iv. Vërtetimin për zotërimin e mandatit në Kuvend, ose:

- Vërtetimin që zotëron mandat si Kryetar Bashkie në rast së kandidati kandidon për Kryetar Bashkie
- Vërtetimin që zotëron mandat si anëtar i këshillit bashkiak në rast se kandidati kandidon si anëtar i këshillit bashkiak, sipas nenit 70/4 dhe 68/2 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar.”

Sipas rregullimit që bën Aneksi i Manualit për Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor anëtarët e këshillit bashkiak nuk mund të kandidojnë për kryetar, dhe anasjelltas.

2) Partitë politike, nisur nga detyrimi që përcakton Kodi Zgjedhor⁹, Ligji “Për Nëpunësin Civil” si dhe morali politik i një gare të barabartë, duhet të sigurojnë që të gjithë kandidatët të cilët mbajnë poste apo janë nëpunës civilë dhe kandidojnë për kryetar bashkie apo anëtarë të këshillave bashkiakë, të japin dorëheqjen nga postet e tyre ose së paku të kërkojnë pezullimin nga detyra që mbajnë¹⁰.

Ndërsa sipas rregullimit që bën Aneksi i Manualit për Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor, kandidatëve iu kërkohet vetëm “deklarimi i dorëheqjes nga funksionet e përcaktuara në nenin 63 pika 4 të Kodit Zgjedhor shoqëruar me kopjen e dorëheqjes të depozituar/protokolluar pranë institucionit përkatës”.

e) Keqinterpretimi i Kodit Zgjedhor mbi kandidimin e kandidatëve të pavarur

Sërish në kuadër të kontradiktave të lindura prej qëndrimeve të ndryshme lidhur me efektet e ndarjes së re administrative-territoriale, subjekti “Partia Socialdemokrate e Shqipërisë” paraqiti ankim pranë Kolegjit Zgjedhor kundër vendimit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve nr. 214, datë 06.05.2015, përmes të cilit ky organ vendosi kthimin për korrigjim të dokumentacionit të kandidimit për listën shumemërore të kandidatëve për Këshillin e Bashkisë Durrës, të Partisë Socialdemokrate si më poshtë :

“Të depozitohet lista e 1% të zgjedhësve të Bashkisë Durrës që mbështesin listën e kandidatëve për këshillin e bashkisë Durrës të propozuar nga Partia Socialdemokrate së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, të nënshkruar prej tyre...”

Argumenti mbi të cilin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e mbështeti këtë vendimmarrje lidhet me faktin se sipas ndarjes aktuale territoriale, dy prej kandidatëve të listës së PSD, ishin anëtarë të Këshillave Bashkiakë në njësi vendore të ndryshme nga bashkia Durrës (Sukth dhe Manëz). Në këto kushte, KQZ vlerësoi se për personat në fjalë duhej paraqitur lista e nënshkrimeve të mbështetësve të nevojshëm për kandidimin e tyre, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor.

Ky arsyetim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ishte i cunguar dhe nuk i përmbahej as logjikës së legjislacionit zgjedhor, as edhe shtrirjes së efekteve në kohë të reformës territoriale.

⁹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 63 “Subjektet zgjedhore dhe kandidatët”.

¹⁰Ligji 152/2016, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil”, Neni 37 “Të drejtat politike”, pika: “3. Nëpunësi civil ka të drejtën të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra”.

Ndarja e re administrative, sikurse u theksua edhe më parë, nis me efekte të plota pas konstituimit të organeve të saj prej zgjedhjeve të datës 21 qershor.

Deri në atë moment të drejtat e këtyre organeve, si dhe të përfaqësuesve të tyre janë të pacënueshme.

Për më tepër shtojmë faktin se Bashkia Durrës “e re”, nga pikëpamja territoriale, përmbledh edhe bashkitë e sotme të Sukthit dhe të Manzës, anëtarët e këshillave të të cilave janë në listën zgjedhore-objekt shqyrtimi. Kjo e bën edhe më evidente pabazueshmërinë e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

f) Handikapi ligjor në lidhje me nënshkrimet e zgjedhësve

Kushtetuta e Shqipërisë që në nenin 2 pika 2 shprehet se “*Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti*”.

Një dispozitë që e përshkruan demokracinë shqiptare si një shtet ku legjislativi i të përfaqësuarve dhe iniciativa normative qytetare qëndrojnë potencialisht të barabarta.

Një parim që pas Referendimit të vitit 1988, për miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me gjithë disa përpjekje referendare, nuk ka gjetur zbatimin.

Që prej vitit 1998, normativa ka qenë tërësisht prodhim i legjislativit, duke e shndërruar thjesht në afirmativ parimin e sipërpërmendur.

Kjo gjendje shoqërohet edhe me një mangësi jo të vogël ligjore. Ndryshimi i Kodit Zgjedhor në vitin 2008, i la një detyrim legjislativit që ishte hartimi i një ligji mbi referendimet e përgjithshme dhe vendore. Një detyrim që shprehet në nenin 182 pika 2 e Kodit Zgjedhor sot në fuqi¹¹ Sot, shtatë vite më pas ky detyrim i vonuar mbetet mbi përgjegjësinë e Kuvendit të Shqipërisë.

Kodi Zgjedhor parashikon edhe një element të iniciativës qytetare që ka të bëjë me *passive suffrage*, e drejta për t’u zgjedhur.

Kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, ose siç emërtohen gjerësisht kandidatëve të pavarur, i kushtohen veçanërisht dy nene të Kodit Zgjedhor¹².

Këtyre kandidatëve për t’u bërë pjesë e garimit elektoral i vendoset detyrimi i paraqitjes së një kuote nënshkrimesh prej zgjedhësve që i mbështesin, që i korrespondon jo më pak se një qind e listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore.

Vlerësimi i dokumentacionit dhe sidomos i vlefshmërisë së nënshkrimeve, sado një proces tepër mekanik në tagrin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (apo të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor) bëhet objekt problematikash.

Një fenomen që botërisht vihet re në ato Komisione Qendrore Zgjedhjesh që vihen nën trysni politike.

Rasti më i fundit i kësaj problematike ishte kandidatura për Kryetar të Bashkisë Selenicë, në Zonën e Administrimit Zgjedhor Numër 85.

Në këtë rast Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkoi edhe ekspertizën e Ministrisë së Brendshme në vlerësimin e origjinalitetit të nënshkrimeve të dorëzuar prej kandidatit në fjalë¹³.

¹¹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 185, pika 2, “*Pavarësisht nga përcaktimet e bëra në pikën 1 të këtij neni, pjesa e nëntë “Referendimet” e ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe çdo pjesë e dispozitave të tij që ka lidhje me të mbetet në fuqi deri në miratimin e ligjit të ri për referendimet e përgjithshme dhe vendore.*”

¹² Po aty, Neni 69. *Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet në Kuvend; dhe Neni 70, Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore.*

Përvoja botërore është e pasur me shembuj në këtë drejtim. Që prej shteteve pjesë të Shteteve të Bashkuara si *Oklahoma* apo *South Dakota*, ku origjinaliteti i nënshkrimeve merret i mirëqenë (nëse nuk ngrihet dyshimi prej palëve të interesuar), dhe deri në Letoni¹⁴ ku në nismën referendare të 2012-ës nënshkrimeve iu bashkëngjiti çertifikimi i origjinalitetit prej noterit, shembujt janë të shumtë.

Duke i dhënë tagrin Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor për të vlerësuar origjinalitetin e firmave, i pari nën trysni të shpeshtë politike dhe të dytët të ngritur mbi bazën e një balance politike, objektiviteti i tyre mund të vihet lehtësisht në dyshim.

Kodi Zgjedhor duket sikur ia zoton tërësisht gjykimin të dy institucioneve të sipërpërmendur në lidhje me nënshkrimet për regjistrimin e kandidaturave të propozuar nga zgjedhësit. Një rregullim që e kanë bërë edhe shumë vende me Komisionet Qendrore të Zgjedhjeve apo me institucionet e ngjashme.

Gjithsesi vlen të konsiderohet edhe qasja tjetër. Prej ligjit zgjedhor, dy institucioneve në fjalë nuk i atribuohet asnjë mekanizëm apo tagër eksplicit për të patur një ekspertizë të tillë¹⁵.

Në këtë qasje, Kodi Zgjedhor i shteron nga çdo gjykim këto dy institucione, duke i lënë thjesht si regjistruar të përciptë të një liste dokumentacionesh.

¹³ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. *Shkresa me Numër Protokolli 4887*, datë 16.05.2015.

¹⁴ <http://rus.delfi.lv/news/daily/latvia/zapchel-nachinaet-sbor-podpisej-za-referendum-po-nulevomu-variantu.d?id=40370427>

¹⁵ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 73, *Verifikimi i dokumentacionit*, “1. KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja, verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të Kodit Zgjedhor, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 35 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Dokumentacioni i korrigjuar depozitohet jo më vonë se 32 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre.”

C. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Organet e administrimit zgjedhor në sistemin zgjedhor që ka Shqipëria janë: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) si dhe Grupet e Numërimit të Votave (GNV).

C.1 KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucioni kryesor i ngarkuar nga ligji për administrimin, koordinimin dhe mbikqyrjen e gjithë procesit zgjedhor.

KQZ-ja ka zhvilluar 31 mbledhje dhe ka marrë 455 vendime nga data 27 mars deri ne 21 maj 2015. Për 14 prej këtyre vendimeve është bërë ankimim në Kolegjin Zgjedhor¹⁶.

Veprimtaria e këtij institucioni gjatë dy muajve të fundit është përqëndruar kryesisht në:

- përgatitjen dhe miratimin e akteve për regjistrimin e partive e politike;
- regjistrimin e listave shumemërore dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit dhe subjektet zgjedhore në bashkitë me më shumë se një ZAZ;
- ngritjen e KZAZ-ve dhe miratimin e manualit për to;
- miratimin e qendrave të votimit në adresa private;
- miratimin e adresave të vendeve të numërimit të votave;
- miratimin e modeleve të fletëve të votimit, etj.

Një pjesë shumë e rëndësishme e punës së KQZ ka qenë shqyrtimi i kërkesave ankimore të ardhura nga kandidatë apo subjekte të ndryshme zgjedhore.

Në shumicën dërrmuese të vendimmarrjes së KQZ-së ka mbizotëruar konsensusi por, ka patur edhe vendime të marra me shumicë të thjeshtë, pra me 4 vota pro dhe 3 kundër.

Në rastet e kërkesave ankimore, të paraqitura kryesisht nga partitë politike, KQZ është përfshirë në debate, ku evidentohet qartazi qëndrimi i anëtarëve të KQZ, i njëjtë me qëndrimin e përfaqësuesve të forcave politike prej të cilave janë propozuar për të qenë anëtarë të KQZ-së.

KQZ ka nënshkruar marrëveshje me institucione të rëndësishme si AMA dhe Prokuroria e Përgjithshme. Këto marrëveshje konsistojnë në bashkëpunim ndërmjet institucioneve për rritjen e standardeve të procesit zgjedhor.

Angazhimet e marra përsipër në “Memorandumin e Bashkëpunimit” ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Prokurorisë së Përgjithshme përbëjnë një frymë vërtet pozitive bashkëpunimi. Ajo çfarë duhet theksuar është se ky memorandum së bashku me angazhimet reciproke përbën dhe një përgjegjësi të madhe për të dy institucionet. Përgjegjësi që buron nga vetë kuadri ligjor zgjedhor dhe jo vetëm.

Në kornizën e zgjedhjeve të mëparshme, ku janë të pakët personat e vendosur përpara përgjegjësisë për shkeljet dhe krimet e kryera përgjatë dhe në dhunim të procesit zgjedhor, në këndvështrimin e KVV-së, ky angazhim duhet parë si një autokritikë dhe një përkushtim akoma më i madh në mbarëvajtjen e zgjedhjeve të datës 21 Qershor.

¹⁶ Kolegji Zgjedhor ka vendosur pushimin për 4 kërkesa ankimore, ka rrëzuar 5 kërkesa ankimore dhe ka pranuar 5 kërkesa ankimore.

Mbarëvajtja dhe ecuria pas datës së zgjedhjeve, do jetë realisht nënshkrimi i atij memorandumit prej këtyre dy institucioneve. Në të kundërt ajo çfarë do mbesë nga ky akt do jetë një afirmim vullneti pa asnjë vlerë.

Ndër çështjet që vlen të sjellim në vëmendje për të ilustruar punën dhe performancën e KQZ-së gjatë administrimit të procesit gjatë kësaj periudhe përmendim:

1. Miratimi i rregullores

Kodi Zgjedhor parashikon në nenin 184 pika 2, se KQZ duhet të kishte miratuar Rregulloren e Brendshme jo më vonë se data 26.12.2012.

KVV dhe aktorë të tjerë kanë ngritur vazhdimisht shqetësimin për vonesat në mosmiratimin e këtij akti, si dhe rolin dhe rëndësinë themelore e tij në funksionimin e institucionit.

Pas asistencës dhe kontributit të partive politike dhe veçanërisht të OSBE-së, KQZ hartoi dhe miratoi këtë rregullore.

Rregullorja e Brendshme e KQZ¹⁷ u miratua me *vendimin numër 95*, datë 08.04.2015.

2. Angazhimi i Personave me Aftësi të Kufizuar

Në datën 30.04.2015, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve trajnoi dhe më pas nënshkroi kontrata pune me 12 Persona me Aftësi të Kufizuar (PAK), të cilët do të angazhohen pranë Zyrave Rajonale Zgjedhore, përkatësisht në çdo qark të vendit.

Është hera e parë që KQZ-ja angazhon PAK në procesin zgjedhor duke i bërë pjesë integrale të strukturave të veta e posaçërisht të Zyrave Rajonale Zgjedhore.

Ky angazhim konsiston jo vetëm në angazhimin konkret të PAK, por edhe në evidentimin e problematikave dhe rekomandimeve konkrete në funksion të përmirësimit të kushteve për të respektuar dhe realizuar çdo të drejtë të kësaj kategorie në proceset zgjedhore dhe më tej.

3. Ngritja e KZAZ-ve, trajnimi i trajnerëve

Afati i fundit që parashikon Kodi Zgjedhor për ngritjen Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) për zgjedhjet e datës 21 qershor 2015 ishte data 21 Mars 2015.

Ky afat nuk u bë i mundur, për shkak të vonesës në miratimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor nga Kuvendi i Shqipërisë.

Menjëherë pas miratimit të këtyre ndryshimeve, KQZ mori vendimin për përcaktimin e afateve të reja për ngritjen e KZAZ-ve, një prej të cilave ishte dorëzimi i propozimeve të partive politike në KQZ deri në datën 9 Prill 2015.

KQZ-ja miratoi ngritjen e KZAZ-ve në datën 13 Prill 2015. Sipas shortit të hedhur dhe miratuar në KQZ, PS propozoi anëtarin e shtatë në KZAZ me numër çift, ndërsa PD propozoi anëtarin e shtatë në KZAZ me numër tek.

¹⁷Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. *Rregullore për Organizimin dhe funksionimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.*

http://www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/rregullore_cec/Rregullorja%20e%20KQZ.pdf

KQZ bëri trajnimin e trajnerëve në datën 11.04.2015, ndërkohë që mbledhja e parë e KZAZ-ve u zhvillua në një pjesë të KZAZ-ve në datën 14 prill 2015, në respekt të vendimit të KQZ-së.

Në nenin 93, pika 2, gërma b, përcaktohet qartë se: “Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave nuk mund të krijohen: b) në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore”.

Ndryshe nga sa diktohet nga ky përcaktim, KQZ me vendimin nr. 85 datë 07.04.2015 ka përcaktuar selitë e KZAZ-ve në kundërshtim me kriteret¹⁸ e sipërpërmendura.

4. Ngritja e BMM-së, Marrëveshja me AMA

Sipas përcaktimeve në Kodin Zgjedhor, KQZ-ja nënshkroi një marrëveshje bashkëpunim me AMA, në mënyrë që të lehtësoje dhe rrisë cilësinë e punës monitoruese të Bordit të Monitorimit të Medias gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore.

Sipas nenit 85 pika 1 të Kodit Zgjedhor, KQZ duhet të kishte ngritur Bordin e Monitorimit të Medias (BMM) deri në datën 2 Prill 2015. Përbërja dhe mënyra e ngritjes së tij përcaktohen në nenet 85 dhe 85/1 të Kodit Zgjedhor.

KQZ morri vendim për ngritjen e BMM në datën 6 Maj 2015 me vendimin nr. 211. Në vendimin e KQZ-së vërehet se të gjitha kandidaturat e paraqitura nga çdo anëtar i KQZ për anëtarë të BMM-së dhe të miratuara nga Komisioni, janë paraqitur dhe protokolluar në KQZ pas kalimit të afatit zyrtar të përcaktuar në Kod¹⁹.

Për më tepër organizatat që kanë sjellë këto propozime për anëtarë të BMM nuk janë në listën e organizatave të cilave KQZ-ja iu ka bërë kërkesë për të propozuar anëtarë.

Nuk është i qartë fakti se si KQZ-ja mori në konsideratë këto kandidatura jo vetëm të paraqitura jashtë afatit, por edhe nga organizata ndaj të cilave nuk ishte bërë asnjë kërkesë zyrtare.

¹⁸Sipas lidhjes së këtij vendimi selia e KZAZ-së nr. 76 është në Bashkinë Memaliaj (salla e mbledhjeve); e KZAZ nr.1 është në godinën e Drejtorisë së Bujqësisë; e KZAZ-së nr. 77 në Bashkinë Tepelenë. Për më shumë tek: http://www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/te_dhena_ZAZ/Zyrtar%20e%20KZAZ-ve.xls.pdf.

¹⁹ Emrat për anëtarë të BMM të paraqitur prej secilit anëtar të KQZ dhe miratuar (anëtarët e BMM) janë si më poshtë: “Znj. Lefterije Luzi, Kryetare i paraqet KQZ për miratim si anëtar BMM, z. Basir Çollaku, propozuar nga Shoqata e Sociologëve Universitar Shqipëtar me shkresën nr. 3141, datë 28.04.2015; Z. Denar Biba Zv/Kryetar i paraqet KQZ-së për miratim si anëtar BMM z. Florian Seriani propozuar nga Qendra Kulturore Mediatike Antigona, me shkresën nr.3971, datë 04.05.2015; Zj. Edlira Jorgaqi, anëtare, i paraqet KQZ-së për miratim si anëtar BMM z.Maklen Misha propozuar nga Forumi Shqipëtar për Mediat e Lira me shkresën nr.3972, datë 04.05.2015; Z. Gëzim Veleshnja anëtar i paraqet KQZ-së për miratim si anëtar BMM z Vilson Kuçi, propozuar nga Qendra Kulturore Mediatike Antigona me shkresën nr.3400, datë 02.05.2015; Z. Hysen Osmanaj i paraqet KQZ për miratim si anëtar BMM, z. Andon Andoni, propozuar nga Shoqata e Sociologëve Universitar Shqipëtar me shkresën nr.3141, datë 28.04.2015; Z. Klement Zguri i paraqet KQZ për miratim si anëtar BMM, zj.Klarita Bajraktari, propozuar nga Shoqata e Sociologëve Universitar Shqipëtar me shkresën nr.3141, datë 28.04.2015; Zj. Vera Shtjefni i paraqet KQZ për miratim si anëtar BMM, z. Rexhep Polis propozuar nga Shoqata e Sociologëve Universitar Shqipëtar me shkresën nr.3141, datë 28.04.2015” – Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Vendim nr.211, datë 06.05.2015. <http://www2.cec.org.al/sq-al/Legjislacioni/Aktet-e-KQZ-s%C3%AB/Vendimet/Vendimet-2015>.

Nga KQZ-ja nuk është marrë asnjë vendim në lidhje me shtyrjen e afateve të pranimit të kandidaturave për anëtarë të BMM-së, ndërkohë që ky institucion duhet të kishte qenë më aktiv në ndërmarrjen e hapave të duhur për të siguruar një proces ligjor deri në hapin final të miratimit të BMM-së.

Pavarësisht deklaratave publike të bëra nga KQZ-ja, të cilat sigurisht përbëjnë një angazhim të institucionit në lidhje me çështjen, angazhimi i saj duhet të ishte edhe më konkret dhe ligjor duke ushtruar autoritetin e vet si organ kolegjal për të rivendosur një afat të ri apo kryer njoftime të reja, sikurse ndodhi pas përfundimit të afatit ligjor me hapat joligjore të ndërmarra.

5. Ceremonialiteti i mbledhjeve

Mbledhjet e KQZ-së janë publike dhe gjatë zhvillimit të tyre në sallë ka jo vetëm gazetarë e vëzhgues, por edhe persona të interesuar mbi çështjet që diskutohen në këtë komision.

KVV vlerëson angazhimin e Kryetares së KQZ për të njoftuar në fund të mbledhjeve ditën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes pasardhëse, si një detyrim që përcaktohet në Kodin Zgjedhor.

Gjithashtu, KVV vlerëson gatishmërinë e KQZ-së për të marrë në shqyrtim dhe verifikuar çdo rast, për të cilin indici për problematikën që mund të ketë apo sjellë, vjen nga përfaqësuesit e partive politike.

Në të gjitha rastet mbledhjet fillojnë me disa minuta vonesë (10 deri në 30 minuta vonesë).

Shumë shpesh, anëtarët e Komisionit vazhdojnë të diskutojnë pa mikrofonta me njëri-tjetrin, çka jo vetëm shkakton zhurmë në sallë, por nga ana tjetër përbën shkelje të etikës dhe profesionalizmit, mosrespektim të personave që janë duke folur, përfshi këtu administratën, përfaqësuesit e partive politike apo edhe palë të tjera interesuara që diskutojnë gjatë mbledhjeve.

Fakti që anëtarët e Komisionit diskutojnë shpesh pa mikrofon gjatë mbledhjes, lidhur me akte të ndryshme, është një tregues për mungesën e konsultimit paraprak të tyre me njëri-tjetrin dhe me materialet në shqyrtim.

Shtyrjet pa ndonjë shkak thelbësor të mbledhjeve apo edhe pa paraqitur asnjë lloj shkak, por thjesht duke bërë komunikimin e vendimit të shtyrjes nga Kryetarja, përbëjnë një tjetër problem evident gjatë punës së KQZ-së.

Mbetet i pakuptimtë fakti që përgjithësisht pas diskutimeve kur anëtarët manifestojnë qëndrime qartazi të kundërta rreth projekt-akteve që kanë në shqyrtim, përpara hedhjes në votë dhe marrjes së vendimit final nga Komisioni, përgjithësisht kërkohet, pa servitur asnjë shkak, pushimi për pak kohë i mbledhjes.

6. Transparenca dhe menaxhimi i punës nga Administrata

Faqja zyrtare e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është një aspekt shumë i rëndësishëm në funksionimin e KQZ-së, pasi jo vetëm që aty pasqyrohen të gjitha informacionet zyrtare të KQZ-së, por publikimi i materialeve në të është një ndër elementët detyrues që Kodi jep në funksion të rritjes së transparencës, bërjes publike të

aktivitetit të KQZ-së, por edhe të mundësisë për të komunikuar dhe ndërvepruar online me administratën e KQZ-së.

Disa prej vendimeve që ka marrë KQZ-ja nuk janë të publikuara²⁰ në faqen zyrtare të internetit, megjithëse detyrimi ligjor është që ato të publikohen brenda 24 orëve nga marrja e vendimit.

Në pasqyrimin e vendimeve në faqen zyrtare të internetit mungon përcaktimi se si ka qenë votimi i anëtarëve të KQZ-së në lidhje me atë vendim.

Gjithashtu, materialet paraprake të projekt-akteve që do të diskutohen dhe miratohen gjatë mbledhjeve të radhës në KQZ, në shumë raste mungojnë²¹ dhe në raste të tjera ato janë aty pjesërisht²².

7. Regjistrimi i partive politike dhe i koalicioneve

Afati i fundit për regjistrimin e partive politike në KQZ ishte data 12 Prill 2015²³. KQZ-ja regjistroi 61 parti politike²⁴ dhe refuzoi regjistrimin për dy parti²⁵ të tjera, të cilat u regjistruan më pas nga Kolegji Zgjedhor.

Shkaku i mosregjistrimit të këtyre partive ishte se nuk kishin kthyer tepricën e fondeve të përfutuara nga buxheti i shtetit për fushatën zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013, sipas nenit 87 pika 6 të Kodit Zgjedhor²⁶.

Në këto kushte Neni 87 pika 8 e Kodit Zgjedhor parashikon se partitë politike të cilat nuk kthejnë fondet përkatëse nuk mund të regjistrohen si subjekte zgjedhore në zgjedhjet e radhës pavarësisht llojit të tyre, as vetëm dhe as si pjesë e ndonjë koalicioni.

Edhe për disa parti të tjera të regjistruara nga KQZ, kthimi i kësaj shume apo auditimi nga KQZ-ja ishte kryer jashtë afateve ligjore, pasi sipas nenit 87 pika 8 kjo shumë duhet të ishte kthyer brenda 90 ditësh nga dita e përfitimit të tyre, që korrespondon me muajin shtator 2013.

Pavarësisht kthimit të shumës jashtë afateve ligjore dhe penaliteteve që dikton ligji, përsëri KQZ-ja bëri regjistrimin e tyre.

Në total në zgjedhjet e 21 qershorit do të jenë 63 parti. 52 parti janë të grupuara në dy koalicione kryesore dhe 9 të tjera garojnë jashtë koalicioneve (2 parti nuk do të përfshihen në fletën e votimit pasi nuk kanë paraqitur lista shumëmemërore për kandidatë për këshillat bashkiakë).

²⁰ Nr e vendimeve qe mungojnë: Vendimi nr. 400, nr. 403-406; 418; 430, 432, 434, 439, 440, 442, 445, etj.

²¹ Mungojnë materialet e mbledhjeve të datës 30.03.2015; 14.04.2015; 15.04.2015; 16.04.2015; 22.04.2015; 23.04.2015; 28.04.2015; etj.

²² Janë pjesërisht 09.04.2015; 04.05.2015; 16.05.2015; etj.

²³ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 64, pika 1.

²⁴ Lista e plotë e partive politike të regjistruara për zgjedhjet e 21 qershorit 2015 tek http://www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rregjistri/150427%20-%20DTI%20-%20parti_koalocione_2015.pdf

²⁵ Partia e të Drejtave të Mohuara dhe Partia Lëvizja Puntore Shqiptare. Këto dy parti paraqitën kërkesë ankimore në kolegjin Zgjedhor dhe u regjistruan nga ai.

²⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 87, pika 6.

Kështu, 37 parti janë pjesë e Koalicionit Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASHE), 15 parti janë pjesë e Koalicionit Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet (APPD) dhe 11 parti nuk janë të përfshira në asnjë prej koalicioneve²⁷.

Ndërsa në fletët e votimit do të jenë të përfshira 61 parti, pasi 2 parti nuk kanë depozituar në KQZ apo KZAZ lista shumëmemërore për kandidatë për këshilla bashkiake.

Afati i fundit për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore ishte data 22 prill 2015²⁸. Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASHE) u regjistrua nga KQZ me vendimin nr. 176 datë 27.04.2015, ndërsa Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet (APPD) u regjistrua nga KQZ me vendimin nr. 177 datë 27.04.2015.

Në kërkesën për regjistrimin e ASHE ishin 39 parti, por KQZ-ja me arsyetimin se dy parti²⁹ nuk ishin regjistruar në KQZ sipas dispozitave të nenit 65 pika 1 të Kodit Zgjedhor, ndaj për rrjedhim ato nuk mund të ishin pjesë e asnjë koalicioni zgjedhor.

8. Regjistrimi i kandidateve

Në zgjedhjet lokale të datës 21 qershor 2015, do të garojnë gjithsej 162 kandidatë për kryetarë bashkie.

KQZ-ja ka regjistruar kandidatët që garojnë në bashki, në territorin e të cilave ndodhen më shumë se një KZAZ. Ata kandidatë që garojnë në bashki, në territorin e të cilave ndodhet vetëm një KZAZ, sipas Kodit Zgjedhor dhe udhëzimeve të KQZ u regjistruan pranë KZAZ-së së bashkisë përkatëse.

Përpos kandidatëve të propozuar nga subjektet zgjedhore, qofshin këto koalicione apo parti politike që garojnë jashtë koalicionit, KQZ-ja ka regjistruar edhe kandidatë të pavarur, të propozuar nga zgjedhësit.

Këta kandidatë sipas një procedure ligjore, kanë regjistruar fillimisht në KQZ Komitetin Nismëtar³⁰ dhe më pas kanë dorëzuar firmat mbështetëse të 1% të zgjedhësve të zonës zgjedhore ku ata kandidojnë.

Për këta kandidatë, bëhet verifikimi sipas nenit 71 pika 3³¹ të Kodit Zgjedhor.

Anëtarët e KQZ, në vazhdimësinë e punës së tyre janë shprehur vazhdimisht se është në frymën e punës së KQZ që të krijojë kushte të njëjta dhe barazi për çdo kandidat, qoftë ky i mbështetur nga partitë kryesore politike ose jo.

Pavarësisht bindjes se të gjithë duhet të jenë në kushte të barabarta, me vendimmarrjen e saj KQZ-ja shpesh nuk e ka respektuar këtë parim.

Në kërkesat ankimore të ndryshme të shqyrtuara në KQZ, kandidatët e PSD janë hequr nga gara bazuar në një procedurë ligjore, e cila lë shteg për diskutime dhe dyshime serioze.

²⁷Konkretisht ndarja e partive nëpër koalicione dhe partitë që garojnë jashtë koalicioneve tek http://www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/rregjistri/150427%20-%20DTI%20-%20parti_koalocione_2015.pdf

²⁸ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 65, pika 1.

²⁹Partia “Lëvizja Punëtore Shqiptare” dhe Partia “Toleranca e Re e Shqipërisë”

³⁰ Komiteti nismëtar për realizimin e punës për mbledhjen e nënshkrimeve për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përbëhet nga jo më pak se 9 persona.

³¹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 71, pika 3.

Përpos kësaj, shumë kandidatë të partive të vogla janë penalizuar për shkak të vendimmarrjes së KQZ.

Me vendimin nr. 88 datë 07.04.2015, iu hoq e drejta partive që zotëronin mandate nëpër këshillat e komunave apo si kryetar komune, të futeshin në garë pa patur nevojën të mblidhnin nënshkrimet e 1% të zgjedhësve të zonës zgjedhore.

Ky vendim u bë subjekt ankimimi në Kolegjin Zgjedhor, i cili e rrëzoi vendimmarrjen e KQZ-së referuar vendimit nr. 88 datë 7 Prill 2015, por pa e shfuqizuar këtë vendim.

Kjo situatë solli konfuzion tek kandidatët dhe dokumentacioni që ata duhet të plotësonin për regjistrim. Për më tepër që pas rrëzimit të këtij vendimi, tashmë u soll si argument kalimi i afatit të regjistrimit të kandidatëve në KQZ apo KZAZ-në përkatëse.

Vendimmarrja e gabuar e KQZ dhe gjithë kjo situatë penalizoi në radhë të parë kandidatët e partive të vogla që u regjistruan për të garuar jashtë koalicioneve apo që do të dëshironin të garonin si të pavarur.

9. Regjistrimi i listave të kandidatëve për këshillat bashkiakë dhe kuotat gjinore

Listat shumëemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiake, për bashkitë me më shumë se një KZAZ janë kontrolluar dhe regjistruar nga KQZ.

Në të gjitha rastet këto lista respektonin kuotën gjinore (1 në çdo 2 ishte nga e njëjta gjini) të vendosur në Kodin Zgjedhor, pas ndryshimeve të fundit të miratuara nga Parlamenti.

Nga 63 parti të regjistruara në KQZ, vetëm 61 prej tyre depozituan në KQZ apo KZAZ listat shumëemërore të kandidatëve për këshillat bashkiake. Rrjedhimisht vetëm këto parti do të shfaqen në fletën e votimit për anëtarë të këshillave bashkiakë.

Gjithashtu përpos propozimeve të bëra nga partitë politike, në zgjedhjet e 21 qershorit do të kandidojnë edhe 12 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit për anëtarë të këshillave të bashkisë të ndarë sipas bashkive përkatëse.

10. Kërkesat ankimore dhe vendimmarrja e KQZ-së

Procesi i shqyrtimit të kërkesave ankimore ka qenë i shoqëruar me jo pak debat në KQZ. Madje, vendimmarrja në shumicën dërrmuese të këtyre kërkesave ka qenë e ndarë në 4 vota pro dhe 3 kundër, pra jokonsensuale.

Qëndrimet e anëtarëve të KQZ kanë qenë të njëjta me ato të përfaqësuesve të partive politike, të cilët i kanë propozuar për të qenë anëtarë të KQZ.

Në total në KQZ janë paraqitur 22 kërkesa ankimore. Nga këto kërkesa janë shqyrtuar 18 ndërsa për dy është vendosur moskalimi në shqyrtim³² për shkak të mungesës së legjitimitetit të kërkesës.

Të gjitha këto kërkesa ankimore kanë qenë të përqëndruar në kundërshtimin ndaj vendimeve të KZAZ-ve të ndryshme për mosregjistrimin e kandidatëve për kryetarë bashkie apo të listave shumëemërore për anëtarë të këshillave bashkiakë.

³²Kërkesat ankimore nr. 8, nr.11, nr. 16, nr. 17.

Në gjashtë raste subjekti ankues nuk ka qenë i njëjtë me subjektin ndaj të cilit KZAZ ka marrë vendimin.

Kështu kërkesat ankimore nr. 6, nr. 7, nr. 12, nr. 13, nr. 18 dhe nr. 21 janë paraqitur nga subjektet PS dhe LSI. Objekti i ankimit konsistonte në shpalljen si të pavlefshëm të vendimeve të KZAZ-ve me anë të të cilave është bërë regjistrimi i kandidatëve të propozuar nga PSD në pesë raste dhe kandidatit të propozuar nga PD në një rast.

Në 18 kërkesa ankimore të shqyrtuara gjithsej, për 10 prej tyre vendimmarrja ka qenë e ndarë në 4 vota pro dhe 3 kundër. Pra në më shumë se gjysmën e rasteve KQZ nuk ka gjetur konsensusin për zgjidhjen e çështjes, ndërkohë që vihet re mos mbajtja parasysh (vijimësia) e precedentëve të krijuar prej vendimmarrjes së mëparshme të vetë komisionit³³.

Referuar procedurës së shqyrtimit të kërkesave ankimore, pasi hidhet shorti për caktimin e relatorit të çështjes, ky i fundit relaton nëse kërkesa i plotëson kriteret e nevojshme ligjore për t'u kaluar në shqyrtim më pas nga KQZ-ja.

Në kërkesën ankimore nr. 9 kjo procedurë nuk pati vëmendjen e nevojshme, pasi fakti që kërkesa ishte firmosur nga ankuesi (individi për kandidat) dhe jo nga kryetari i subjektit politik apo një përfaqësues ligjor i tij, e bën të pamundur proceduralisht shqyrtimin e mëtejshëm të saj.

KQZ-ja pavarësisht se kishte vendosur kalimin në shqyrtim të çështjes duke mos vërejtur problemin e firmës që e bënte të pavlefshme kërkesën, vazhdoi gjykimin dhe vendosi rrëzimin e saj pikërisht me arsyetimin se kërkesa nuk është legjitime duke qenë se është firmosur nga individi dhe jo nga kryetari apo përfaqësuesi i autorizuar i subjektit politik. Ky vendim solli pasoja të drejtpërdrejta cënuese tek e drejta për t'u regjistruar dhe për të garuar e një subjekti politik, për shkak të pakujdesisë dhe gabimit të vetë KQZ-së, ndërkohë që është kjo e fundit që duhet t'u garantojë kushte të barabarta në garë subjekteve elektorale.

11. Vendimi nr. 88 dt. 07.04.2015.

Në mbledhjen e datës 7 Prill 2015, KQZ-ja mori në shqyrtim projekt-vendimin “Për miratimin e modeleve të kandidimit, që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015” dhe pas shumë diskutimesh vendosi të miratojë të drejtën e personave që zotërojnë mandat në nivel lokal (qoftë ky edhe mandat në këshilla) për të kandiduar pa qenë e nevojshme mbledhja e firmave të votuesve mbështetës, sikundër parashikohet për kandidatët e pavarur që aktualisht nuk kanë mandat si të zgjedhur të pushtetit vendor në bashki apo komunë.

Në këtë mbledhje u miratua akti i propozuar nga administrata e KQZ ku thuhet se: “Përyshkohet nga detyrimi i mësipërm (i përcaktuar në nenin 70 pika 3 të Kodit Zgjedhor) kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, nëse janë kryetarë bashkie ose

³³Në lidhje me kërkesat ankimore nr. 5, nr.7, nr. 14, nr. 15 objekti i të cilave kishte të bënte përgjithësisht me kundërshtime të vendimeve të KZAZ-ve, KQZ vendosi që t'i rikthente ato në KZAZ në mënyrë që këto të fundit të kryenin siç duhet detyrën e përcaktuar nga ligji dhe me arsyetimin se janë çështje që duhet t'i zgjidhë KZAZ-ja. Ndërkohë me kërkesat ankimore nr. 19 dhe nr. 20, për të cilat objekti i shqyrtimit ishte i njëjtë, KQZ vendosi shqyrtimin në KQZ me arsyetimin se koha nuk premtonte.

Për më tepër anëtarët që në çështjet e para kishin votuar pro kthimit në KZAZ, në dy kërkesat e fundit votuan pro shqyrtimit në KQZ, dhe e njëjta gjë për anëtarët që kishin votuar kundër kthimit në KZAZ tani votuan kundër shqyrtimit në KQZ.

komune, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse (sipas ligjit për ndarjen territoriale do të përfshihen ish-komunat dhe bashkitë që tashmë janë njësi administrative përbërëse të bashkisë për të cilën do të kandidohet) ose deputet”. Votimi në lidhje me modelin 01-K që përfshin këtë çështje ka qenë 4 me 3, ndërkohë miratimi në tërësi i aktit, i cili përmbledh të gjitha modelet e kandidimit ka qenë 5 me 2.

Ndërsa në vendimin e publikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së thuhet ndryshe. Aty thuhet se “Përrjashtohen nga detyrimi i mësipërm kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, nëse janë kryetar bashkie, anëtarë të këshillit të bashkisë përkatëse ose deputet”.

Në lidhje me ndryshimet e bëra në këtë vendim KVV është shprehur me një deklaratë publike³⁴ në datën 16 Prill 2015.

Përpos kësaj ky vendim është bërë objekt ankimi në Kolegjin Zgjedhor nga PSD. Kolegji shfuqizoi përmbajtjen e këtij vendimi por jo vetë vendimin, çka solli edhe më shumë konfuzion për kandidatët dhe subjektet zgjedhore që prekeshin prej tij.

Gjithsesi, një pjesë e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit dhe partitë që garojnë jashtë koalicioneve, vazhduan procesin e regjistrimit të tyre duke dorëzuar pranë komisioneve përkatëse listën mbështetëse me 1% të nënshkrimeve të zgjedhësve të zonës zgjedhore përkatëse, pavarësisht se zotëronin mandat në këshill.

12. Deklarata për fillimin e fushatës nga Kryetarja dhe reagimi i zv. kryetarit.

Neni 77 i Kodit Zgjedhor³⁵, përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve. Konkretisht, fushata zgjedhore duhet të fillojë në datën 22 maj 2015 dhe të përfundojë në datën 19 qershor 2015.

Nisur nga fakti që dukshëm partitë politike kishin nisur fushatën elektorale para afatit, Kryetarja e KQZ bëri një deklaratë për mediat në datën 5 maj 2015, e cila pasoi thirrjen e bërë në fillim të mbledhjes së po asaj dite për nisjen e parakohshme të fushatës zgjedhore, ku njoftoi të gjitha partitë politike që të respektojnë Kodin Zgjedhor në lidhje me fillimin e fushatës.

Duke iu referuar Kodit Zgjedhor, Kryetarja e KQZ deklaroi se “Nëse partitë politike nuk do të ndërpresin menjëherë fushatën zgjedhore, të nisur përpara përcaktimeve ligjore, atëherë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të marrë masat e parashikuara në Kodin Zgjedhor. Gjithashtu ky apel vlen edhe për të gjithë mediat të cilat po ashtu janë të detyruara të zbatojnë Kodin Zgjedhor, pasi neni 77 përcakton detyrimin edhe për median fillimin e fushatës në datë 22 maj, ndaj mediat të mos transmetojnë asnjë material të fushatës zgjedhore të kandidatëve apo partive politike”.

³⁴ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (2015). Deklaratë “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mungesë transparence dhe ndryshime të paligjshme të akteve të miratuara më parë”, datë 16.04.2015. <http://zgjedhje.al/index.php?idart=88&gj=sh>

³⁵ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 77 “Periudha e fushatës dhe heshtjes zgjedhore”, pika 1 “1.Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve.” http://www.parlament.al/web/pub/kodi_zgjedhor_i_azhornuar_pdf_web_15174_1.pdf.

Pavarësisht se Kryetarja e KQZ e bëri këtë deklaratë në emër të institucionit që ajo drejton, në reagimet e Zv. Kryetarit të këtij komisioni në media³⁶, u deklarua se ai ishte një qëndrim i Kryetares dhe jo i trupës së KQZ-së.

Përpos kësaj, pavarësisht se asgjë nuk ndryshoi në lidhje me vazhdimin e fushatës zgjedhore dhe paraqitjes së saj në media, KQZ-ja nuk ndërmori asnjë hap të mëtejshëm në zbatim të dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor.

Reagimi i Kryetares së KQZ, i cili duhet vlerësuar dhe mbështetur si një reagim i mbështetur në ligj, mbeti vetëm në kornizat e një deklaratë dhe nuk u pasua nga veprime konkrete, ndërkohë që KQZ si organ kolegjal mund të nxirrte akte nënligjore për të ndaluar çdo fushatë politike jashtë afateve të përcaktuara në ligj.

C.2. KOMISIONET ZONALE TË ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, do të administrohen në nivelin e dytë nga 90 Komisione Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ).

Roli dhe rëndësia e këtyre KZAZ-ve në këtë proces zgjedhor është e lartë, pasi ato jo vetëm që administrojnë organizimin e procesit në Zonën përkatëse të Administrimit Zgjedhor (ZAZ), por kanë edhe disa përgjegjësi të shtuara të cilat janë thelbësore në një proces zgjedhjesh vendore.

KZAZ-të kryejnë regjistrimin e kandidatëve të forcave politike, të cilat janë regjistruar më parë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si subjekte politike pjesëmarrëse në garë, si dhe të kandidatëve të pavarur të mbështetur nga një grup zgjedhësish për organet e reja të qeverisjes vendore³⁷, në rastin kur bashkia përkatëse mbulohet vetëm nga një ZAZ.

Gjithashtu, KZAZ-ja ka kompetencën të shpallë fituesin e zgjedhjeve për kryetar të asaj bashkie.

Në rastet kur territori i bashkisë mbulohet nga më shumë se një ZAZ atëherë këto kompetenca të posaçme i kalojnë KQZ-së, ndërkohë që KZAZ-të bëjnë vetëm përgatitjen dhe miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për çdo subjekt zgjedhor dhe për çdo kandidat për kryetar bashkie në ZAZ dhe ia dërgojnë ato KQZ-së.

Përbërja e KZAZ-ve dhe ngritja e tyre

KZAZ-të përbëhen nga shtatë anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja me propozimin e partive politike, sipas një procedure të mirëpërcaktuar në nenin 29 të Kodit Zgjedhor e cila ruan balancën politike. Zëvendëskryetari është i përkatësisë së kundërt politike me Kryetarin. Sekretari i KZAZ-së nuk ka të drejtë vote.

Ndarja e vendeve të anëtarëve të KZAZ-së bazohet në renditjen e partive parlamentare sipas numrit të votave të fituara prej tyre në shkallë vendi për këshillat vendore³⁸ në Zgjedhjet Vendore të 8 Majit 2011.

³⁶ Për më shumë shih <https://www.youtube.com/watch?v=sd1B7TdmQFM>

³⁷ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 33 “Detyrat e KZAZ-së” gërma f : “Regjistron subjektet zgjedhore dhe kandidatët për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore.”

³⁸ Po aty, Neni 29 “Përbërja e KZAZ-së” pika 4: “Renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ, sipas përcaktimeve të këtij neni, bëhet mbi bazën e numrit të mandateve që ka fituar partia politike nga zgjedhjet pararendëse për Kuvendin. Në rastin e zgjedhjeve vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e

2 anëtarë të këtyre komisioneve propozohen nga Partia Socialiste (PS), 2 anëtarë propozohen nga Partia Demokratike (PD), 1 anëtar propozohet nga Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) dhe 1 anëtar propozohet nga Partia Republikane (PR).

Duke u bazuar edhe në shortin e hedhur³⁹ nga KQZ-ja, në KZAZ-të me numër çift anëtari i shtatë propozohet nga PS, ndërsa sekretari nga PD dhe në KZAZ-të me numër tek anëtari i shtatë propozohet nga PD, ndërsa sekretari nga PS.

Nenit 28 i Kodit Zgjedhor përcakton si afat të fundit për ngritjen e KZAZ-ve datën 23 Mars 2015.

Miratimi i ndarjes së re territoriale të vendit e bëri të pamundur procesin e ngritjes së KZAZ-ve, pasi diktonte një ndarje të re⁴⁰ të ZAZ-ve, e cila nuk mund të bëhej pa adresuar ndryshimet e nevojshme ligjore në Kodin Zgjedhor.

Kuvendi i Shqipërisë u vu në lëvizje për të bërë ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor pas nismës së 4 deputetëve të maxhorancës, të cilët nga ana tjetër u nxitën për këtë nismë pas dy shkresave që KQZ-ja, në tejkalim të kompetencave të veta i dërgoi Kuvendit të Shqipërisë⁴¹.

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor, u miratuan nga Parlamenti në seancë plenare në datën 2 Prill 2015.

Sipas nenit 184 pika 3 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar tashmë me ligjin e ri nr. 31/2015, datë 02.04.2015, Kuvendi i atribuon KQZ-së të drejtën⁴² për të përcaktuar afate të reja lidhur me ngritjen e KZAZ-ve si dhe lidhur me procese të tjera që afektohen nga këto afate.

Sipas vendimit të miratuar nga KQZ⁴³, partitë politike dorëzuan listat me propozime për anëtarë të KZAZ-ve pranë KQZ-së më datën 9 prill 2015, që ishte tashmë afati i ri i përcaktuar.

Menjëherë më pas KQZ-ja miratoi anëtarët⁴⁴ e KZAZ-ve, sekretarët, si dhe kryetarët dhe zv/kryetarët e tyre⁴⁵ pas propozimeve të ardhura nga vetë anëtarësia e KZAZ-ve.

numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare”.

³⁹ Vendimi nr. 84 datë 7 Prill 2015 “Për shpalljen e rezultatit të shortit për caktimin e partisë që do të propozojë anëtarin e shtatë të KZAZ-ve në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015”.

⁴⁰ Ndarja e vjetër e territorit në 89 ZAZ të miratuara në Zgjedhjet e kaluara Parlamentare, për Zgjedhjet Lokale të 21 Qershorit rezultonte e pambështetur në ligj, pasi ajo është miratuar duke u bazuar mbi rrethin administrativ si juridiksion territorial, i cili nuk ekziston më si koncept në ligjin e ri administrativo-territorial të miratuar.

Po ashtu kjo ndarje nuk është as funksionale pasi në një pjesë të konsiderueshme të ZAZ-ve nuk sigurohet kriteri i pandashmërisë, në ndarjen e re me 61 bashki.

⁴¹ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Shkresa me Nr. 914 prot., datë 03.02.2015, Lënda “Kërkohet shpejtim i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor” dhe shkresa me nr. 914/1 prot. Datë 05.02.2015, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë.

⁴² Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 184 pika 3, Nxjerrja e akteve nënligjore, Përfshirja për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015, afatet e parashikuara në nenin 28 e në vijim të Kodit Zgjedhor, të cilat nuk mund të zbatohen, ngarkohet KQZ-ja për miratimin e tyre me vendim, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

⁴³ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Vendim nr. 87 datë 4 Prill 2015 “Për miratimin e afateve për ngritjen e KZAZ-ve dhe depozitimin e dokumentacionit të kandidatimit në KZAZ dhe KQZ nga Grupet Nismëtare, për zgjedhjet për Organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015, si pasojë e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor”.

⁴⁴ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Vendim nr. 133 datë 13.04.2015 “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015”

Anëtarësia e KZAZ-ve dhe kuotat gjinore

Kodi Zgjedhor përcakton kuotën gjinore⁴⁶ prej 30 % për anëtarët e KZAZ-ve të propozuar nga dy partitë më të mëdha.

Kjo kuotë është respektuar nga këto dy parti për 225 anëtarët e propozuar prej tyre në shkallë vendi, dhe respektivisht nga PS në masën e 38,2% (86 gra, 139 burra) dhe nga PD në masën e 37,3% (84 gra, 141 burra).

Gjithashtu, vlen të theksohet se kuota gjinore është respektuar prej PS dhe PD, edhe pas ndryshimeve të shpeshta që ata i kanë bërë anëtarëve të tyre në KZAZ.

Trajnimi dhe ndryshimi i anëtarëve të KZAZ-ve

Ndryshimi i anëtarëve të KZAZ-ve prej partive politike që i propozojnë ato, vazhdon të mbetet sërish një problem jo i vogël edhe për këtë proces zgjedhor.

Megjithëse kjo e drejtë iu njihet këtyre partive nga Kodi Zgjedhor, shfrytëzimi i saj pa kriter është në nivele shqetësuese, pasi kjo zhbën procesin e trajnimit që kanë ndjekur anëtarët e mëparshëm, si dhe e shndërron procesin e administrimit zgjedhor që duhet të kryejnë këto KZAZ në ZAZ-të përkatëse, në një proces të mirëfilltë politik dhe militantist.

Është për t'u vlerësuar thirrja e herëpashershme që kryetarja e KQZ-së ka bërë ndaj partive politike për mosndryshimin e anëtarëve të KZAZ-ve, por përsëri, deri në periudhën që mbulon ky raport, janë kryer 123 zëvendësime⁴⁷ në trupën prej 630 anëtarësh, ose rreth 19.52 % e tyre.

Sipas një deklarate të KQZ-së për mediat të datës 11 prill 2015, u njoftua se ishte kryer trajnimi i 52 trajnuesve të anëtarëve të KZAZ-ve.

Nga informacionet e marra nga vëzhguesit e KVV në terren, trajnimet e anëtarëve të KZAZ-ve janë kryer përgjatë periudhës 15 Prill 2015 deri në 5 Maj 2015.

Selitë e KZAZ-ve dhe funksionaliteti i tyre

Kodi Zgjedhor i kushton rëndësi ndër të tjera vendit ku KZAZ-ja do të ngrihet dhe ku do të ushtrojë detyrën e saj në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në ligj.

Në nenin 93, pika 2, gërma b, përcaktohet qartë se: “*Qendrat e votimit, selitë e KZAZ-ve dhe Vendi i Numërimit të Votave nuk mund të krijohen: b) në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore*”.

Ndryshe nga sa diktohet nga ky përcaktim, KQZ me vendimin nr. 85 datë 7.04.2015 ka përcaktuar selitë e KZAZ-ve kundërshtim me kriteret⁴⁸ e sipërpërmendura.

⁴⁵ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Vendim nr. 154 datë 15.04.2015 “*Për emërimin e kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të KZAZ-ve, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 Qershor 2015*”.

⁴⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 29 “*Përbërja e KZAZ-së*” pika: 1/ç “*30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini.*”

⁴⁷ Deri në datën 21 Maj, PS ka ndryshuar 54 anëtarë ose 24 %; PD 43 anëtarë ose 19.1 %; PR 19 anëtarë ose 21.1 % dhe LSI 7 anëtarë ose 7.8 %.

⁴⁸ Sipas lidhjes së këtij vendimi selia e KZAZ-së nr. 76 është në Bashkinë Memaliaj (salla e mbledhjeve); e KZAZ nr.1 është në godinën e Drejtorisë së Bujqësisë; e KZAZ-së nr. 77 në Bashkinë Tepelenë. Për më

Nga monitorimi i KVV rezulton se disa KZAZ nuk ndodhen në adresat e miratuara nga KQZ, por në adresa të tjera⁴⁹ të cilat sërish nuk janë në përmbushje të kritereve të ligjit.

Për funksionimin normal të KZAZ-ve parashikohet vënia në dispozicion e pajisjeve, e bazës së nevojshme materiale si dhe e rrjetit të komunikimit e veçanërisht pajisja me linjë telefonike të rrjetit fiks⁵⁰.

Nga monitorimi i KVV është vërejtur se në shumë KZAZ⁵¹ ky element mungon. Gjithashtu përveç rrjetit të telefonit fiks, mungojnë edhe elementë të tjerë, të cilët përbëjnë bazën materiale të nevojshme⁵² për kryerjen e punës nga KZAZ-ja.

Mbledhjet e KZAZ-ve dhe orari i punës së tyre

Bazuar në vendimin 86 të KQZ-së⁵³, KZAZ-të duhet të zhvillonin mbledhjen e tyre të parë në datën 14 Prill 2015, afat që u respektua pjesërisht⁵⁴ prej tyre.

Shqetësues është funksionimi i KZAZ-ve pa orar, çka ka sjellë edhe jo pak vështirësi dhe pengesa përsa i përket të drejtës së qytetarëve apo subjekteve politike jashtë dy koalicioneve të mëdha, për të kandiduar, pasi kjo e drejtë u ka humbur ose është bërë pjesë e procesit të apelimit në KQZ, për faktin, e pamundur për tu provuar, nëse ka qenë apo jo në punë KZAZ-ja në orarin dhe kohën e përcaktuar nga rregullorja.

Udhëzimi nr. 2 i KQZ-së, datë 25.02.2009, në nenin 18 të tij përcakton se “Gjatë periudhës zgjedhore dhe deri tre ditë para datës së zgjedhjeve, KZAZ-ja punon paradite nga ora 08.00 – 13.00 dhe pasdite 16.00 - 20.00”.

Nga monitorimi i kryer rezulton se në asnjë rast ky orar nuk respektohet nga anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve.

Një nga faktorët kryesorë në mosrespektimin e këtij detyrimi ka të bëjë me faktin se pjesa dërmuese e anëtarëve të KZAZ-ve janë të punësuar dhe kryesisht janë të punësuar në

shumë tek: http://www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2015/te_dhena_ZAZ/Zyrtar%20e%20KZAZ-ve.xls.pdf.

⁴⁹ KZAZ nr. 52 në Bashkinë Librazhd, sipas vendimit të KQZ-së duhet të ndodhej tek Qendra Kulturore, ndërkohë ajo është vendosur në godinën e Bashkisë Librazhd; KZAZ nr. 74 në Bashkinë Përmet, sipas vendimit të KQZ-së duhet të ndodhej në sallën e aktiviteteve pranë nënprefekturës, ndërkohë ajo është vendosur në godinën e Bashkisë Përmet, tek salla e mbledhjeve të këshillit bashkiak; KZAZ nr. 75 në Bashkinë Këlcyrë, sipas vendimit të KQZ-së duhet të ndodhej tek Shtëpia e Kulturës Këlcyrë, ndërkohë ajo është vendosur tek salla e Këshillit të Bashkisë Këlcyrë; KZAZ nr. 9 Tropojë sipas vendimit të KQZ duhet të ndodhej në Shkollën e Mesme Bajram Curri, ndërkohë ajo është vendosur në godinën e Bashkisë Bajram Curri, tek salla e mbledhjeve të këshillit bashkiak;

⁵⁰ Udhëzimi nr. 2 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve datë 25.02.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, neni 15, pika 4.

⁵¹ Telefoni fiks mungon në KZAZ-të me nr. 1, 29, 55, 6, 64, 79, 88, 82, 90, 26, 75, 52, 6, 50 dhe 55.

⁵² Vërehet mungesa e: - Kompjuterit në KZAZ-në me nr. 55, 56, 38, 50; - Printerit në KZAZ-në me nr. 55, 56, 63, 79, 88, 90, 26, 75, 6, 80, 50; - Lidhjes së internetit në KZAZ-në me nr. 29, 55, 56, 72, 75, 78, 38, 33, 50; - Fotokopjes në KZAZ-në me nr. 1, 72, 29, 55, 56, 62, 63, 64, 26, 1, 52, 78, 38, 6, 23, 80, 69, 50; - Telefonit celular në KZAZ-në me nr. 55, 56, 52; - Faksit në KZAZ-në me nr. 1, 11, 55, 56, 62, 64, 72, 80, 90, 9, 50;

⁵³ Vendim nr. 86 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, datë 7 Prill 2015, “Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015 “

⁵⁴ Nga monitorimi i vëzhguesve të KVV-së rezultoi se në disa KZAZ si ajo me nr. 1; 38; 55; 56; 79; 80; 88; 89; kjo mbledhje është kryer më vonë se data 14 Prill, por në çdo rast është zhvilluar brenda muajit prill 2015.

institucione shtetërore⁵⁵, duke e bërë të pamundur praktikisht ushtrimin e të dy detyrave njëkohësisht.

Në asnjë nga kontaktet e marra me anëtarët e KZAZ-së, nuk është ndjekur mundësia e pezullimit të përkohshëm nga puna që ata kryejnë, në mënyrë që t'i përkushtohen detyrës së anëtarit të KZAZ-së, megjithëse ligji u jep të drejtën e ruajtjes së vendit dhe pozicionit të punës⁵⁶.

Kjo praktikë është e domosdoshme të ndiqet prej tyre sidomos në zbatim të detyrimit që jep neni 18 i udhëzimit nr. 2 të KQZ-së datë 25.02.2009, sipas të cilit KZAZ-të prej datës 18 qershor e deri në shpalljen e rezultateve dhe dërgimit të dokumentacionit të plotë në KQZ, KZAZ-ja duhet të qëndrojë në mënyrë permanente e mbledhur në zyrë.

Respektimi i orarit të punës nga KZAZ-të, është një problem shqetësues që është reflektuar edhe në vendimmarrjen e tyre në lidhje me regjistrimin e kandidatëve për Kryetar Bashkie apo për Anëtarë të Këshillave Bashkiakë, vendimmarrje që ka qenë penalizuese për subjektet pikërisht për shkak të kalimit të afateve të parashikuara në ligj⁵⁷.

Kështu, në disa kërkesa ankimore të paraqitura në KQZ, ankuesit pretendonin se kishin shkuar disa herë në KZAZ por aty nuk kishin gjetur njeri.

Lidhur me këto çështje, duke qenë se subjektet nuk kishin mundësi të provonin se kishin qenë pranë zyrave të KZAZ-së por nuk kishin gjetur aty anëtarët e saj, KQZ ka marrë vendim duke i penalizuar këto subjekte dhe duke lënë në fuqi vendimet e KZAZ-ve për mosregjistrimin e tyre.

Sjellja e KZAZ-ve në procesin e regjistrimit të kandidatëve

Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor janë një strukturë ad hoc, që aktivizohet për rreth tre muaj një herë në dy vjet.

Këto struktura çdo herë vuajnë mungesën e një formimi elektoral-ligjor, influencën e plotë dhe ngacmimin politik si dhe mungesën e një kuadri ligjor të qartë në punën e tyre. Rëndësia e kësaj problematike shtohet në zgjedhjet vendore kur kësaj trupe i vendoset edhe barra e regjistrimit të kandidatëve⁵⁸.

⁵⁵ Një pjesë e mirë e anëtarëve të KZAZ-ve janë të punësuar në institucione shtetërore si: Prefekturë, Bashki, Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Drejtori Arsimore Rajonale, Shkolla 9-vjeçare dhe të mesme, Korporata Elektroenergetike Shqiptare, Drejtoria e Pyjeve, Drejtoria e Shëndetit Publik, Shërbimi Social Shtetëror, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (Hipoteka), Doganë, etj.

⁵⁶ Udhëzimi nr. 2 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve datë 25.02.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, neni 11 “Të drejtat e anëtarit të KZAZ-së”: “Anëtari i KZAZ-së ka të drejtën e shpërblimit për punën e bërë. Masa e shpërblimit përcaktohet me vendim të KQZ-së. Gjatë kohës që anëtari i KZAZ-së ushtron këtë detyrë, nuk humbet të drejtat dhe detyrat në vendin e tij të punës”.

⁵⁷ Afati i parë për regjistrimin e kandidatëve i shpallur me njoftim publik nga KQZ-ja ka qenë data 4 Maj 2015 ora 18.00. Ndërkohë, nga Kryetarja e KQZ-së, përgjatë zhvillimit të mbledhjes së KQZ-së gjatë ditës së hënë datë 04.05.2015, është njoftuar se ky afat shtyhej deri në orën 24.00 në mënatë të po asaj dite. Nuk ka informacion nëse kjo shtyrje afati i është dërguar në rrugë të tjera zyrtare anëtarëve të KZAZ-ve.

⁵⁸ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 67 “Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive”, pika: 1 “Partia politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumëemërore të kandidatëve të saj për çdo zone zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.”

Me këtë tagër që i jepet, KZAZ-të në këtë pikë të rëndësishme arrijnë të dublojnë KQZ-në. Dhënia e më shumë detyrave kësaj trupe të përkohshme jo profesioniste e rrit më shumë mundësinë për të gabuar dhe për t'iu lënë hapësirë ngacmimeve politike.

Udhëzimi i KQZ-së mbi organizimin dhe funksionimin e KZAZ-ve, ndër të tjera, përcakton qartë se *anëtari i KZAZ-së është i detyruar të zbatojë, Kodin Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së, aktet apo dokumentet shkresore të nxjerra nga KQZ-ja dhe të përcjella me rrugë elektronike nëpërmjet Inspektorit Rajonal ose drejtpërdrejtë nga KQZ-ja, si dhe vendimet e KZAZ-së. Anëtari i KZAZ-së është i detyruar të paraqitet rregullisht në detyrë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Udhëzim dhe akte të tjera të KQZ-së.*

Ndërkohë referuar edhe disa prej kërkesave ankimore të ardhura në KQZ, vihet re se në disa raste se anëtarët e KZAZ-ve nuk kanë qenë të informuar për mënyrën ligjore të trajtimit të çështjeve, madje kanë konkluduar në vendimmarrje jo ligjore.

Përmendim rastin e KZAZ nr. 74 në Përmet e cila bëri regjistrimin e kandidatit të PSD me vërtetim si anëtar i Këshillit të Komunës Petran, ndërkohë që sipas vendimmarrjes së KQZ ai duhet të kishte paraqitur listën mbështetëse më 1% të nënshkrimeve të zgjedhësve; apo edhe rastin e KZAZ nr. 15 në Kurbin, e cila mori vendim për ç' regjistrim kandidati, në kushtet kur Kodi Zgjedhor nuk e parashikon⁵⁹ një fare një procedurë të tillë.

Papërgatitja e duhur ligjore apo edhe mosfunksionimi sipas orarit të rregullt zyrtar⁶⁰, penalizon subjektet elektorale që duan të bëhen pjesë e garës zgjedhore, pasi nuk arrijnë të shfrytëzojnë të drejtat që iu jep Kodi Zgjedhor dhe as nuk mund të bëjnë ankimim më tutje⁶¹.

Konfuzion pranë këtyre Komisioneve krijoi edhe vendimi nr. 144 datë 14 Prill 2015 i KQZ-së për miratimin e manualit të KZAZ-ve.

Fillimisht KQZ vendosi që në dokumentet e kandidimit që duhet të plotësonin kandidatët të ishte, përveç të tjerave, edhe certifikata e lindjes/personale dhe kjo vendimmarrje u pasqyrua në manualin e KZAZ-ve.

Por, pas sugjerimeve dhe ankesave të ardhura në KQZ, kjo e fundit vendosi që të pranohej si dokument i vlefshëm identifikimi edhe karta e identitetit.

Ky ndryshim nuk u pasqyrua në disa raste në vendimmarrjen e disa KZAZ-ve, të cilat pikërisht për shkak të mungesës së çertifikatave nuk regjistruan komitetet nismëtare⁶² për kandidatët të pavarur.

Disa nga këto raste u ankimuan në KQZ dhe ishte kjo e fundit që zgjidhi këtë çështje nëpërmjet vendimmarrjes së saj, ndërkohë që ngelet i paprovuar fakti nëse ka patur nisma të tjera të cilat janë tërhequr fare nga kandidimi pas vështirësive të hasura⁶³.

⁵⁹ KZAZ nr. 74 në Përmet me vendimin nr. 3 datë 05.05.2015 ka marrë vendim për regjistrimin e kandidatit të Partisë Socialdemokrate, kur ky i fundit kishte depozituar në KZAZ jo listën me 1% të nënshkrimeve mbështetëse sikurse përcakton udhëzimi i KQZ-së, por kishte paraqitur një vërtetim që zotëronte mandat në Komunën Petran. KZAZ nr. 15 në Kurbin, pas paraqitjes së dorëheqjes nga gara të kandidatit të Aleancës Popullore për Punë dhe Dinjtet (APPD), mori vendim për ç' regjistrimin e tij. As Kodi Zgjedhor dhe as ndonjë udhëzim i KQZ-së nuk përcakton vendimmarrje për një çështje të tillë.

⁶⁰ Rasti i pretenduar nga Partia Konservatore në KZAZ nr. 64 në Bashkinë Berat, pretendim që u ndoq në KQZ me ankimimin numër 5.

⁶¹ Si shembuj për këtë shqetësim, deri në këtë moment të procesit zgjedhor, mund të përmendim *ankimimet numër 5 dhe numër 6* në KQZ, ku kandidatët pretendonin mosfunksionimin e KZAZ-ve më datë 04.05.2015. Tjetër rast është edhe *ankimimi numër 1* në KQZ, ku pretendohet nga kandidati se nga KZAZ-ja i ishin dorëzuar modelet e gabuar për regjistrimin e kandidaturës.

⁶² Kërkesa ankimore nr. 1 dhe kërkesa ankimore nr. 2.

⁶³ Për shkak të mungesës së akreditimit, KVV nuk ka mundur të marrë informacionin e nevojshëm dhe rrjedhimisht të gjykojë në mënyrë të plotë lidhur me këto raste apo për raste të tjera, të cilat mund të kenë

C.3. KOMISIONET E QËNDRAVE TË VOTIMIT

Procesi i votimit për zgjedhjet vendore të datës 21 Qershor 2015 do të administrohet, në nivelin e tretë, nga 5299 Komisione të Qëndrave të Votimit (KQV).

Kodi Zgjedhor parashikon që përsa është e mundur, Qendrat e Votimit (QV) të ngrihen në ambiente shtetërore publike.

Nga 5299 QV, 432 prej tyre janë vendosur në ambiente private dhe 20 QV janë në institucione të posaçme.

Funksionimi i QV-ve, përbërja dhe afatet e ngritjes së tyre

KQV-të funksionojnë si një organ kolegjal gjatë ditës së zgjedhjeve.

Puna e tyre fillon me tërheqjen e bazës materiale për votim, vazhdon me organizimin e procesit të votimit në QV-në përkatëse, dhe pas mbylljes së procesit të votimit në orarin e caktuar bëjnë plotësimin e procesverbaleve dhe dokumentacionit përkatës si dhe transferimin e kutive me fletët e votimit dhe kutisë së materialeve zgjedhore në Vendet e Numërimit të Votave (VNV) të zonës zgjedhore përkatëse.

Risi në punën e KQV-ve është se do të plotësojnë në procesverbalin e mbylljes edhe të dhënat e votuesve mbi baza gjinore, pra sa gra dhe sa burra kanë marrë pjesë në procesin e votimit.

Përbërja e KQV-ve miratohet me të njëjtën formulë si Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ). KQV-ja përbëhet nga shtatë anëtarë⁶⁴, të cilët emërohen nga KZAZ-ja e zonës zgjedhore ku ndodhet QV-ja.

Njëri prej anëtarëve kryen detyrën e sekretarit. Sekretari është i partisë politike të kundërt me kryetarin. KQV-të nuk kanë zv. kryetar.

Sipas udhëzimit nr. 2 datë 04.03.2015⁶⁵ të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), partitë politike duhet të çojnë në KZAZ propozimet për anëtarë të KQV-ve deri në datën 22 Maj 2015.

KZAZ-të duhet të bëjë emërimin e anëtarëve të KQV-ve⁶⁶ në çdo rast jo më vonë se data 1 Qershor 2015.

Kriteret e ngritjes së QV-ve dhe vendndodhja e tyre

Qendrat e Votimit nuk duhet të kenë më shumë se 1000 zgjedhës. Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Brendshme numri i QV-ve jashtë limitit është 0.

KQZ ka miratuar manualin e KQV-së në datën 23 Mars 2015.

ndeshur në të njëjtën problematikë. Një trajtim i tillë i plotë do të përpiqet të bëhet në raportin final të vëzhgimit nga KVV.

⁶⁴ Në përbërjen e KQV-ve do të jenë 2 anëtarë/e të propozuar nga PS, 2 anëtarë/e të propozuar nga PD, 1 anëtar/e i/e propozuar nga LSI, 1 anëtar/e i/e propozuar nga PR dhe anëtar/i ja i/e shtatë (sekretari/ja) propozohet nga partia politike me përkatësi të kundërt me kryetarin.

⁶⁵ Udhëzimi nr. 2 datë 04.03.2015 i KQZ “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit”, Neni 6 “Paraqitja e propozimeve nga partitë politike”, pika 1 “Partitë politike paraqesin në KZAZ propozimet për kryetar, anëtar dhe sekretar të KQV-ve jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve.”

⁶⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 36 “Përbërja e KQV-së”, pika 2.

Sipas Kodit zgjedhor, QV-ja për sa është e mundur duhet të vendoset në ambiente publike.

Në rastet kur kjo gjë është e pamundur, me propozimin e Kryetarit të Njesisë së Qeverisjes Vendore (NJQV), në territorin e të cilës ndodhet QV-ja, ajo mund të vendoset në ambiente private, por duke respektuar kriteret strikte të vendosura nga ligji⁶⁷.

Nga tërësia e propozimeve të ardhura në KQZ për ngritjen e QV-ve, në jo pak raste ato nuk ishin në përmbushje të kriterëve ligjore.

KQZ është angazhuar për të verifikuar në terren çdo propozim apo dyshim të ardhur nga përfaqësuesit e partive politike për vendndodhjen e QV-ve, në respektim të pikës 4 të nenit 93 të Kodit Zgjedhor, duke konkluduar në raportime konkrete në lidhje me to.

Megjithatë, rezulton se janë disa QV të miratuara nga KQZ-ja në adresa private⁶⁸, të cilat nuk përmbushin kriterin ligjor të sipërfaqes së nevojshme të përcaktuar në udhëzimin nr. 1 datë 12.12.2012⁶⁹.

Deri tani janë miratuar nga KQZ 432 QV në ambiente private, ndërkohë që nuk është miratuar ende vendndodhja për 15 QV të tjera që do të vendosen në adresa private pasi janë ende në proces verifikimi.

Bashkia me numrin më të madh të QV-ve është Tirana e cila ka 888 QV për 609.473 zgjedhës dhe Bashkia me numrin më të vogël të QV-ve është Pusteci me 8 QV për 4.280 zgjedhës.

C.4. VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE

Miratimi i Vendeve të Numërimit të Votave

Pas përfundimit të procesit të votimit, procesi i numërimit të votave realizohet në mënyrë të përqëndruar në Vendet e Numërimit të Votave (VNV), të cilat ngrihen në çdo Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ). Pra procesi i numërimit të votave, për zgjedhjet vendore të datës 21 Qershor 2015 do të administrohet në 90 VNV.

Adresat e VNV-ve përcaktohen, pas propozimeve të prefektëve, me vendim të KQZ-së sipas kriterëve të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, deri më datën 12 Maj 2015, i cili është edhe afati i parashikuar⁷⁰ nga Kodi Zgjedhor.

⁶⁷ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012), Neni 93 “Vendndodhja e qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe Vendeve të Numërimit të Votave”

⁶⁸ QV nr. 20461 me sip. 24 m², QV nr. 20462 me sip.24 m², QV nr. 2046 me sip. 25 m², QV nr. 1191 me sip. 26 m²,etj.

⁶⁹ Udhëzimi nr. 1 datë 12.12.2012 “ Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet“ Neni 6 “Kritere teknike për vendndodhjen e qendrës së votimit” pika 1/a “të jetë me sipërfaqe minimumi 30 m²”

⁷⁰ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012), Neni 94 “Vendndodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave”, pika 1: “Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 93 dhe të këtij neni. Jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, KQZ-ja me vendim cakton Vendin e Numërimit të Votave. ...”

Deri në datën 21 Maj, KQZ ka përcaktuar vendndodhjen e 86 KZAZ-ve⁷¹.

Ky proces u vonua edhe për shkak të propozimeve kontradiktore të prefektëve, sugjerimeve nga përfaqësuesit e partive politike si dhe të inspektimeve të realizuara në terren nga administrata e KQZ-së.

KVV vlerëson angazhimin dhe vendimmarrjen e KQZ-së pavarësisht rasteve të propozimeve jo të sakta dhe kontradiktore nga disa prefektë.

Përbërja dhe afatet e ngritjes së Grupeve të Numërimit të Votave

KZAZ-ja organizon dhe përgatit VNV-të në mënyrë të tillë që të garantojë zhvillimin normal të punës për numërimin e votave nga Grupet e Numërimit të Votave (GNV).

KZAZ-ja cakton me vendim numrin e GNV-ve që do të numërojnë votat në rang ZAZ-je.

Çdo GNV emërohet nga KZAZ-ja dhe përbëhet nga 4 anëtarë⁷². Dy anëtarë të GNV propozohen nga partitë e mëdha të shumicës parlamentare dhe pakicës parlamentare (pra konkretisht PS dhe PD).

Partitë politike që propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve përcaktohen me vendim nga KQZ-së. KQZ-ja vendos pas hedhjes së shortit ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive politike të opozitës parlamentare të regjistruara në këto zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit 2013, pra respektivisht Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU) si dhe Partia Republikane (PR).

Në çdo rast pas hedhjes së shortit, të drejtën e propozimit për anëtarë të tretë dhe të katërt të GNV-ve e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare. GNV përbëhet nga numëruesi i parë, sekretari dhe 2 anëtarë.

Numri i GNV-ve për çdo ZAZ përcaktohet me vendim nga KZAZ-ja, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr. 4 datë 09.04.2015 të KQZ⁷³.

Partitë propozuese duhet të dërgojnë propozimet e tyre për anëtarë të GNV-ve jo më vonë se data 9 qershor 2015, ndërsa KZAZ-ja duhet të caktojë⁷⁴ këto grupe deri më datën 11 qershor 2015.

Në rastin e mospropozimit të anëtarëve të GNV-ve prej subjekteve politike brenda afateve të parashikuara, Kodi Zgjedhor autorizon KZAZ-në të përcaktojë me short anëtarët zëvendësues midis anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) që i përkasin atij subjekti zgjedhor në rang zone zgjedhore⁷⁵.

Për zgjedhjet e 21 Qershorit 2015 procesi i numërimit të votave do të bëhet nga një trupë prej 3.520 numëruesish, anëtarë të 880 GNV-ve në të gjithë vendin.

⁷¹ Në proces miratimi janë VNV e KZAZ-së nr. 42 Qarku Tiranë; VNV e KZAZ-së nr. 64 Qarku Berat; VNV e KZAZ nr. 49 Qarku Elbasan; VNV e KZAZ-së nr. 50 Qarku Elbasan.

⁷² Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012), Neni 95 “Procedura për përcaktimin e partive që propozojnë anëtarë të GNV-ve” pika 1.

⁷³ Udhëzimi nr. 4 datë 09.04.2015 “ Për mënyrën e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit për çdo Vend të Numërimit të Votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit”, Neni 6 “Kriteret për caktimin e Tavolinave të Numërimit dhe numrit të Grupeve të Numërimit të Votave”.

⁷⁴ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012), Neni 95 “Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV)” pika 1.

⁷⁵ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012), Neni 95 “Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV)” pika 3.

D. INSTITUCIONE TË TJERA TË ANGAZHUARA NË NDËRTIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR

D.1. KUVENDI I SHQIPËRISË

Më datë 2 prill 2015 Kuvendi i Shqipërisë miratoi me 87 vota pro ndryshimet në Kodin Zgjedhor⁷⁶, ndryshime të cilat vinin si pasqyrim i dy projektligjeve, njëri prej të cilëve adresonte ndryshimet teknike të domosdoshme që rridhnin prej reformës së re administrativo- territoriale⁷⁷ dhe tjetri adresonte kuotat gjinore të detyrueshme për partitë politike si dhe sanksionet në rast mospërbushjeje të këtyre kriterëve⁷⁸.

Vonesa në amendimet e nevojshme të Kodit Zgjedhor solli bllokim në procesin zgjedhor, duke qenë se Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) e kishte të pamundur të miratonte Zonat Zgjedhore për Zgjedhjet Vendore 2015.

Kuvendi i Shqipërisë nuk ndërmori hapat e nevojshëm për këto ndryshime zgjedhore dhe u desh që KQZ-ja t'i drejtohet Kuvendit me një shkresë në datën 3 shkurt 2015, shoqëruar me propozime konkrete për ndryshimet të dërguar më datë 5 shkurt 2015⁷⁹.

Pavarësisht se mosmiratimi i amendimeve solli një bllokim të procesit duke qenë se zonat e reja zgjedhore do të duhej të ishin miratuar brenda 21 janarit 2015, Kuvendi mori dy muaj kohë nga momenti që KQZ kërkoi zyrtarisht përshejtim të miratimit të amendimeve dhe një muaj e gjysmë kohë nga momenti që grupi i deputetëve nismëtarë vendosi të merrte në konsideratë dhe mbështeste këto propozime.

Gjatë diskutimeve në lidhje me ndryshimet në Kodin Zgjedhor në Komisionin e Ligjeve u ftuan edhe organizata të shoqërisë civile për të dhënë opinionin e tyre, një prej të cilave ishte edhe KVV.

Propozimet dhe rekomandimet e veta në lidhje me ndryshimet e nevojshme, KVV, përveçse i shprehu në prani të Komisionit të Ligjeve në seancën dëgjimore, i bëri edhe publike me anë të një Letre të Hapur dërguar Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetarëve të Grupeve Parlamentare më 11 mars 2015⁸⁰.

Është e rëndësishme të theksohet se Kuvendi i Shqipërisë nuk mori në konsideratë dy nga propozimet kryesore të KVV-së në lidhje me dy pika shumë të rëndësishme të cilat do të duhej të ishin adresuar gjatë amendimeve të Kodit Zgjedhor: (1) zbatimin e kriterit ligjor për numrin e përafërt të zgjedhësve për çdo Zonë të Administrimit Zgjedhor dhe (2)

⁷⁶ Kuvendi i Shqipërisë (2015). *Ligj Nr. 31/2015, Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10 019, Datë 29.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR*, datë 2.4.2015. http://www.parlament.al/web/pub/ligj_nr_31_dt_2_4_2015_21836_1.pdf.

⁷⁷ Kuvendi i Shqipërisë (2015). *Projektligj "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10019, Datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhori i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar*, nismë e deputetëve Blendi Klosi, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj dhe Petrit Vasili, 23.02.2015. http://www.parlament.al/web/PROJEKTLIGJ_P_R_DISA_NDRYSHIME_N_LIGJIN_NR_10019_DAT_2_9_12_2008_KODI_ZGJEDHOR_I_REPUBLIK_S_19385_1.php.

⁷⁸ Kuvendi i Shqipërisë (2015). *Projektligj për disa shtesa e ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë*, nismë e deputetëve Mesila Doda, Mimoza Hafizi dhe Silva Caka, datë 05.02.2015. http://www.parlament.al/web/PROJEKTLIGJ_P_R_DISA_SHTESA_E_NDRYSHIME_N_KODIN_ZGJEDHOR_T_REPUBLIK_S_S_SHQIP_RIS_19246_1.php.

⁷⁹ Propozimet e KQZ në lidhje me ndryshimet në Kodin Zgjedhor dërguar Kuvendit të Shqipërisë në 5 shkurt 2015 janë të njëjtat që ky institucion i ka dërguar Ministrit për Çështjet Vendore më 10 nëntor 2015, me shkresën me Nr. 1416/1 Prot.

⁸⁰ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (2015). *Letër e Hapur – Propozime të KVV lidhur me ndryshimet në Kodin Zgjedhor*, datë 11.03.2015. <http://zgjedhje.al/index.php?idart=84&gj=sh>.

qartësimin në ligj nëse kryetarët apo këshilltarët aktualë të Njësive të Qeverisjes Vendore (Komuna dhe Bashki) do të kishin të drejtë të kandidonin pa patur nevojë të mbledhnin firma mbështetëse⁸¹.

Heqja e termit “Komunë” dhe “Këshill Komune” nga Kodi Zgjedhor në amendimet që iu bënë⁸² solli përballjen e KQZ-së me legjitimitimin ose jo të së drejtës së të zgjedhurve aktualë si Kryetarë Komunash apo Anëtarë të Këshillave Komunalë për të kandiduar në Zgjedhjet Lokale 2015 si të pavarur pa patur nevojën për të mbledhur firma mbështetëse.

Në datë 7 prill 2015, pas shumë diskutimesh e debatesh, KQZ vendosi që këta të zgjedhur ta kishin këtë të drejtë me Vendimin nr. 88, datë 07. 04.2015 “Për miratimin e modeleve të kandidimit, që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015”, ndërkohë që pas publikimit në faqen zyrtare të KQZ-së në internet në datën 8 prill 2015, më datën 14 prill në mënyrë abuzive, totalisht të paligjshme dhe të paprecedentë, në faqen zyrtare të KQZ-së u bënë ndryshime në përmbajtjen e vendimit, si dhe u prekën 6 nga 15 modelet shoqëruese të këtij vendimi⁸³. Ecuria e miratimit të këtij lë të nënkuptohet qartë për ushtrimin e presionit politik të dyanshëm, çka do të ishte kursyer ndaj KQZ-së, në rast se ligjvënësi do ta merrte në shqyrtim dhe të vendoste për çështjen.

D.2. MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Një ndër institucionet kryesore në përgatitjen e procesit zgjedhor të 21 Qershorit, është Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Roli i saj konsiston kryesisht në procesin e përgatitjes dhe saktësimin të listave të zgjedhësve.

Procesi i publikimit të listave të zgjedhësve u krye në mënyrë periodike nga NJQV-të përkatëse. Ky proces u shoqërua me disa problematika për të cilat KVV është shprehur në raportet e mëparshme.

Sipas të dhënave zyrtare të MPB-së lidhur me ndarjen e QV-ve rezultojnë se:

- a) *Numri i përgjithshëm i Qëndrave të Votimit (të sakta)*
Në ekstraktin e datës 16 Mars 2015 kanë qenë 5.315 QV, në ekstraktin e datës 14 Prill 2015 kanë qenë 5.316 QV dhe në ekstraktin përfundimtar janë 5.299 QV.
- b) *Numri i Qëndrave të Votimit jashtë limitit (mbi 1000 zgjedhës)*
Në ekstraktin e datës 16 Mars 2015 kanë qenë 8 QV, në ekstraktin e datës 14 Prill 2015 kanë qenë 6 QV dhe në ekstraktin përfundimtar janë 0 QV.
- c) *Numri i Qëndrave të Votimit nën limitin (20-200 zgjedhës)*
Në ekstraktin e datës 16 Mars 2015 kanë qenë 6 QV, në ekstraktin e datës 14 Prill 2015 kanë qenë 2 QV dhe në ekstraktin përfundimtar janë 0 QV.

⁸¹ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (2015). *Raporti I Parë I Ndërmjetëm I Monitorimit për Zgjedhjet Lokale 2015, Seksioni III: Rekomandime, fq. 49-50, 30.03.2015*

⁸² Kuvendi I Shqipërisë (2015). *Ligj Nr. 31/2015, Pdisa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10 019, Datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, datë 2.4.2015; Neni 18 “Në të gjithë tekstin e ligjit, fjalët “komunë”, “kryetar komune”, “këshill komune”, hiqen.”* http://www.parlament.al/web/pub/ligj_nr_31_dt_2_4_2015_21836_1.pdf.

⁸³ Për më shumë shih Deklaratën e KVV “Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, mungesë transparence dhe ndryshime të paligjshme të akteve të miratuara më parë” në <http://zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-Deklarate-KQZ-JoTransparenceENdryshimeTePaligjshmeVendimeshTeMiratuara-16-04-2015.pdf>.

- d) *Numri i Qëndrave të Votimit me një numër nga 1 deri në 20 zgjedhës*
Në ekstraktin e datës 16 Mars 2015 kanë qenë 242 QV, në ekstraktin e datës 14 Prill 2015 kanë qenë 96 QV dhe në ekstraktin përfundimtar janë 0 QV.

Sipas të dhënave zyrtare të MPB-së lidhur me numrin e zgjedhësve në lista rezultojnë se:

- a) *Lista e shtetasve 100 vjeç të pa përfshirë në lista*
Në ekstraktin e datës 16 Mars 2015 kanë qenë 1.123 shtetas, në ekstraktin e datës 14 Prill 2015 kanë qenë 1.020 shtetas dhe në ekstraktin përfundimtar janë 978 shtetas.
- b) *Lista zgjedhësve me numër banimi 000 888 999*
Në ekstraktin e datës 16 Mars 2015 kanë qenë 312.457 zgjedhës, në ekstraktin e datës 14 Prill 2015 kanë qenë 301.558 shtetas, dhe në ekstraktin përfundimtar janë 300.506 shtetas
- c) *Të papërfshirë në lista (për shkak të QV me numër zgjedhësish jashtë limitit)*
Në ekstraktin e datës 16 Mars 2015 kanë qenë 9.759 zgjedhës, në ekstraktin e datës 14 Prill 2015 kanë qenë 6.960 shtetas, dhe në ekstraktin përfundimtar janë 0 shtetas.
- d) *Numri total i zgjedhësve të përfshirë në lista*
Në ekstraktin e datës 16 Mars 2015 kanë qenë 3.363.814 zgjedhës, në ekstraktin e datës 14 Prill 2015 kanë qenë 3.365.111 shtetas, dhe në ekstraktin përfundimtar janë 3.370.206 shtetas.

Procesi i saktësimi të qendrave të votimit dhe listës përfundimtare të zgjedhësve u shoqërua me bllokimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në pjesën më të madhe të zyrave të gjendjes civile pranë NJQV-ve.

Një problem shqetësues në këndvështrimin e KVV-së, janë QV-të e posaçme që duhet të ngrihen në IEVP (Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale) dhe numrin e zgjedhësve në secilën prej tyre, për të cilat informacioni nuk është i plotë.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme duhet t'i kishin kushtuar një vëmendje më të lartë realizimit të këtij procesi, nëpërmjet nxjerrjes së udhëzimeve konkrete në lidhje me ushtrimin e të drejtës së votës për shtetasit që ndodhen duke vuajtur dënimin në IEVP.

D.3. NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) kanë një rol të rëndësishëm në përgatitjen e procesit zgjedhor, rëndësi që konsiston në procesin e hartimit, saktësimi dhe shpalljes së listave të zgjedhësve si dhe në përcaktimin e Qëndrave të Votimit (QV) si dhe të vendeve që do të shërbejnë si QV ditën e zgjedhjeve.

Në lidhje me ecurinë e punës së NJQV-ve në procesin e hartimit dhe shpalljes së listave deri në muajin mars, KVV është shprehur në Raportin e Parë të Ndërmjetëm të Monitorimit⁸⁴.

Në ecurinë e mëtejshme të procesit, përsa i përket shpalljes dhe saktësimit të listave të zgjedhësve, KVV ka vërejtur se disa prej NJQV-ve⁸⁵ nuk e kanë përmbushur detyrimin ligjor për shpalljen e ekstraktit zgjedhor të datës 14 Prill 2015.

Gjithashtu, për të përmbushur detyrimin ligjor të hartimit dhe saktësimit të ekstraktit përfundimtar të zgjedhësve (data 11 Maj 2015), në pjesën më të madhe të NJQV-ve u pezulluan të gjitha shërbimet ndaj qytetarëve në zyrat e gjendjes civile për 1 deri në 2 ditë.

Propozimet e kryetarëve të NJQV-ve, janë bërë shpesh objekt debati në KQZ, për parregullsitë dhe vonesat në propozimet e tyre për qendrat e votimit që do të vendoseshin në ambiente private.

Mungesa e propozimeve alternativave të dyta sikurse parashikon ligji, kanë orientuar KQZ drejt vendimmarrjeve jo të ligjshme, duke qenë se disa prej QV-ve në adresa private⁸⁶ të miratuara nga KQZ janë më pak se 30 m². Po ashtu, për disa propozime në KQZ është ngritur pretendimi se adresat e QV-ve të propozuara⁸⁷ ishin në pronësi të punonjësve të NJQV-së.

Gjithashtu, sipas diskutimeve në KQZ, nga disa kryetarë të NJQV-ve janë propozuar objekte private për vendosjen e QV-ve ndërkohë që nuk ka munguar mundësia e vendosjes së tyre në ambiente publike.

Të gjitha këto çështje kanë shtyrë dhe vështirësuar procesin për KQZ, e cila është detyruar të bëjë verifikim në terren për çdo rast, megjithatë nuk kanë munguar edhe raste kur QV janë vendosur në shtëpi private⁸⁸.

E. LISTAT DHE IDENTIFIKIMI I ZGJEDHËSVE

Shqipëria shkon në zgjedhje me një numër total prej 3.370.206 zgjedhës, të cilët janë të përfshirë në listën përfundimtare të zgjedhësve.

Sipas legjislationit Shqiptar institucionet kryesore përgjegjëse për realizimin e procesit të hartimit, saktësimit dhe publikimit të listave të zgjedhësve janë: Ministria e Brendshme (MB), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ).

⁸⁴ Për më shumë informacion në lidhje me Njësitë e Qeverisjes Vendore mund t'i referoheni Raportit I të Ndërmjetëm të Monitorimit të KVV, fq. 27-28, publikuar më 30 Mars 2015, tek: <http://zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-RaportiNdermjetemMonitorimi-I-ZgjedhjeLokale2015-30Mars2015.pdf>

⁸⁵ Bashkitë: Cërrik, Devoll, Has, Peqin dhe Shkodër.

⁸⁶ QV nr. 20461 Komuna Paskuqan – 24 m², QV nr. 20462 Komuna Paskuqan - 24 m², QV nr. 2046 Komuna Paskuqan – 25 m², QV nr. 1191 Komuna Kastriot - 26 m², QV nr. 2338 Bashkia Elbasan – 28 m² etj.

⁸⁷ QV nr. 1578, QV nr. 1578/1, QV nr. 1582 dhe QV nr. 1582/1 Bashkia Kamëz.

⁸⁸ QV nr. 3043 Komuna Kutë.

Referuar datës së shpalljes së datës së zgjedhjeve nga presidenti i Republikës, listat paraprake të zgjedhësve duhet të shpallëshin në datat: 14 janar 2015, 13 shkurt 2015, 15 mars 2015 dhe 14 Prill 2015. Lista përfundimtare e zgjedhësve shpallet në datën 11 Maj 2015. Kjo listë publikohet edhe në faqet zyrtare të internetit të Ministrisë së Brendshme dhe Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

KQZ, sipas nenit 50 pika 3 të Kodit Zgjedhor, mbikqyr procesin e hartimit të listave të zgjedhësve dhe ndarjen e tyre në qendra votimi.

Megjithëse institucion i ngarkuar nga ligji, për menaxhimin e procesit zgjedhor, KQZ ka patur një rol jo aktiv në procesin e monitorimit të hartimit të listave. Megjithatë KVV përgëzon vullnetin e shprehur prej këtij institucioni, në përmbushje të detyrimit që i njeh ligji, për t'ia kaluar çështjen e lëvizjeve të dyshimta në listat e zgjedhësve, organit të prokurorisë, pas raportimit të njërit prej auditëve teknikienë.

Shpallja e ekstrakteve zgjedhore dhe publikimi i listës finale

Në lidhje me shpalljen e tre ekstrakteve të parë zgjedhorë dhe ecurinë e tyre KVV është shprehur në Raportin e Parë të Ndërmjetëm⁸⁹ të Monitorimit të situatës parazgjedhore.

KVV ka vazhduar monitorimin e procesit të afishimit të listave të zgjedhësve, edhe për ekstraktin e datën 14 Prill 2015.

Pas monitorimit rezultoi se një pjesë e madhe e NJQV-ve⁹⁰ e kishin publikuar ekstraktin e datës 14 Prill, ndërsa disa NJQV⁹¹ nuk kishin publikuar një ekstrakt të ri. Si rrjedhojë e një ngarkese shumë të lartë, për hartimin e listave përfundimtare të zgjedhësve, në shumë Zyra të Gjendjes Civile (ZGJC) pranë njërive të qeverisjes vendore u pezulluan shërbimet për 1 – 2 ditë me arsyetimin se ishin duke punuar për përgatitjen e listave të zgjedhësve.

Pas publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve, në datën 11 Maj 2015, nëse zgjedhësit vërejnë se ka pasaktësi në të dhënat e tyre apo në qoftë se ata nuk figurojnë në lista, atëherë ata duhet t'i drejtohen gjykatës⁹² deri në datën 19 Qershor 2015.

Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Brendshme numri total i zgjedhësve të përfshirë në listën përfundimtare të zgjedhësve është 3.370.206 zgjedhës nga 3.272.828. që kanë qenë në ekstraktin e datës 14 Janar 2015.

Ndërkohë që numri i zgjedhësve të papërfshirë në lista për shkak të qendrave të votimit jashtë limit në ekstraktin përfundimtar është 0 pavarësisht se ky numër në publikimin e ekstraktit të parë të datës 14 janar 2015 ka qenë 105.129 zgjedhës.

Shtetas mbi moshën 100 vjeç të papërfshirë në lista janë 978 nga 1.288 që kanë qenë në ekstraktin e datës 14 Janar 2015.

Numri i zgjedhësve me kod banimi 000 888 999 (persona me kod banese të panjohur) është 300.506 zgjedhës nga 333.681 që ka qenë në ekstraktin e datës 14 janar 2015.

⁸⁹ Për më shumë informacion në lidhje me hartimin dhe publikimin e 3 ekstrakteve të parë zgjedhorë mund t'i referoheni Raportit I të Ndërmjetëm të Monitorimit të KVV, fq. 30-33, publikuar më 30 Mars 2015, tek: <http://zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-RaportiNdermjetemMonitorimi-I-ZgjedhjeLokale2015-30Mars2015.pdf>

⁹⁰ Bashkitë: Berat, Bulqizë, Delvinë, Dibër, Dropull, Durrës, Elbasan, Fier, Fushë-Arrëz, Gjirokastrë, Gramsh, Kavajë, Këlcyrë, Klos, Kolonjë, Konispol, Krujë, Kuçovë, Kurbin, Libohovë, Librazhd, Livadhja, Lushnjë, Malësi e Madhe, Mallakastër, Mat, Mirditë, Patos, Përmet, Përrenjas, Pogradec, Pukë, Rrogozhinë, Roskovec, Sarandë, Selenicë, Shijak, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Tropojë, Ura Vajgurore, Vau i Dejës dhe Vlorë.

⁹¹ Bashkitë: Cërrik, Devoll, Has, Peqin e Shkodër.

⁹² Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012), Neni 57 “Vendimet gjyqësore pas hartimit të listës së zgjedhësve, pika 1.

Numri i personave të dyshuar si të dubluar në listën përfundimtare të zgjedhësve është 1.193 zgjedhës, ndërkohë që ka qenë 3.900 zgjedhës në ekstraktin e datës 14 Janar 2015.

Përfshirja në lista e personave që janë duke vuajtur dënimin në IEVP

Në këndvështrimin e KVV një problem shqetësues, i cili meriton vëmendjen e institucioneve përkatëse, është ushtrimi i të drejtës për të votuar nga personat që janë duke vuajtur dënimin në Institucione e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), qofshin këto burgje apo paraburgime.

Për këtë kategori qytetarësh, ligji parashikon ngritjen e Qendrave të Votimit të Posaçme, të cilat ngrihen brenda institucionit të vuajtjes së dënimit.

Përpara nxjerrjes së ekstraktit përfundimtar të listave të zgjedhësve, nga Drejtoritë përkatëse të Burgjeve në bashkëpunim me NJQV-të, duhet të ishte realizuar procesi i pasqyrimin të emrave të të gjithë të dënuarve me të drejtë vote në çdo IEVP në listat e votuesve të QV-ve që duhet të ngriheshin pranë çdo IEVP-je dhe rrjedhimisht, në ZGJC në territorin e së cilës ndodhet IEVP-ja.

Sipas Kodit Zgjedhor, institucione të posaçme⁹³ quhen burgjet, vendet e paraburgimit dhe spitalet.

Referuar të dhënave zyrtare të publikuara në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) për muajin Prill 2015, rezulton se në Shqipëri janë duke vuajtur dënimin⁹⁴ 2.848 persona të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, dhe 2.851 persona në paraburgim⁹⁵ në pritje të vendimit të gjykatës.

Duke përjashtuar 102 persona të mitur (nën moshën 18 vjeç), rezultojnë 5.597 persona që janë të privuar nga liria, të cilët do të ushtrojnë të drejtën e votës në institucionin e vuajtjes së dënimit, përfshirë në këtë numër edhe të dënuarit që iu është hequr me vendim gjykatë e drejta për të votuar.

Në gjithë territorin e vendit janë 22 IEVP⁹⁶.

Ndërkohë, nga 5299 Qendra Votimi në total, 20 prej tyre janë Qendra Votimi të Posaçme⁹⁷.

⁹³ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012), Neni 2 “Përkufizime” pika 2 “Institucione të posaçme janë burgjet, vendet e paraburgimit, si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se tri ditë.”

⁹⁴ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. *Gjendja dhe ndarja e të dënuarve – Prill 2015.* <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=521>

⁹⁵ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. *Gjendja dhe ndarja e të paraburgosurve – prill 2015.* <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&m=shfaqart&gj=gj1&aid=521>

⁹⁶ Këto IEVP janë: IEVP “Mine Peza” Tiranë, IEVP “Jordan Misa” Tiranë i cili aktualisht është zhvendosur në Fier për shkak të rikonstruksionit, IEVP Elbasan, IEVP Berat, IEVP Vlore, IEVP Sarandë, IEVP Burrel, IEVP Vaqar, IEVP “Ali Demi” Tiranë, IEVP Lushnjë, IEVP Peqin, Institucioni i Veçantë Shëndetësor i Burgjeve, Instituti i të Miturve në Kavajë, IEVP Fushë-Krujë, IEVP Korçë, IEVP Lezhë, IEVP Rrogozhinë, IEVP Tropojë, IEVP Kukës, IEVP Durrës, IEVP Krujë dhe IEVP Tepelenë.

⁹⁷ Konkretisht QV 3278 në Bashkinë Berat - Komisariati me 67 zgjedhës; QV 0938/2 në Bashkinë Mat - Burgu Burrel me 200 zgjedhës; QV 1422/2 në Bashkinë Durrës - I.E.P.V.D Durrës me 32 zgjedhës; QV 1274 në Bashkinë Krujë - Burgu me 30 zgjedhës; QV 1292/1 në Bashkinë Krujë - F.Krujë, Blloku Nr. 1 me 38 zgjedhës; QV 2391 në Bashkinë Elbasan - Palestra e paraburgimit IEVP Elbasan me 202 zgjedhës; QV 2565/1 në Bashkinë Belsh - Kosove+Burgu me 112 zgjedhës; QV 3079/3 në Bashkinë Patos Lagia '29 Marsi' - Shkolla 'Zhani Ciko' me 464 zgjedhës; QV 4383/1 në Bashkinë Tepelenë - Klasa e edukimit burgu Bëncë me 124 zgjedhës; QV 3707/1 në Bashkinë Korçë - Drenovë Burgu me 404 zgjedhës; QV 0636/1 në Bashkinë Kukës - Drejt. Burgjeve. IEVP. Kukës me 33 zgjedhës; QV 0637/1 në Bashkinë Kukës - Shtëpia e Oficerëve me 81 zgjedhës; QV 0748/1 në Bashkinë Lezhë - I.E.V.P (Burgu) Shënkoll me 100 zgjedhës; QV 1680 në Bashkinë Tiranë - Shtëpia e të Moshuarve me 48 zgjedhës; QV 1690 në Bashkinë Tiranë -

Sipas të dhënave zyrtare të DPB-së, në muajin Prill 2015 janë 5.597 shtetas me të drejtë vote të privuar nga liria, ndërkohë që numri total i zgjedhësve në 20 QV- të e posaçme që figurojnë në listën finale të zgjedhësve është 2.620 zgjedhës. Për rrjedhojë, diferenca prej rreth 2.977 zgjedhës, ngelet e papërfshirë në lista.

Pas kontakteve me drejtuesit e IEVP-ve në të gjithë vendin, duket se ka mospërputhje⁹⁸ midis numrit të shtetasve që janë duke vuajtur dënimin në IEVP të caktuara dhe numrit të shtetasve të përfshirë në listën e zgjedhësve për të njëjtën IEVP.

Gjithashtu, në disa IEVP nuk rezulton të jenë ngritur QV të posaçme⁹⁹.

Drejtuesit e IEVP-ve deklarojnë se ka patur një udhëzim nga DPB-ja që fillimisht të përfshiheshin në listën e votuesve vetëm ata shtetas që janë duke vuajtur dënimin në IEVP që ndodhen në juridiksionin e NJQV-së ku ata kanë vendbanimin. Kjo ka sjellë që numri i zgjedhësve për atë IEVP të jetë më i vogël se 15 zgjedhës, çka është kriter ligjor për ngritjen e një QV-je.

DPB-ja , Ministria e Drejtësisë (MD) si dhe KQZ-ja duhet të angazhohen për sqarimin dhe qartësimin e situatës si dhe garantimin e të drejtës për të votuar të këtyre shtetasve, duke ngritur QV të posaçme në çdo institucion që përcakton ligji si “institucion të posaçëm”, si dhe duke marrë të gjithë masat e nevojshme me anë të ndjekjes së procesit në gjykatë.

Gjithashtu, sjellim në vëmendje edhe ngritjen e qendrave të posaçme të votimit pranë institucioneve të kujdesit shëndetësor si spitalet. Në detyrim të ligjit, drejtoritë e këtyre institucioneve duhet të angazhohen për krijimin e lehtësive të nevojshme që edhe pacientëve në këto institucione t’iu jepet mundësia për të votuar.

Është detyrim i KQZ-së të marrë rol aktiv për të detyruar institucionet përgjegjëse dhe mbikqyrur këtë proces në mënyrë që t’i sigurojë çdo qytetari të drejtën për të votuar dhe për të shprehur vullnetin e tij.

Raportet e auditive teknicienë¹⁰⁰

Burgu me 101 zgjedhës; QV 1811 në Bashkinë Tiranë Pranë Q.S.U.T. Tirane - Instituti i Veçantë Shëndetësor i të Burgosurve me 25 zgjedhës; QV 1967 në Bashkinë Tiranë - Burgu 302 me 202 zgjedhës; QV 2113 në Bashkinë Tiranë – Vaqar Burgu me 187 zgjedhës; QV 4451 në Bashkinë Vlorë - Paraburgimi me 116 zgjedhës; QV 4678 në Bashkinë Sarandë - Paraburgimi Sarandë me 54 zgjedhës.

⁹⁸ Konkretisht në IEVP Vlorë ndodhen 140 shtetas me të drejtë vote ndërkohë që në listën e zgjedhësve për QV që do të ngrihet në këtë institucion (QV nr. 4451) janë 116 zgjedhës; në IEVP Korçë ndodhen 470 shtetas (260 të burgosur dhe 210 të paraburgosur) me të drejtë vote ndërkohë që në listën e zgjedhësve për QV që do të ngrihet në këtë institucion (QV nr. 3707) janë 404 zgjedhës; në IEVP Tepelenë ndodhen 259 shtetas (135 të burgosur dhe 124 të paraburgosur) me të drejtë vote ndërkohë që në listën e zgjedhësve për QV që do të ngrihet në këtë institucion (QV nr. 4383) janë 124 zgjedhës.

⁹⁹ Konkretisht mungojnë: *IEVP Lushnjë* ku janë duke vuajtur dënimin 240 shtetas, IEVP Peqin ku janë duke vuajtur dënimin 830 shtetas të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë dhe 20 shtetas në pritje të gjykimit, IEVP Rrogoshinë ku janë duke vuajtur dënimin 199 shtetas të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë dhe 222 shtetas në pritje të gjykimit, IEVP Tropojë ku janë duke vuajtur dënimin 24 shtetas. Për IEVP Tropojë juristja ka konfirmuar se të dënuarit do të çohen nga institucioni në QV-të ku kanë vendbanimin, por në çdo rast për shtetasit që kanë vendbanimin afër IEVP-së.

¹⁰⁰ Për shkak të pamundësisë së pasjes në kohë të këtyre raporteve KVV do të adresojë në raportin final problematikën që mund të pasqyrojnë ato.

Për realizimin e detyrimit ligjor që ka të bëjë me mbikqyrjen e hartimit të listave të zgjedhësve, KQZ emëroi në datën 18 Shkurt 2015 dy auditët teknikienë.

Auditët detyrohen nga Kodi Zgjedhor të përgatisim raporte auditimi mujore dhe t'i paraqesin pranë KQZ-së, duke e ndihmuar atë në përmbushjen e detyrimit për mbikqyrjen sa më të mirë dhe të plotë të procesit të saktësisimit dhe hartimit të listave të zgjedhësve, si dhe të veprimeve të bëra në bazën e të dhënave të RKGJC-së.

Këta auditë kanë realizuar përkatësisht nga dy raportime periodike, që nga momenti i emërimit të tyre nga KQZ dhe raportet e tyre pasi janë dëgjuar dhe diskutuar në KQZ, i janë përcjellë Ministrisë së Brendshme.

Në datën 4 Maj 2015, auditi Armand Teliti prezantoi pranë KQZ-së një raport i cili ngrinte shqetësimin për një numër jo normal të lëvizjeve të zgjedhësve drejt Bashkisë së Durrësit.

Sipas tij *“nga ekstrakti i marsit deri ne ekstraktin e prillit 2015, ka një shtesë prej 774 votuesish, ndërkohë që për periudhën 12-27 prill 2015 rritja është 1412 votues, duke çuar në total numrin e zgjedhësve të regjistruar në Durrës në 2186 në më pak se dy muaj. Kjo shifër është rreth 7 herë me e madhe se mesatarja mujore e hyrjeve në Bashkinë e Durrësit. Në total në Bashkinë Durrës janë 230.000 zgjedhës.”*

Raporti i auditit nuk ishte mjaftuar vetëm në konstatimin e shifrave, por edhe në kontrollin e praktikave përkatëse në bazë të cilave ishte bërë ndryshimi i vendbanimeve të zgjedhësve, praktika të cilat rezultonin me probleme të respektimit të dispozitave të ndryshme ligjore.

KQZ pasi dëgjoi dhe diskutoi në lidhje me raportin e auditit vendosi me 5 vota pro dhe 2 kundër, që këtë çështje t'ia kalonte për verifikime të mëtejshme Prokurorisë.

Është për t'u theksuar se vendimi për këtë çështje ende mungon në faqen e internetit të KQZ-së, çka bie ndesh me detyrimin ligjor për ta publikuar atë brenda 24 orëve.

Lidhur me këtë çështje, KVV ka publikuar një deklaratë¹⁰¹ ku përshëndeti këtë vendim të KQZ-së dhe të përfaqësuesve të partive politike në KQZ.

Ky fenomen nuk është i panjohur, madje duhet thënë se veçanërisht për zgjedhjet vendore janë përdorur skema të tilla manipulimi edhe më parë, por ky rast është i vetmi që provohet zyrtarisht, shqyrtohet dhe merret seriozisht në konsideratë prej KQZ-së dhe përcillet për hetime të mëtejshme tek organi i Prokurorisë.

Pikërisht për këtë fakt, KVV shpreh domosdoshmërinë që partitë politike të mbështesin punën hetimore të Prokurorisë për të çuar deri në fund hetimin dhe nxjerrjen para drejtësisë të të gjithë personave përgjegjës lidhur me këtë çështje, duke ndëshkuar këdo individ pavarësisht peshës politike, sipas legjislacionit në fuqi.

¹⁰¹ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (2015). Deklaratë *“Realizimi i standarteve për ecurinë e procesit zgjedhor në periudhën e mbetur deri ditën e zgjedhjeve, kërkon kontributin e të gjithë aktorëve institucionalë si edhe të vetë subjekteve elektorale”*, datë 16 Maj 2015. Për më shumë tek: www.zgjedhje.al ose tek Shtojca 2 e këtij raporti.

F. REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE KANDIDATËVE

Subjekte zgjedhore në zgjedhjet e datës 21 qershor janë partitë politike (të grupuara në koalicione ose jo) me kandidatët e propozuar dhe mbështetur prej tyre si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Kodi zgjedhor përcakton afat të fundmë për regjistrimin e partive politike në KQZ datën 12 Prill 2015¹⁰². Ndërkohë afati i fundit për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore ishte data 22 prill 2015¹⁰³.

Për Zgjedhjet Vendore regjistrimi i kandidatëve¹⁰⁴ duhet të bëhet jo më vonë se data 2 maj 2015 në Komisionin Zonal të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) që mbulon Njësinë përkatëse të Qeverisjes Vendore (NJQV) (Bashkinë), ose në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) në qoftë se Bashkia mbulohet nga më shumë se një Zonë Administrimi Zgjedhor (ZAZ).

Ky afat u shty nga KQZ në datën 4 Maj 2015 ora 18.00, nëpërmjet një deklarate publike të këtij institucioni, duke qenë se datat 1, 2 dhe 3 Maj përkonin me ditë pushimi zyrtar.

Kodi Zgjedhor parashikon në pjesën IV të tij procedurat për regjistrimin e kandidatëve për kryetar të NJQV-ve si dhe për anëtarë të Këshillave të këtyre njësive. Regjistrimi i tyre bëhet nga partia politike përkatëse. Kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiakë regjistrohen me lista të mbyllura të cilat depozitohen paraprakisht pranë KZAZ-ve apo KQZ-së.

Kodi Zgjedhor parashikon gjithashtu edhe të drejtën e kandidimit të kandidatëve të pavarur të cilët për t'u regjistruar si subjekt në garë, duhet të sigurojnë paraprakisht mbështetjen nga një numër zgjedhësish prej jo më pak se 1% të listës së zgjedhësve që përmban NJQV-ja (bashkia), por në çdo rast jo më pak se 50 prej tyre¹⁰⁵.

Kandidati i pavarur duhet të regjistrohet jo më vonë se data 4 maj 2015 nga një Komitet Nismëtar prej jo më pak se 9 zgjedhësish nga bashkia përkatëse. Ky komitet duhet të

¹⁰² Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012), Neni 64 “Regjistrimi i partive politike në zgjedhje”, pika: “1. Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve.” http://www.parlament.al/web/pub/kodi_zgjedhor_i_azhornuar_pdf_web_15174_1.pdf.

¹⁰³ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012), Neni 65 “Regjistrimi i koalicioneve zgjedhore”, pika: “1. Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.” http://www.parlament.al/web/pub/kodi_zgjedhor_i_azhornuar_pdf_web_15174_1.pdf.

¹⁰⁴ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr. 74/2012]. Neni 67 “Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive”, pika: “1. Partia politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumëemërore të kandidatëve të saj për çdo zone zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësive të qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.

¹⁰⁵ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012), Neni 70 “Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”. http://www.parlament.al/web/pub/kodi_zgjedhor_i_azhornuar_pdf_web_15174_1.pdf.

regjistrohej në KZAZ-në përkatëse ose, për analogji në zbatimin e ligjit, në KQZ në qoftë se bashkia mbulohet nga më shumë se një ZAZ, jo më vonë se data 18 prill 2015¹⁰⁶.

Në lidhje me aftin e datës 4 Maj 2015, KQZ gjatë zhvillimit të mbledhjes së asaj date, nëpërmjet kryetares bëri një deklaratë për shtyrjen e afatit nga ora 18.00 në orën 24.00. Kjo deklaratë krijoi konfuzion, pasi nuk ishte e qartë situata nëse KQZ morri apo jo një vendim në lidhje me këtë çështje dhe a iu përcoll zyrtarisht KZAZ-ve ky njoftim. Diçka e tillë u reflektua edhe në punën e KZAZ-ve tek të cilat u krijua konfuzion në lidhje me orën në të cilën mbaronte afati i regjistrimit.

Me ndarjen e re administrative-territoriale dhe zgjerimin e Bashkive, në Kodin Zgjedhor krijohet një disbalancë mes regjistrimit të kandidatëve të mbështetur nga partitë politike jo-parlamentare dhe kandidatëve të pavarur.

Në të dy rastet parashikohet kriteri i mbështetjes prej 1% të zgjedhësve në njësinë vendore ku do të konkurrohet, por në rastin e kandidatëve të partive politike vendoset një tavan prej 3000 zgjedhësish firmëtarë¹⁰⁷, ndërkohë që për kandidatët e pavarur nuk parashikohet asnjë tavan¹⁰⁸ për numrin e firmëtarëve mbështetës.

Gjatë konsultimit të zhvilluar në Komisionin e Ligjeve, KVV i kërkoi Kuvendit që si domosdoshmëri e reformës administrative-territoriale, ky i fundit duhet të rregullonte kuadrin ligjor që lidhet me detyrimin për mbledhjen e nënshkrimeve nga kandidatët e propozuar nga partitë politike që garojnë jashtë koalicioneve, por që kanë mandat (si parti) në këshillat e bashkive apo komunave të vendit referuar ndarjes aktuale administrative.

Kjo pikë e Kodit Zgjedhor¹⁰⁹ duhet të zgjidhej nga Kuvendi, pasi drejtuesit aktualë të bashkive apo komunave apo anëtarët e këshillave bashkiakë a komunalë e kanë fituar mandatin e tyre qeverisës bazuar në një njësi më të vogël administrative dhe si rrjedhim nuk zotërojnë automatikisht mbështetjen e të gjithë zgjedhësve të njësisë së re administrative.

Kuvendi nuk e morri në konsideratë një ndryshim të tillë, duke ia lënë përgjegjësinë për zgjidhjen e rasteve, tashmë referuar ndarjes së re administrative-territoriale, Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

¹⁰⁶ Vendim nr. 87 datë 4 Prill 2015 “Për miratimin e afateve për ngritjen e KZAZ-ve dhe depozitimin e dokumentacionit të kandidimit në KZAZ dhe KQZ nga Grupet Nismëtare, për zgjedhjet për Organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015, si pasojë e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor”.

¹⁰⁷ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012), Neni 68, pika: “2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3 000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës.”
http://www.parlament.al/web/pub/kodi_zgjedhor_i_azhornuar_pdf_web_15174_1.pdf.

¹⁰⁸ Po aty, Neni 70, pika: “3. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë apo komunës vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod.”

¹⁰⁹ Po aty, Neni 70, pika: “4. Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse janë kryetarë bashkie apo komune, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputetë. Në këtë rast kandidati paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit”.
http://www.parlament.al/web/pub/kodi_zgjedhor_i_azhornuar_pdf_web_15174_1.pdf.

Ky i fundit, me miratimin e vendimit nr. 88 datë 7 Prill 2015, krijoi edhe më shumë çoroditje duke qenë se ndryshe u votua dhe ndryshe u zbardh përmbajtja e këtij vendimi.

Në lidhje me këtë çështje KVV është shprehur në deklaratën¹¹⁰ e datës 16 Prill 2015.

Çështja u shqyrtua nga Kolegji Zgjedhor, i cili rrëzoi vendimmarrjen e KQZ referuar vendimit nr. 88 datë 7 Prill 2015, por pa e shfuqizuar këtë vendim. Kjo situatë reflektoi akoma më shumë paqartësi se si do të ishte standardi që do të përdorte KQZ-ja në vazhdim.

63 parti politike do të jenë pjesë e zgjedhjeve të 21 Qershorit. 52 prej tyre janë të grupuara në dy koalicione të mëdha [37 Partia Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASHE) dhe 15 parti Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjtet (APPD)], ndërkohë që 9 parti do të garojnë jashtë koalicioneve.

Në fletën e votimit do të shfaqen vetëm 61 parti politike, pasi 2 parti¹¹¹ nuk kanë depozituar lista për anëtarë të këshillave bashkiakë.

Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASHE) është regjistruar nga KQZ me vendimin nr. 176 datë 27.04.2015, ndërsa Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjtet (APPD) është regjistruar nga KQZ me vendimin nr. 177 datë 27.04.2015.

Në zgjedhjet lokale të datës 21 qershor 2015, do të garojnë gjithsej 162 kandidatë për kryetarë bashkie, 120 kandidatë të mbështetur nga dy koalicionet e mëdha¹¹², 27 kandidatë të mbështetur nga parti politike që garojnë jashtë koalicioneve¹¹³ dhe 15 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit¹¹⁴.

¹¹⁰ Për më shumë shih Shtojcën 1 të këtij Raporti.

¹¹¹ Partia Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare dhe Partia Për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë.

¹¹² 61 kandidatë përfaqësojnë Koalicionin APPD; 59 kandidatë përfaqësojnë Koalicionin ASHE (ky koalicion nuk do të ketë kandidatë në bashkitë Finiq dhe Dropull).

¹¹³ Ramiz Oboni kandidat për kryetar në Bashkinë Kuçovë mbështetur nga Partia Fronti Majtë; Dik Spata kandidat për kryetar në Bashkinë Dibër mbështetur nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut; Mehmet Rakipi kandidat për Bashkinë Shijak mbështetur nga Partia Aleanca Popullore; Shefki Çota kandidat në Bashkinë Librazhd mbështetur nga Aleanca Popullore; Artur Topi kandidat për Bashkinë Përrenjas mbështetur nga Partia Socialdemokrate; Albert Çaçi kandidat për Bashkinë Fier mbështetur nga Partia Socialdemokrate; Vangjel Ngjelo kandidat për Bashkinë Dropull mbështetur nga Partia MEGA; Kostaq Ziso kandidat për Bashkinë Dropull mbështetur nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut; Hazbi Kasaj kandidate për kryetar në Bashkinë Këlcyrë mbështetur nga Partia PMDPSH; Arjan Zeqaj kandidat për kryetar në Bashkinë Memaliaj mbështetur nga Partia PMDPSH; Albert Malaj kandidat për kryetar në Bashkinë Memaliaj mbështetur nga Partia Socialdemokrate; Shpëtim Bega kandidat për kryetar në Bashkinë Përmet mbështetur nga Partia Fronti Majtë; Gëzim Ibrahim kandidat për kryetar në Bashkinë Përmet Partia Socialdemokrate; Paqësor Cane kandidat për kryetar në Bashkinë Kolonje mbështetur nga Partia Socialdemokrate; Gëzim Ukperaj kandidat për kryetar në Bashkinë Has mbështetur nga Partia Socialdemokrate; Ardian Hysa kandidat për kryetar në Bashkinë Malësi e Madhe mbështetur Partia Socialdemokrate; Vullnet Elbasani kandidat për kryetar në Bashkinë Shkodër mbështetur nga Partia LDVMP; Arben Hajdini kandidat për kryetar në Bashkinë Rrogozhinë mbështetur nga Partia Socialdemokrate; Sazan Guri kandidat për kryetar në Bashkinë Tiranë mbështetur nga Partia Aleanca Ekologjike Europiane; Arben Tafaj kandidat për kryetar në Bashkinë Tirane mbështetur nga Partia LDVMP; Dhimitër Muslia kandidat për kryetar në Bashkinë Tiranë mbështetur nga Partia KristianDemokrate; Leonidha Hristo kandidat për kryetar në Bashkinë Finiq mbështetur nga Partia MEGA; Jani Babi kandidat për kryetar në Bashkinë Finiq mbështetur nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut; Dhionisio Beleri kandidat për kryetar në Bashkinë Himarë mbështetur nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut; Anastas Guda kandidat për kryetar në Bashkinë Konispol mbështetur nga Partia Bashkimi për të

Kandidatët e pavarur mund të garojnë jo vetëm për të qenë kryetarë bashkie por edhe për anëtarë të këshillave bashkiakë.

Në këto zgjedhje kandidatë të pavarur të propozuar nga zgjedhësit për anëtarë të këshillave bashkiake janë dymbëdhjetë¹¹⁵ në të gjithë vendin.

KQZ, pavarësisht angazhimit të saj të shprehur për të vendosur kushte të barabarta të gjithë kandidatët, qofshin këta të propozuar nga partitë politike apo të propozuar nga zgjedhësit. Por, me vendimmarrjen e saj, qoftë me vendimin 88 datë 7 Prill 2015 qoftë me vendimin 144 datë 14 Prill 2015 për miratimin e manualit të KZAZ-së (ku përfshihet paraqitja e certifikatës personale, apo pasaktësi të tjera lidhur me modelet e kandidimit), ka ndikuar në stepjen e kandidatëve për tu bërë pjesë e garës elektorale.

Në lidhje me kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, neni 71 pika 3 i Kodit Zgjedhor¹¹⁶, përcakton verifikimin e nënshkrimeve mbështetëse të paraqitura nga kandidatët, nga KQZ apo KZAZ.

Në lidhje me këtë çështje Kodi është i paplotë, pasi lë evazive mënyrën se si do të realizohet ky verifikim dhe metodologjinë konkrete që duhet të përdoret nga administrata përkatëse (KQZ apo KZAZ).

Në asnjë prej arsytimeve apo vendimeve të KQZ për regjistrimin e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit nuk jepen detaje mbi numrin konkret të firmave të vlefshme (që përmbushin kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor) në mbështetje të kandidatit. Pra ka një zbritje aritmetike të nënshkrimeve që rezultojnë të pavlefshme apo ka një shtrirje të tyre sipas një kampionimi të bërë që në nisje të procesit.

Drejtat e Njeriut; Niko Kuri kandidat për kryetar në Bashkinë Sarandë mbështetur nga Partia MEGA; Adem Hoxha kandidat për kryetar në Bashkinë Sarandë mbështetur nga Partia Socialdemokrate.

¹¹⁴ Ilir Bulku - Bashkia Dibër; Besjon Tafani - Bashkia Belsh; Hristo Duci - Bashkia Dropull; Bujar Fezga - Bashkia Këlcyrë; Orgen Hasanbeg - Bashkia Memaliaj; Astrit Dervishi - Bashkia Memaliaj; Lulzim Meçi - Bashkia Memaliaj; Dritan Memushi - Bashkia Tepelenë; Llazi Deti - Bashkia Pogradec; Agron Demushi - Bashkia Tropojë; Gjergj Bojaxhi - Bashkia Tiranë; Vladimir Kumi - Bashkia Himarë; Fatmir Shero - Bashkia Konispol; Alma Golemaj - Bashkia Selenicë; Vasil Bedinaj - Bashkia Vlorë.

¹¹⁵ Gjergj Paluca - Bashkia Kamëz; Luan Fufi - Bashkia Mirditë; Gjon Pjetri - Bashkia Mirditë; Agim Kaçani - Bashkia Korçë; Gjergj Ndreca - Bashkia Lezhë; Armando Gjoka - Bashkia Kukës; Ilirjan Sadiku - Bashkia Elbasan; Lavdrim Shehu - Bashkia Kukës; Agim Gjoni - Bashkia Dibër; Astrit Ademi - Bashkia Dibër; Madalena Nikolli - Bashkia Mirditë; Edmond Ndoj - Bashkia Kamëz.

¹¹⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 71, pika 3 “Procedura e mbledhjes së nënshkrimeve”, pika: “3. Verifikimi i nënshkrimeve për zgjedhjet për Kuvendin kryhet nga administrata e KQZ-së dhe për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kryhet nga KZAZ-ja përkatëse, duke verifikuar 5 për qind të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit, nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit. Pas verifikimit

administrata paraqet një raport të detajuar mbi mangësitë e konstatuara. Raporti shqyrtohet në seancë publike, në prani të palës së interesuar. KQZ-ja vendos për pranimin ose refuzimin e listës mbështetëse. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve mbështetëse, duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të parregullta, është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas këtij Kodi.”

¹¹⁷ http://www.parlament.al/web/pub/kodi_zgjedhor_i_azhornuar_pdf_web_15174_1.pdf.

G. FUSHATA E PARAKOHSHME ZGJEDHORE

Nisja e parakohshme e fushatës zgjedhore

Sipas projektit ACE¹¹⁷ “Fushata zgjedhore është një proces sipas të cilit një subjekt elektoral (qoftë parti, kandidat apo organizatë që ka një interes të veçantë [në çështjen që votohet]) kërkon mbështetje elektorale në garën për të fituar një post politik¹¹⁸”.

Pra çdo aktivitet politik i kryer në periudhën para zgjedhjeve dhe që synon të ndryshojë qëndrimin e votuesve në favor të një kandidati, partie politike a subjekti zgjedhor të çfarëdo lloji mund të konsiderohet si fushatë zgjedhore.

Koncepti i fushatës zgjedhore është i ndryshëm në vende të ndryshme, në shumë vende nuk ka një limit kohor për zhvillimin e fushatës, ndërkohë që shumë të tjerë e kanë të përcaktuar në ligjin zgjedhor periudhën në të cilën fushata mund të zhvillohet.

Në legjislacionin e disa vendeve përcaktohet biles edhe një periudhë heshtjeje zgjedhore (përgjithësisht një deri në dy ditë përpara ditës së zgjedhjeve), gjatë së cilës çdo aktivitet elektoral është i ndaluar dhe zgjedhësit kanë kohë të reflektojnë mbi ofertat politike dhe të vendosin për cilën do të votojnë pa qenë nën efektin e komunikimit politik.

Shqipëria bën pjesë në grupin e vendeve që e kanë të përcaktuar qartë me ligj se cila është periudha gjatë së cilës subjektet zgjedhore mund të kryejnë fushatë.

Neni 77 “Periudha e fushatës dhe e heshtjes zgjedhore”, pika 1 thotë shprehimisht: “Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve”.

Pavarësisht se Kodi Zgjedhor e kufizon periudhën e fushatës në muajin e fundit përpara ditës së zgjedhjeve, fushatat zgjedhore në Shqipëri si rregull fillojnë përpara afatit të përcaktuar në ligj, në kundërshtim me këtë të fundit.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 fushata zgjedhore nisi prej janarit, pothuajse gjashtë muaj përpara ditës së zgjedhjeve¹¹⁹.

Në këto zgjedhje, nuk u vu re një nisje kaq e herët e fushatës, megjithatë, sërish fushata zgjedhore u nis në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, veçanërisht përsa u përket kandidatëve të dy koalicioneve më të mëdha që garojnë, “Aleanca për Shqipërinë Europiane” (ASHE) dhe “Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet” (APPD), drejtuar respektivisht nga Partia Socialiste dhe Partia Demokratike.

Të dyja këto aleanca kanë prezantuar kandidatët e tyre përpara publikut të gjerë së paku një muaj përpara datës zyrtare në të cilën duhej të niste fushata zgjedhore¹²⁰, dhe sidomos

¹¹⁷ Projekti ACE është një bazë të dhënash online që ofron informacion të gjithanshëm mbi proceset zgjedhore që ka nisur të operojë prej vitit 1998. ACE është një përpjekje e përbashkët e nëntë organizatave: Instituti për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore (IDEA), Instituti Zgjedhor për Demokraci të Qëndrueshme në Afrikë (EISA), Elections Canada, Instituti Kombëtar Zgjedhor i Meksikës (INE), Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), The Carter Center, Departamenti për Çështjet Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara (UNDESA), Pogrami i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Divizioni për Asistencë Zgjedhore i Departamentit të Çështjeve Politike në Kombet e Bashkuara (UNEAD).

¹¹⁸ ACE Project – The electoral knowledge network. <https://aceproject.org/ace-en/topics/pc/pc/pc08>.

¹¹⁹ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (2013). Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013 – Raporti I i Ndërmjetëm i Monitorimit, Seksioni F: Fushata Zgjedhore, fq. 28. <http://zgjedhje.al/uploads/File/KVV%20-%20Raport%20I%20-%2018Mars2013.pdf>.

pas regjistrimit zyrtarisht në datën 4 maj 2015, të kandidatëve të bërë publik që më parë prej forcave të tyre politike.

Të tjerë elementë, tipikë për një fushatë zgjedhore (duke iu referuar përkufizimit të mësipërm) janë vënë re nga kandidatët e të dyja këtyre koalicioneve, të tilla si:

- Kandidatët u kanë kërkuar zgjedhësve të votojnë për ta,
- Kanë kërkuar të mos votojnë për kandidatët konkurrentë,
- Kanë bërë premtime në lidhje me çfarë ata do të realizojnë për zgjedhësit nëse do të zgjidhen¹²¹.

Në këto kushte mund të thuhet se fushata zgjedhore nisi jashtë afateve ligjore edhe në këtë raund zgjedhor.

Pasqyrimi i fushatës zgjedhore nga media

Media e ka transmetuar gjerësisht fushatën e parakohshme zgjedhore gjatë gjithë muajit të fundit, pavarësisht se jashtë afateve ligjore dhe pavarësisht thirrjes së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ndaj partive politike dhe ndaj mediave për të ndaluar fushatën e parakohshme, bërë në 5 maj 2015, pasi në rast të kundërt do të merreshin masa ndaj tyre¹²².

Koalicioni e ka vlerësuar këtë nismë të KQZ në deklaratën e bërë publike më datë 6 Maj 2015 si dhe angazhimin e tri televizioneve informative (ABS News, News 24 dhe Ora News) për të mos transmetuar asnjë aktivitet zgjedhor deri në momentin e nisjes së fushatës ligjorisht.

Fatkeqësisht, kjo iniciativë e KQZ ndaloi aty, fushata zgjedhore vazhdoi me të njëjtin intensitet nga të dyja Koalicionet kryesore dhe mediat (përfshi tri televizionet e sipërpërmendur) vazhdoi t'i transmetonte ato në kohë reale dhe duke përdorur sinjalin e prodhuar nga vetë partitë apo kasetat e gatshme, madje edhe tekstin që duhet të lexohej gjatë dhënies së lajmit në shumë raste.

Përdorimi i burime publike në fushatë

Një nga shqetësimet më të mëdha në fushatat zgjedhore në Shqipëri është abuzimi me burimet publike për qëllime elektorale, të tilla si përdorimi i mjeteve financiare apo logjistike nga kandidatët që përfaqësojnë forcat politike në pushtet.

Kjo vlen si për kandidatë në nivel lokal si në nivel qëndror.

KVV ka vlerësuar nismën e Kryeministrit Rama i cili më 4 maj 2015 nxori Urdhrin nr. 67 “Për marrjen e masave për zbatimin e ndalimit të vënies në përdorim të subjekteve

¹²⁰ Kosova, Veliaj dhe Duma shkelin kodin zgjedhor , nisin fushatën 37 dite përpara, Gazeta Sot, 03-05-2015, fq. 9; Kosova bashkëbisedon me studentë, Gazeta Mapo, 23-04-2015, fq. 4; Mero: sfida per Korçën duhet te jete ndryshimi, Gazeta Mapo, 27-04-2015, fq. 6; Rama ne fushate me Veliaj, prezantojne projektligjin per zejtarine, Gazeta Sot, 29-04-2015, fq. 4; Ilir Meta çel fushaten: votoni kunder bllokades Berisha-Basha. Te largojm Bashën qe braktisi qytetaret, Gazeta Sot, 05-05-2015, fq. 2.

¹²¹ Rama: Veliaj do bejë për Tiranen me shume se sa eshte bere ne 20 vjet, Gazeta Mapo, 29-04-2015, fq. 4; Kosova: investime ne cerdhe, investim per te ardhmen e qytetit, Gazeta Mapo, 29-04-2015, fq. 5; Kosova: Program per tregtaret e fermeret qe te shtojn vendet e punes, Gazeta Mapo, 04-05-2015, Fq. 4; Basha thirrje qytetareve te mos votojne kandidatet e Ps: asnje vote trafikanteve, Gazeta Sot, 01-05-2015, fq. 10.

¹²² Balkanweb, 5.5.2015. KQZ: Partitë politike të ndalojnë fushatën, po shkelin Kodin Zgjedhor. Mediat të mos I transmetojnë aktivitetet. <http://www.balkanweb.com/site/kqz-partite-te-ndalojne-fushaten-po-shkelin-kodin-zgjedhor-mediat-te-mos-i-transmetojne-aktivitetet/>.

zgjedhore të mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë publike, për Zgjedhjet e Organeve të Pushtetit Vendor të datës 21 Qershor 2015¹²³, por konstaton se pavarësisht vullnetit të shprehur me anë të këtij urdhri, burimet publike janë shfrytëzuar gjatë kësaj periudhe në ndihmë të fushatës së kandidatëve të ASHE në shumë raste.

Si të tilla mund të përmenden inaugurimet nga ana e qeverisë dhe prania e kandidatëve të Aleancës për Shqipërinë Europiane nga zyrtarë të lartë të shtetit në këto aktivitete, prania e ministrave apo të tjerë zyrtarëve të nivelit të lartë në takime ku janë të pranishëm edhe kandidatët, etj¹²⁴.

Prania e kandidatëve në takime me zyrtarë të shtetit ku theksohen arritjet e qeverisë krijon qartas një disbalancë në fushatë duke qenë se u jep avantazh të padrejtë kandidatëve që vijnë nga maxhoranca¹²⁵.

Një shqetësim tjetër është se kur në të tilla aktivitete marrin pjesë vetë ministrat, indirekt ato influencojnë në pjesëmarrjen në to të nëpunësve të institucioneve në varësi apo të vartësve të vet.

Rasti i denoncuar nga Partia Demokratike, Dega Shkodër, ku janë fotografuar në një shkollë të Malësisë së Madhe postera dhe flamuj të kandidatës së ASHE znj. Bazhdari, çka u verifikua edhe nga vëzhguesit e KVV, përbën një shkelje tjetër lidhur me institucionet arsimore¹²⁶.

Premtimet elektorale

Një shqetësim tjetër në lidhje me fushatën e parakohshme zgjedhore të zhvilluar deri në këtë moment janë premtimet elektorale të kryera nga kandidatët apo drejtuesit e partive politike respektive.

Ajo çka mund të nënvizohet si një shqetësim shumë i mprehtë është pretendimi nga ana e kandidatëve të ASHE se nëse votohen kandidatët e ASHE, bashkitë përkatëse do të

¹²³ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (2015). *Deklaratë – Realizimi i standardeve për ecurinë e procesit zgjedhor në periudhën e mbetur deri ditën e zgjedhjeve, kërkon kontributin e të gjithë aktorëve institucionalë si edhe të vetë subjekteve elektorale*. Për më shumë shih Shtojcën 2 në këtë Raport.

¹²⁴ Kryeministri Rama dhe Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës kanë marrë pjesë në një takim në Malësinë e Madhe për inspektimin e punimeve të ujësjellësit gjatë të cilit Kryeministri Rama deklaroi: “Dhe ndërkohë të ecim përpara me projekte që na çojnë në drejtimin e duhur dhe që njerëzit e Malësisë Madhe, Shkodrës, këtij qarku duhet të na japin një ndihmë duke vendosur në krye të këtyre punëve kandidatët tanë.”, *OraNews*, 04-05-2015, <http://www.oranews.tv/vendi/malesia-e-madhe-zgjidh-problemin-e-ujit-rama-votoni-kandidatet-tane/>; Ditën e dorëzimit të dorëheqjes së tij, Kandidati I ASHE për Tiranën, Veliaj duke folur ende në pozitën e Ministrit të Mirëqenies Sociale në një takim me stafin e tij ka bërë premtime elektorale: “Veliaj premtoi se Bashkia e Tiranës nuk do të jetë një bashki që nuk hap qendra rinore, “Do të gjeni një bashki që ju inkurajon dhe ju bashkëfinancon”, - deklaroi Veliaj gjatë një takimi me zyrtarët e ministrisë pasditen e së enjtes në kryeqytet”, *Veliajn jep dorëheqjen tek Rama, zbardh mesazhin e nënës për Parlamentin: tani do ta ndjek për Linditën; Rama shpendan 1001 tapi ne Tirane:kur voton ne drejtimin e duhur merr ate qe kerkon me voten tende*, *Gazeta Zëri I Popullit*, 8-05-2015, fq. 3.

¹²⁵ Një rast flagrant në këtë drejtim përbën shpërndarja e lejes së legalizimeve në Sauk prej kandidatit të ASHE për Bashkinë Tiranë, Veliaj në datë 20 maj 2015. Shpërndarja e lejeve të legalizimeve nga kandidati për Kryetar Bashkie, në prezencën e drejtorit të ALUIZNI-t është totalisht e pajustificuar dhe një shkelje e hapur e rregullave të barazisë në fushatë - *Veliaj shpërndan leje legalizimi në Sauk: Ne i rrimë në kokë punës*, *Gazeta Dita*, 20.05.2015, <http://www.gazetadita.al/veliaj-shperndan-leje-legalizimi-ne-sauk-ne-i-rrime-ne-koke-punes/>.

¹²⁶ *Zgjedhjet 2015, PD denoncon: Shkolla në Bërdicë zyrë elektorale për Keti Bazhdarin*, *Gazeta Mapo*, 16-05-2015, <http://www.mapo.al/2015/05/zgjedhjet-2015-pd-denoncon-shkolla-ne-berdice-zyre-elektorale-per-ke-ti-bazhdarin>.

përfitojnë mbështetje dhe investime nga qeveria ndërsa në të kundërt do të mbeten prapa përsa u përket investimeve¹²⁷.

Pavarësisht se e racionalizuar me faktin se kandidatët e zgjedhur nga APPD nuk do të kërkojnë bashkëpunimin e qeverisë, nga votuesit lehtësisht kjo mund të perceptohet si një kërcënim se nëse nuk votojnë për kandidatët e ASHE do të jetë qeveria që do të bllokojë investimet për bashkitë e tyre.

Në këto kushte kjo mënyrë të komunikuarit përbën një tjetër shkelje të rregullave të barazisë dhe një kërcënim ndaj zgjedhësve për ndëshkim në rast të votimit kundër kandidatëve të mbështetur nga maxhoranca qeverisëse.

Nga ana tjetër, fushata e kandidatëve të APPD, në takimet e të cilëve ka marrë pjesë kryetari i opozitës, z. Basha fokusohet në premtime që nuk qëndrojnë pasi ato kanë lidhje me qeverisjen qendrore dhe aspak me atë lokale për të cilat zhvillohen edhe këto zgjedhje.

Në të gjitha takimet elektorale ku ka marrë pjesë z. Basha ka premtuar ulje taksash apo rritje të vendeve të punës apo të tjera premtime që lidhen me qeverisjen qendrore dhe jo në funksion të premtimeve lokale¹²⁸.

Incidente

Pavarësisht se fushata ende nuk ka nisur zyrtarisht dhe është në fazat e para nuk kanë munguar incidentet, çka përbën shqetësim për përshkallëzim të mundshëm të situatës ndërkohë që dita e zgjedhjeve afrohet.

Nuk kanë munguar incidentet deri në këtë moment, ndër të cilët mund të përmendet incidenti në Durrës ku një person që shoqëronte kandidaten e APPD, Duma u godit prej dy personave që lëviznin me një makinë me flamuj të Partisë Socialiste¹²⁹, incidenti në Malësi të Madhe ku dy persona u shpallën në kërkim nga policia për një incident të ndodhur gjatë një takimi elektorale¹³⁰, apo edhe incidenti në Ersekë kur një person tentoi të godiste me karrige kryetarin e opozitës Basha gjatë një takimi elektorale¹³¹.

Një tjetër fenomen shqetësues që pasqyrohen në faqet e mediave të shtypit dhe portaleve online janë akuzat e paprovuara për blerje votash të ngritura deri në këtë moment, si ajo e

¹²⁷ Na duhen kryetarë bashkish që ditë-natë të punojnë bashkë me ne, Gazeta Zëri i Popullit, 12.05.2015, http://www.zeri-popullit.com/index.php?option=com_content&view=article&id=8283:na-duhen-kryetare-bashkish-qe-dite-nate-te-punojne-bashke-me-ne&catid=71:kryesore&Itemid=124.

¹²⁸ Basha prezanton Alibeajn në Fier: Taksë e sheshtë 9%, Gazeta Panorama, 18-05-2015, <http://www.panorama.com.al/basha-prezanton-alibeajn-ne-fier-takse-e-sheshte-9/>.

¹²⁹ Ditën e premtje, datë 1 maj 2015 rreth orës 18.30, kandidatja e koalicionit opozitar "Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet" znj. Grida Duma ka qenë duke kryer takime me qytetarët në zonën e Shkozetit. Dy të rinj, përkatësisht Xh.K. dhe J.B. që lëviznin në mënyrë të përsëritur rreth vendtakimit me një makinë "Alfa Romeo" ngjyrë gri më targë AA960IR dhe me një flamur të PS, janë konfliktuar me një nga shoqëruesit e kandidatës, aktivistin e Partisë Demokratike, përkatësisht me të riun E.S. të birin e kryetarit të Partisë Demokratike të Durrësit z. O.S. Konflikti degjeneroi në goditje me grushta dhe me sende të forta, prej të cilave E.S. është detyruar të marrë ndihmën e nevojshme mjekësore pranë Spitalit të Durrësit. Një ditë më pas policia ka shoqëruar dy autorët Xh.K dhe J.B, të cilët pas kryerjes së veprimeve të para hetimore prej policisë janë liruar dhe po hetohen në gjendje të lirë.

¹³⁰ Incidenti në Malësi të Madhe, PD: Rama po i ushtron presion elektoratit. Reagojnë blutë e Shkodrës, Balkanweb, 10-05-2015, <http://www.balkanweb.com/site/incidenti-ne-malesi-te-madhe-pd-rama-po-ushtron-presion-elektoratit-reagojne-blute-e-shkodres/>.

¹³¹ PD publikon fotot në Kuvend: Incidenti në Ersekë skenar i Ramës, Telegraf, 07-05-2015, <http://www.telegrafi.com/lajme/pd-publikon-fotot-ne-kuvend-incidenti-ne-erseke-skenar-i-rames-78-13977.html>.

ngritur ndaj LSI në Shkodër se po ofrohen kuponë për blerje në një dyqan veshjesh me vlerë 5,000 lekë¹³², etj.

Ajo çka vihet re është se prokuroria është treguar pasive ndaj hetimit të këtyre incidenteve.

Pavarësisht se nuk ka denoncime zyrtare në prokurori, prokuroria në zbatim edhe të marrëveshjes së nënshkruar me KQZ-në dhe në zbatim të detyrimit ligjor duhet të tregohet e vëmendshme ndaj këtyre lajmeve që publikohen në media apo ndaj çdo sinjali tjetër të këtij lloji, duke hapur çështje hetimore dhe duke i shkuar deri në fund zbardhjes së të vërtetës.

Një rol më proaktiv i prokurorisë është mëse i domosdoshëm për të ndihmuar në rikthimin e besimit të qytetarëve në institucione, duke mos lejuar të krijohet një klimë frike apo tensioni zgjedhor, apo një klimë mosbesimi në procesin e ardhshëm zgjedhor si pasojë e perceptimit për një prani të natyrshme të korrupsionit apo të fenomenit të blerjes së votave.

H. MEDIA

Ngritja dhe funksionimi i Bordit të Monitorimit të Medias (BMM)

Sipas Kodit Zgjedhor, data 2 prill 2015 ishte afati i fundit për ngritjen e Bordit të Monitorimit të Mediave (BMM) nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve¹³³ (KQZ).

Procedura e ngritjes së BMM-së e përcaktuar në Nenin 85/1 të Kodit¹³⁴ nxit përfshirjen e ekspertëve të medias, të propozuar nga organizata të shoqërisë civile, në një proces thelbësor për garantimin e barazisë në garë gjatë procesit zgjedhor, monitorimin e pasqyrimin të fushatës zgjedhore prej mediave audio-vizive private dhe shtetërore.

Në ndryshim nga zgjedhjet e fundit parlamentare të viti 2013, KQZ, nëpërmjet një procesi transparent, kërkoi publikisht depozitimin e kandidaturave për anëtarë të BMM-së nga organizata të shoqërisë civile (Organizata JoFitimprurëse – (OJF)) që operojnë në fushën e medias deri më datën 25 Mars 2015, sipas afatit të parashikuar në ligj.

Brenda këtij afati u paraqitën vetëm kandidaturat prej një organizatë ndërkohë që deri në datën 15 prill 2015 tre organizata të tjera kanë depozituar kërkesa, pavarësisht se jashtë afatit zyrtar (nga të cilat njëra nga organizatat nuk legjitimohet pasi nuk është njoftuar zyrtarisht prej KQZ-së duke qenë se nuk operon në fushën e medias)¹³⁵.

¹³² Ekskluzive, LSI blen vota me xhinse, Civitas, 12-05-2015, <http://ëëë.civitas.al/al/politike/ekskluzive-lsi-blen-vota-me-xhinse-foto>.

¹³³ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. (Ligj Nr.10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr.74/2012]. Neni 85 “Monitorimi i fushatës zgjedhore”, pika 1 “KQZ-ja, 40 ditë përpara fillimit të fushatës zgjedhore, ngre Bordin e Monitorimit të Medias, i cili ka për detyrë monitorimin e zbatimit të dispozitave të këtij Kodi për fushatën zgjedhore në radion dhe televizionin publik dhe ato private.”

¹³⁴ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. (Ligj Nr.10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr.74/2012]. Neni 85/1 “Mënyra e formimit të Bordit të Monitorimit të Medias”.

¹³⁵ Nga komunikimi zyrtar me KQZ-në, deri në datë 15 prill kanë depozituar kandidaturat e tyre këto organizata: 1) “BIRN Albania” (3 kandidatë), propozim i protokolluar në KQZ në datën 26 Shkurt 2015; “Rrjeti i Gazetarëve Shqiptar të Politikës” (1 kandidat), propozim i protokolluar në KQZ në datën 1 Prill 2015; “Forumi i Mendimit të Lirë” (1 kandidat), propozim i protokolluar në KQZ në datën 7 Prill 2015, si dhe “Qendra Vullnetare e Emergjencave Civile” (1 kandidat), propozim i protokolluar në KQZ në 15 Prill 2015. Numri i kandidatëve nuk është totalisht i saktë pasi në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga

Një nga arsyet për numrin e ulët të kandidaturave, sipas KQZ, është pasaktësia e adresave zyrtare të tyre të regjistruara në gjykatë¹³⁶.

Në mungesë të propozimeve dhe në pamundësi për të njoftuar xx OJF, në datën 8 mars 2015 KQZ-ja iu kërkoi nëpërmjet një njoftimi publik¹³⁷ organizatave që operojnë në fushën e medias që të paraqesin kandidaturat e tyre për BMM.

Në mbledhjen e datës 6 maj 2015, KQZ vendosi ngritjen e BMM-së.

Ajo çka vërehet është se kandidaturat e propozuara nga anëtarët e KQZ për këtë organ janë të gjitha të paraqitura pas afatit final për dorëzimin e kandidaturave, ndërkohë që asnjë prej organizatave, kandidaturat e të cilave janë paraqitur për miratim nga anëtarët e KQZ-së, nuk janë në listën e organizatave që KQZ-ja ka marrë prej Gjykatës së Tiranës dhe që ka njoftuar zyrtarisht për të paraqitur kandidaturat e tyre¹³⁸.

Në Raportin e Parë të Ndërmjetëm të Monitorimit të publikuar më datën 30 Mars 2015, KVV i rekomandoi KQZ-së që, pavarësisht se Kodi Zgjedhor e parashikon si të drejtë ekskluzive të çdo anëtari të KQZ-së për të përzgjedhur prej kandidaturave të propozuara, me synimin për të rritur besimin dhe garantuar një funksionim sa më asnjës dhe objektiv të BMM-së, anëtarët e saj të angazhoheshin “për të arsyetuar publikisht vendimin e tyre për përzgjedhjen e anëtarëve të BMM-së apo, për një procedurë akoma më transparente, anëtarët e rinj të BMM-së të përzgjidheshin me short pasi kriteret bazë për kualifikimin e tyre si anëtarë të BMM-së të ishin kontrolluar dhe një përzgjedhje paraprake të ishte kryer”.

Koalicioni e konsideron të pamjaftueshëm, rolin dhe veprimtarinë e KQZ-së në ngritjen e këtij organi shumë të rëndësishëm, ndërkohë që konstaton se sërish procedura për emërimin e tyre ishte jo-transparente, çka rrit gjasat që edhe në raundet e ardhshme zgjedhore të ketë mosbesim dhe hezitim nga ana e organizatave që operojnë në fushën e medias për të paraqitur kandidatura, duke qenë se anëtarët e KQZ në asnjë moment nuk

KQZ-ja janë fshirë emrat e kandidatëve të propozuar, duke e justifikuar si mbrojtje e të dhënave personale, çka në vetvete është një justifikim i pa bazë dhe jo ligjor.

¹³⁶ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (2015). Raport i Ndërmjetëm Monitorimi I (10 Janar – 26 Mars 2015), fq. 39. <http://zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-RaportiNdërmjetëmMonitorimi-I-ZgjedhjeLokale2015-30Mars2015.pdf>.

¹³⁷ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (2015). Njoftim për shtyp, datë 08.03.2015. <http://www2.cec.org.al/sq-al/Kreu/ID/238/Njoftim-per-shtyp-08032015>.

¹³⁸ Emrat për anëtarë të BMM të paraqitur prej secilit anëtar të KQZ dhe miratuar (anëtarët e BMM) janë si më poshtë: “Znj. Lefterije Luzi, Kryetare i paraqet KQZ për miratim si anëtar BMM, z. Basir Çollaku, propozuar nga Shoqata e Sociologëve Universitar Shqipëtar me shkresën nr. 3141, datë 28.04.2015;

Z. Denar Biba Zv/Kryetar i paraqet KQZ-së për miratim si anëtar BMM z. Florian Seriani propozuar nga Qendra Kulturore Mediatike Antigona, me shkresën nr. 3971, datë 04.05.2015;

Zj. Edlira Jorgaqi, anëtare, i paraqet KQZ-së për miratim si anëtar BMM z. Maklen Misha propozuar nga Forumi Shqipëtar për Mediat e Lira me shkresën nr. 3972, datë 04.05.2015;

Z. Gëzim Veleshnja anëtar i paraqet KQZ-së për miratim si anëtar BMM z. Vilson Kuçi, propozuar nga Qendra Kulturore Mediatike Antigona me shkresën nr. 3400, datë 02.05.2015;

Z. Hysen Osmanaj i paraqet KQZ për miratim si anëtar BMM, z. Andon Andoni, propozuar nga Shoqata e Sociologëve Universitar Shqipëtar me shkresën nr. 3141, datë 28.04.2015;

Z. Klement Zguri i paraqet KQZ për miratim si anëtar BMM, zj. Klarita Bajraktari, propozuar nga Shoqata e Sociologëve Universitar Shqipëtar me shkresën nr. 3141, datë 28.04.2015;

Zj. Vera Shtjefni i paraqet KQZ për miratim si anëtar BMM, z. Rexhep Polisi propozuar nga Shoqata e Sociologëve Universitar Shqipëtar me shkresën nr. 3141, datë 28.04.2015” – Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Vendim nr. 211, datë 06.05.2015. <http://www2.cec.org.al/sq-al/Legjislacioni/Aktet-e-KQZ-s%C3%AB/Vendimet/Vendimet-2015>.

arsyetuan kandidaturat e paraqitura apo të ndërmerrnin ndonjë hap tjetër për rritjen e transparencës apo se si arritën në këtë vendimmarrje.

Nuk është e qartë se mbi ç'bazë KQZ-ja vendosi të merrte në konsideratë kandidaturat e propozuara nga organizata të cilave nuk iu është dërguar njoftim zyrtar për të bërë të tilla propozime dhe aq më pak mbi ç'bazë u vendos të merreshin në konsideratë propozimet e protokolluara pas afatit të fundit të përcaktuar në ligj.

Nuk ekziston asnjë vendim i KQZ për shtyrjen e afatit i cili të përcaktonte se deri në ç'datë do të mundeshin OJF-të të dorëzonin propozime për BMM-në, ndërkohë që KQZ si një organ kolegjal i kishte të gjitha mundësitë që, në kushtet kur numri i propozimeve të sjella deri në ditën e afatit të fundit nuk ishte i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha pozicionet, të merrte dhe të luante një rol më proaktiv, duke diskutuar situatën dhe duke marrë një vendim për zgjidhjen e ngërçit të krijuar.

KQZ-ja ka treguar pasivitet total në zgjidhjen e kësaj çështje, duke u mjaftuar vetëm me dy njoftimet publike në të cilat u bën thirrje organizatave që operojnë në fushën e mediave të sillnin propozime dhe duke ndenjur në pritje të këtyre propozimeve, pavarësisht kalimit të afatit për ngritjen e BMM-së dhe afrimit të fillimit të fushatës zgjedhore.

Pasqyrimi i fushatës zgjedhore nga mediat

Edhe në këtë raund zgjedhor, forcat politike e nisën fushatën zgjedhore përpara afatit zyrtar, në shkelje të Kodit Zgjedhor i cili parashikon se “Fushata zgjedhore nis 30 ditë para datës së zgjedhjeve¹³⁹”, veçanërisht përfaqësuesit e dy koalicioneve më të mëdha që garojnë në këto zgjedhje, “Aleanca për Shqipërinë Europiane” dhe “Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet”, drejtuar respektivisht nga Partia Socialiste dhe Partia Demokratike.

Mediat e shkruara dhe ato elektronike janë duke e pasqyruar gjerësisht fushatën e kandidatëve të të dy koalicioneve, pavarësisht se kjo fushatë është në shkelje të ligjit zgjedhor dhe pavarësisht thirrjes publike të Kryetares së KQZ-së, Znj. Luzi të bërë qoftë ndaj partive politike për të ndërprerë fushatën që është duke u kryer në shkelje të ligjit, qoftë ndaj mediave që të mos i transmetojnë këto aktivitete në të kundërt ndaj tyre do të merren masa.

Sjellim këtu në vëmendje se çdo veprimtari fushate zgjedhore që pasqyrohet në media jashtë afatit 22 maj -19 qershor 2015 është jashtë monitorimit të BMM-së dhe vëzhgimit të KQZ-së.

Koalicioni, në Deklaratën e bërë publike më datën 6 maj 2015, e përgëzoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për këtë iniciativë si dhe vlerësoi vullnetin e shprehur nga tri televizionet informative Ora News, News 24 dhe ABC News për të mos transmetuar aktivitetet elektorale deri në datën e nisjes zyrtare të fushatës zgjedhore.

Por ajo çka vihet re është se fatkeqësisht situata nuk ndryshoi aspak pas kësaj thirrjeje të kryetares së KQZ-së dhe të gjitha mediat në vend vazhdojnë të transmetojnë aktivitetet elektorale të kandidatëve të ndryshëm.

¹³⁹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012), Neni 77 “*Periudha e fushatës dhe e heshtjes zgjedhore*”, pika 1 “*Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve.*”

Veçanërisht problematike është situata për sa iu përket televizioneve informative, të cilat i paraqesin takimet elektorale të kandidatëve në kohë reale dhe të plota.

Transmetimi nga mediat i informacioneve të përgatitura nga partitë politike

Një tjetër problem, prezent edhe gjatë fushatës për zgjedhjet e fundit parlamentare është fenomeni i transmetimit të takimeve elektorale nga televizionet duke përdorur sinjalin e prodhuar nga vetë shtabet elektorale me anë të regjisë qendrore apo kasetat informative të përgatitura po prej tyre me zë dhe figurë dhe që thjesht transmetohen nga media, duke i kthyer këto të fundit thjesht në përçuese të informacionit të përgatitur.

Biles, në fushatën e fundit elektorale mediat shpesh nuk janë lejuar të përdorin kamerat e tyre dhe janë detyruar të përdorin sinjalin qendror apo kasetat e gatshme të shtabeve elektorale.

Në këto zgjedhje, deri tani, nuk ka informacion për episode në të cilat mediat të kenë kërkuar të jenë prezent dhe të mos jenë lejuar të filmojnë vetë.

Një nga rekomandimet e KVV-së në Raportin Final të Monitorimit për Zgjedhjet Parlamentare të 23 Qershorit 2013 ishte që partitë politike të detyroheshin të dorëzonin kasetat filmike të papërpunuara tek mediat në rastet kur mediat e kërkonin këtë¹⁴⁰, ndërsa rekomandimet e OSBE/ODIHR përfshinin detyrimin e mediave që t'i transmetonin materialet e gatshme vetëm pasi të vendosnin një shënim të qartë se materiali ishte i përgatitur nga partitë politike, pra të identifikoheshin qartë si material propagandistik dhe jo si material informativ i prodhuar nga vetë media¹⁴¹.

Si pasojë e mosndërmarrjes së reformës zgjedhore, rekomandimet e OSBE/ODIHR të vitit 2013 nuk u trajtuan, ndërkohë që KQZ-ja, e cila mund të merrte një vendim në këtë drejtim nuk ndërmori një hap të tillë të paktën deri tani.

Gjuha dhe etika në media

Gjuha e përdorur nga media gjatë pasqyimit të aktiviteteve elektorale (dhe jo vetëm) ka një rëndësi të veçantë.

Përdorimi i gjuhës fyese, sulmeve personale ndaj kandidatëve apo gjuhës së urrejtjes ndikon negativisht në polarizimin e situatës politike dhe në ndarje fiktive të zgjedhësve bazuar në një mentalitet “ne” kundër “atyre”, mentalitet i cili nuk është i shëndetshëm për asnjë shoqëri e aq më pak për shoqëritë në tranzicion ku pasionet politike mund të krijojnë premisat për konflikte politike.

Gjuha e përdorur nga mediat në vend gjatë periudhës së mbuluar në këtë raport ka qenë përgjithësisht e balancuar me përjashtim të disa mediave të cilat përdorin gjuhë fyese¹⁴².

¹⁴⁰ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (2013). *Raport Përfundimtar i Vëzhgimit për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 23 Qershor 2013*, Fq. 124. <http://zgjedhje.al/uploads/File/KVV%20-%20Raport%20Përfundimtar%20i%20Vëzhgimit-Zgjedhje2013%20-%2027%20Shtator2013.pdf>.

¹⁴¹ Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (2013), *Raport Përfundimtar për Zgjedhjet parlamentare 2013*, fq. 28, <http://www.osce.org/sq/odihr/elections/108194?download=true>.

¹⁴² Më të spikaturat në këtë drejtim mund të përmenden Gazeta “Rilindja Demokratike” e cila i referohet vazhdimisht në shkrimet e saj kandidatit të “Aleancës për Shqipërinë Europiane” për Bashkinë Tiranë, z. Erion Veliaj si “Zogu i Ramës” (shih p.sh. shkrimin e datës 19 maj 2015, “Zogu i Ramës premton se do të ndërtojë çdo muaj 4 shkolla dhe 2 kopshte” - http://www.rilindjademokratike.com/index.php?option=com_content&view=article&id=18895%3A2015-05-19-22-58-34&catid=58%3Alajme-kyce&Itemid=105; Gazeta “55”, (shih p.sh. shkrimin e datës 21 prill 2015 “Zoti Veliaj, kompjuterët e vjedhjeve dhe të eksodit, do i prishësh apo do i marrësh me vete?” -

Nisma e Aleancës së Grave Deputete për mediat online

Veçanërisht problematike paraqitet situata e gjuhës së përdorur përsa u përket mediave *online* të cilat mundësojnë komentimin nga përdoruesit në artikujt e tyre. Pavarësisht se gjuha e përdorur nga vetë mediumi mund të jetë neutrale, shpesh vërehet përdorimi i epiteteve fyese e denigruese nga komentuesit.

Një pjesë e konsiderueshme e mediave të cilat mundësojnë këtë shërbim, vendosin për përdoruesit një paralajmërim në të cilin u kërkojnë atyre të mos përdorin gjuhë fyese apo sulme personale, por jo rrallë komentet sërish shkojnë në drejtim fyese.

Ndërkohë administratorët e faqeve nuk marrin masa për fshirjen e komenteve apo bllokimin e përdoruesve të cilët bëjnë të tilla komente.

Në frymën e shqetësimit të mësipërm, vlen të përmendet iniciativa e *Aleancës së Grave Deputete*, në emër të cilave deputetja Znj. Majlinda Bregu dorëzoi në Kuvend një nisëm ligjore për amendimin e Kodit Civil, e cila synon të eliminojë çdo koment që cënon nderin, personalitetin apo reputacionin e një personi.

Pavarësisht se në parim shqetësimi i ngritur nga propozueset e projekt-ligjit mund të qëndrojë, fakti që projekt-ligji nisët nga një vendim i *Gjykatës së Strasburgut*, i cili nuk përbën një bazë të saktë¹⁴³ dhe se theksi vendoset tek sanksionet ndaj administratorëve të mediave, krijon një shqetësim në lidhje me keqpërdorimin e këtij ligji dhe në shtimin e autocensurës nga ana e mediave *online*.

Projekt-ligji në fjalë është debatuar me ekspertë të fushës përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues të medias dhe të institucioneve të pavarura që monitorojnë mediat në dy tryeza dhe është aktualisht në shqyrtim nga Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut¹⁴⁴.

Në kushtet kur mediat online janë një nga mënyrat më të aksesueshme të komunikimit nga qytetarët të cilët nuk gjejnë vend në mediat tradicionale (në këtë kuptim mund rikujtojmë faktin se mediat tradicionale përdorin kaseta të prodhuara nga partitë politike, çka e limiton akoma më shumë hapësirën për këndvështrimin e qytetarëve) ky projekt-ligj ngre shumë pikëpyetje duke qenë se terminologjia e përdorur lë shumë hapësirë për interpretim.

Se çfarë ekzaktësisht është një koment që cënon nderin dhe personalitetin e një individi nuk është gjithnjë e lehtë të përkufizohet qartë dhe si rrjedhim shumë media *online* mund të ndëshkohen nga gjykatat e të mbyllen përballë presionit apo të praktikojnë autocensurë.

Në fund, argumenti kryesor kundër këtij projekt-ligji, duke lënë mënjanë objektin i cili vërtet meriton vëmendje, është momenti kur shtrohet për diskutim, pra në prag të fushatës elektorale.

<http://gazeta55.al/zoti-veliaj-kompjuteret-e-vjedhjeve-dhe-te-eksodit-do-i-prishesh-apo-do-i-marresh-me-vete/>.

¹⁴³Rasti Delfi kundër Estonisë - [http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-126635#{"itemid":\["001-126635"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-126635#{).

¹⁴⁴ Kuvendi I Shqipërisë (2015). Procesverbal i mbledhjes së datës 28.04.2015 të Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. http://www.parlament.al/web/pub/28_04_2015_22289_1.pdf

Edhe duke e marrë të mirëqenë saktësinë dhe rregullimin më të mirëmenduar që mund të ketë projekt-ligji, momenti kur shtrohet si propozim e zhbën atë nga vlerat.

Për më tepër, shqetësimi i ngritur prej propozuesve kërkon një protokoll rregullues dhe një kuadër ligjor shumë të mirë detajuar, cilësi këto që koha e vënë në dispozicion nuk i bën të mundur.

K. PJESËMARRJA E GRAVE

Barazia gjinore në Shqipëri është e sanksionuar dhe e rregulluar nëpërmjet disa mekanizmave, si Kushtetuta e vendit dhe aktet e tjera ligjore, detyrimet ndërkombëtare që rrjedhin prej ratifikimit të Konventave Ndërkombëtare¹⁴⁵ apo detyrimet që rrjedhin prej përpjekjeve për anëtarësim në Bashkimin Europian¹⁴⁶ ndërkohë që aktualisht sanksionohet me ligjin nr. 9970 “Për barazinë gjinore në shoqëri¹⁴⁷. Gjithashtu, partitë politike në Shqipëri kanë të parashikuara në statutet e tyre respektive pjesëmarrjen e grave dhe kuotat përkatëse.

Në datën 5 shkurt 2015, tri deputete të Kuvendit, si përfaqësuese të Aleancës së Grave Deputete, paraqitën projekt-ligjin “**Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë**”, i cili u morr në shqyrtim në vazhdim nga Komisioni i Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë¹⁴⁸ në mbledhjet e tij të datave 11, 16 dhe 24 Mars 2015.

Projektligji u diskutua dhe votua në seancë plenare në Kuvendin e Shqipërisë në datë 2 prill 2015.

Ndryshimet finale të Kodit Zgjedhor përfshijnë dy ndryshime thelbësore: (1) detyrimin e partive politike për të vendosur një në dy emra të njëpasnjëshëm nga secila gjini në listën shumëemërore për kandidatë për këshilltarë bashkiakë (pra 50% e listës duhet të jetë nga secila gjini)¹⁴⁹ dhe (2) refuzimin e listës shumëemërore të partive në rast të mosplotësismit të kuotave gjinore¹⁵⁰.

KVV e konsideron si një arritje shumë të rëndësishme për barazinë gjinore dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë këtë ndryshim ligjor, pavarësisht se kishte shprehur

¹⁴⁵ Shqipëria ka ratifikuar Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAË) më 1993 dhe Protokollin Fakultativ përkatës më 2003.

¹⁴⁶ Harmonizimi i legjisllacionit me Strategjinë e BE për barazinë mes grave dhe burrave, 2010-2015.

¹⁴⁷ Qendra e Publikimeve Zyrtare. Fletorja Zyrtare Nr. 125, 1 Gusht 2008. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2008/PDF-2008/125-2008.pdf.

¹⁴⁸ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (2015). *Raport i Ndërmjetëm Monitorimi I, (10 janar-26 mars 2015)*, fq. 42-44. <http://zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-RaportiNdermjetemMonitorimi-I-ZgjedhjeLokale2015-30Mars2015.pdf>.

¹⁴⁹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012 dhe ligjin nr. 31/2015), Neni 67 “*Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive*”, pika 6: “...Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t’i përkasë së njëjtës gjini. Subjekti paraqitës i listës deklaron vendet, sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përjashtimit, sipas paragrafit të dytë, të pikës 2, të nenit 164, të këtij Kodi”.

¹⁵⁰ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012 dhe ligjin nr. 31/2015), Neni 175 “*Sanksionet në lidhje me barazinë gjinore*”, pika 1: “*Mospërbushja nga ana e subjektit zgjedhor e detyrimeve të parashikuara në pikën 6, të nenit 67, të këtij Kodi, në lidhje me përbërjen e listës, dënohet nga KQZ-ja me gjobë 1 000 000 lekë si dhe sanksionin plotësues, sipas pikës 2 të këtij neni, në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin, dhe me refuzimin e listës së partisë politike të kandidatëve për këshillat bashkiakë, për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor*”.

rezerva¹⁵¹ për një ndryshim kaq thelbësor në një moment kaq pranë ditës së zgjedhjeve duke qenë se krijonte premiset për përjashtimin¹⁵² nga gara të subjekteve elektorale, të cilat mund të mos kishin mundësi të plotësonin kuotën prej 50% vetëm një muaj përpara afatit përfundimtar (2 maj 2015) për dorëzimin e listave shumëëmërore nga partitë në KQZ apo KZAZ.

KVV vlerëson gjithashtu partitë politike të cilat arritën, pavarësisht kohës së shkurtër në dispozicion, të plotësonin listat shumëëmërore me emra nga secila gjini sipas kërkesave të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, madje i nxit ato që këtë përfaqësim ta pasqyrojnë edhe në të gjitha nivelet e pjesëmarrjes dhe të drejtimit në strukturave të brendshme të partive të tyre.

Për sa i përket numrit të kandidatëve për kryetare të bashkive, për të cilat Aleanca e Grave Deputete propozoi vendosjen e kuotës 20% por që nuk u përfshi në variantin final të votuar në Kuvend, gratë vazhdojnë të mbeten në pakicë të theksuar.

Në total, nga kandidatët e regjistruar në KQZ dhe KZAZ për kryetarë bashkie, deri tani ka vetëm 16 gra kandidatë nga 162 kandidatë në total¹⁵³.

Për sa i përket numrit të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë, për të cilat pas ndryshimeve të fundit në Kodin Zgjedhor u vendos detyrimi që një në çdo dy emra të jetë grua, rezulton se nga 36.251 kandidatë për anëtarë të këshillave bashkiakë 17.887 janë gra (pra 49,34%) dhe 18.364 janë burra (pra 50,66%).

Kodi Zgjedhor parashikon kuota gjinore edhe në anëtarësinë e KZAZ-ve të propozuar nga dy partitë politike më të mëdha të shumicës dhe opozitës [respektivisht Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD)], të cilat kanë detyrimin që në tërësinë e propozimeve të tyre 30 % të jenë nga secila gjini.

Ndryshe nga Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2013, ku kuota gjinore u respektua në momentin e konstituimit të KZAZ-ve por që nuk u ruajt në vazhdim pas zëvendësimeve të ndryshme, deri tani, për Zgjedhjet Lokale të 21 Qershorit 2015, kjo kuotë u respektua në momentin e konstituimit të KZAZ-ve në masën 38 % nga PS dhe 37 % nga PD.

Edhe pas ndërrimeve të ndodhura në anëtarësinë e KZAZ-ve, kuotat gjinore nga të dyja partitë vazhdojnë të respektohen¹⁵⁴.

¹⁵¹ Shih Letrën e Hapur “Propozime të KVV lidhur me ndryshimet teknike në Kodin Zgjedhor”, datë 11 Mars 2015 në <http://zgjedhje.al/index.php?idart=84&gj=sh>.

¹⁵² “Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore” i hartuar nga Komisioni i Venecias vlerëson se “Elementët themelore të së drejtës zgjedhore, dhe, në veçanti, të sistemit zgjedhor, përbërjes së komisioneve elektorale, dhe hartimit të kufijve të zonave zgjedhore, nuk duhet të ndryshohen më pak se një vit përpara zgjedhjeve, ose duhet të shkruhen në kushtetutë ose në një dokument ligjor të një niveli më të lartë se legjislacioni i zakonshëm”. Komisioni i Venecias (2002). *Kodi i praktikës së mirë për çështjet zgjedhore*, II. Kushtet për realizimin e këtyre parimeve, 2. Nivelet rregulluese dhe stabiliteti i ligjit zgjedhor, pika b., fq. 10. <http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD%282002%29023rev-e>.

¹⁵³ Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASHE) ka kandiduar 12 gra nga 59 kandidatë në total (Bashkia Klos, Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Gramsh, Bashkia Mat, Bashkia Patos, Bashkia Roskovec, Bashkia Libohovë, Bashkia Pogradec, Bashkia Shkodër, Bashkia Prrenjas, Bashkia Sarandë dhe Bashkia Ura Vajgurore).

Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet (APPD) ka kandiduar 3 gra nga 61 kandidatë në total (Bashkia Durrës, Bashkia Himarë dhe Bashkia Shkodër).

Ndërkohë vetëm është regjistruar vetëm 1 kandidatë e propozuar nga zgjedhësit, e cila kandidon për Bashkinë Selenicë, Qarku Vlorë.

Lidhur me përfaqësimin gjinor të anëtarësisë në KZAZ të dy partive të tjera parlamentare [Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI) dhe Partisë Republikane (PR), të cilat kanë respektivisht nga një anëtar në çdo KZAZ], Kodi Zgjedhor nuk parashikon asnjë detyrim. Ky përfaqësim deri në periudhën që mbulon ky raport është në masën 11 % për LSI dhe 11 % për PR-në¹⁵⁵.

L. VËZHguesIT DHE E DREJTA PËR INFORMIM

Vëzhgimi i procesit zgjedhor nga grupime qytetarësh dhe organizata jo-politike ka luajtur një rol jo pak të rëndësishëm në përmirësimin e standardeve dhe cilësisë së proceseve zgjedhore në Shqipëri, përkrah rolit të vëzhguesve nga organizma apo institucione ndërkombëtare.

Neni 6 i Kodit Zgjedhor¹⁵⁶ parashikon dhe sanksionon vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendorë dhe ndërkombëtarë, vëzhgues të partive politike si dhe kandidatëve të paraqitur nga një grup zgjedhësish.

Në frymën e rritjes së transparencës së funksionimit të institucioneve publike, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në Shtator të vitit të shkuar Ligjin për të Drejtën e Informimit, i cili sjell një përmirësim të ndjeshëm në krahasim me çka parashikonte ligji i mëparshëm, duke rregulluar mënyrat elektronike për marrjen e informacionit nga institucionet publike¹⁵⁷.

E drejta për informim e vëzhguesve

Në frymë me përmirësimin e aksesit të qytetarëve mbi informacionin zyrtar dhe të rritjes së transparencës së institucioneve publike, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka organizuar një sërë tryezash dhe trajnimesh mbi edukimin e zgjedhësve në të cilat është vënë në dukje veç të tjerash edhe roli dhe rëndësia e vëzhguesve jo-partizanë në përmirësimin e proceseve zgjedhore.

¹⁵⁴ Nga 225 anëtarë të propozuar nga PS-ja, 86 janë gra dhe 139 burra, pra kuota gjinore plotësohet në masën 38,2%; Nga 225 anëtarë të propozuar nga PD-ja, 84 janë gra dhe 141 janë burra, pra kuota gjinore është plotësuar në masën 37,3 %;

Pas lirimeve dhe emërimeve të anëtarëve deri në këtë moment numri i anëtareve femra të PS nuk ka ndryshuar, ndërsa PD ka dy femra më tepër (92 nga 90 që ishin në propozimet fillestare).

¹⁵⁵ Në momentin e konstituimit të KZAZ-ve si PR dhe LSI kishin 10 anëtare gra nga 90 në total, pra vetëm 11%.

¹⁵⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. (Ligj Nr.10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr.74/2012]. Neni 6 “E drejta për të caktuar vëzhgues”.

1. Çdo parti politike apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit, i regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor, ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, në KQV dhe për çdo tavolinë në Vendin e Numërimit të Votave pas regjistrimit të kandidatit/kandidatëve për zonën zgjedhore përkatëse ose pasi ka paraqitur listë shumemërore. Në rast se partitë politike paraqiten në zgjedhje si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka vetëm koalicioni. Koalicioni mund të caktojë jo më shumë se tre përfaqësues për koalicion. Kandidatët e partive politike nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues.

2. Organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në zgjedhje. Për më shumë tek: http://www.parlament.al/web/pub/kodi_zgjedhor_i_azhornuar_pdf_web_15174_1.pdf.

¹⁵⁷ Kuvendi i Shqipërisë, Ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. Për më shumë tek: http://www.parlament.al/web/pub/ligj_nr_119_dt_18_9_2014_19327_1.pdf.

Por, pavarësisht kësaj, në praktikë shpesh KQZ është sjellë në kundërshtim me këtë pozicion publik, duke u treguar e ngurtë dhe hezituese në më tepër se një rast ndaj vëzhgimit dhe kërkesave të KVV-së, çka ka kufizuar mundësitë e vëzhgimit dhe ka sjellë boshllëqe apo vështirësi për të gjykuar mbi procesin, si rrjedhojë e informacionit të mangët të paraqitur apo të pamundësisë së marrjes së tij.

KQZ-ja e konsideron rolin e vëzhguesve të kufizuar vetëm në monitorimin e komisioneve të nivelit të dytë e të tretë, si dhe të mbledhjeve publike të saj, duke e konsideruar gjithë pjesën tjetër të procesit administrativ që prodhon infrastrukturën zgjedhore, si një proces i cili është jashtë kompetencave për monitorim të vëzhguesve, ndryshe nga sa parashikon Kodi Zgjedhor dhe dokumentet ndërkombëtarë mbi rolin e vëzhguesve.

KVV i paraqiti KQZ-së kërkesën për akreditimin e vëzhguesve afatgjatë, të cilët kishin për detyrë të monitoronin të gjithë elementët përgatitorë të procesit gjatë periudhës parazgjedhore qysh në 19 dhjetor të vitit të shkuar.

Kësaj kërkesë KQZ-ja, iu përgjigj se: “KQZ ka të drejtën për akreditimin e vëzhguesve për vëzhgimin e zgjedhjeve pranë komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë.

Duke qenë se KZAZ-të dhe KQV-të nuk janë krijuar akoma, kërkesa juaj do të shqyrtohet në një kohë të mëvonshme. Ndërkohë përse i përket mbledhjeve të KQZ-së ato janë përherë publike. ...”¹⁵⁸.

Ky qëndrim i KQZ-së bie ndesh me pikën 1 të Nenit 7 të Kodi Zgjedhor ku shprehimisht thuhet: “Gjatë kryerjes së detyrave të tyre [vëzhguesit kanë të drejtë]: ...të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor”¹⁵⁹.

Por edhe në rastin se do të marrim apriori të mirëqenë gjykimin e KQZ-së se vëzhguesit mund të ndjekin vetëm punën e komisioneve të nivelit të dytë (KZAZ-të) dhe të tretë (KQV-të e GNV-të), edhe pse komisionet e niveleve të dyta (KZAZ-të) u ngritën dhe u vunë në funksionim që më datën 14 Prill 2015, kërkesa e akreditimit të KVV, u morr në shqyrtim prej KQZ-së, më datën 19 Maj 2015.

Nga ana tjetër, kërkesave zyrtare të dërguara nga KVV për informacion në lidhje me aspekte shumë të rëndësishme të procesit zgjedhor, të tilla si: (1) informacion mbi caktimin nëpunësve ndërlidhës pranë institucioneve shtetërore të përcaktuara nga ligji si dhe emrat e kontaktet e tyre; (2) informacion¹⁶⁰ mbi propozimet që KQZ-ja i drejtoi Kuvendit të Shqipërisë për ndryshimet në Kodin Zgjedhor; (3) informacion lidhur me listën e organizatave të cilat kishin propozuar kandidatura për Bordin e Monitorimit të Medias (BMM) dhe kandidaturat e paraqitura prej tyre; etj, KQZ i është përgjigjur duke dërguar informacion të paplotë ose të censuruar duke e justifikuar rëndom se emrat e personave apo kontaktet zyrtare të tyre, janë të dhëna personale¹⁶¹.

¹⁵⁸ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, përgjigje zyrtare ndaj kërkesës së KVV për të akredituar vëzhgues në monitorimin e procesit për Zgjedhjet Lokale të 21 qershorit 2015. *Shkresa me Nr1929/1Prot, datë 31.12.2014.*

¹⁵⁹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. (Ligj Nr.10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr.74/2012]. Neni 7, pika 1. http://www.parlament.al/web/pub/kodi_zgjedhor_i_azhornuar_pdf_web_15174_1.pdf.

¹⁶⁰ Për më shumë informacion në lidhje me pikën (1) dhe (2) mund t'i referoheni Raportit I të Ndërmjetëm të Monitorimit të KVV, fq. 45-46, publikuar më 30 Mars 2015, tek: <http://zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-RaportiNdermjetemMonitorimi-I-ZgjedhjeLokale2015-30Mars2015.pdf>

¹⁶¹ Lidhur me kërkesën (1) informacion mbi caktimin nëpunësve ndërlidhës pranë institucioneve shtetërore të përcaktuara nga ligji si dhe emrat e kontaktet e tyre, KQZ-ja nuk dërgoi kontaktet e nëpunësve ndërlidhës, duke pretenduar se ato janë të dhëna personale, pavarësisht se kontaktet që ata i kanë çuar KQZ-së, sipas ligjit, janë kontaktet zyrtare të personave zyrtarë të ngarkuar nga titullari i institucionit si personat

Justifikimi i KQZ-së duke e bazuar refuzimin e kërkesës së tyre tek citimi i Nenit 10 të “Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili ka të bëjë me përpunimin e të dhënave për qëllime historike, shkencore ose statistikore¹⁶², tregon një mungesë të të kuptuarit të ligjit dhe të misionit të vëzhguesve, duke qenë se qëllimi i vëzhgimit të procesit zgjedhor nuk është historik, shkencor apo statistikor, por qëllimi i monitorimit synon rritjen e transparencës dhe llogaridhënies¹⁶³ si dhe përmirësimin e tij nëpërmjet rekomandimeve konkrete.

Citimi i neneve në vijim, pa asnjë referencë konkrete është totalisht i paqartë duke qenë se nenet në vijim rregullojnë aspekte shumë të ndryshme.

Mbrojtja e të dhënave personale është një parim i rëndësishëm i së drejtës dhe meriton përkushtimin maksimal të gjithë operatorëve publikë dhe privatë që i kanë pjesë të punës së tyre këto të dhëna.

Gjithsesi, qëndrimi i KQZ-së nuk qëndron brenda kësaj fryme, sepse më së paku ka zgjedhur bazën ligjore të pasaktë ku referohet. Neni 10 i “Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale”, në të tre artikujt e tij, jo vetëm nuk e kufizon por i lë shteg kërkesës së paraqitur nga Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë.

Edhe nëse argumentojmë në një qasje me drejtim të kundërt situata mbetet e njëjtë. Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë e mbështeste kërkesën e tij për informacion në nenin 3 të ligjit mbi të drejtën e informimit i cili për cakton se: “Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet.

Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.”

Në logjikën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pyetja që ngrihet është se a përbën ligji për mbrojtjen e të dhënave një parashikim ndryshe siç u citua më lart?

Në gjykimin e KVV-së dhe në atë çfarë arsyeja e thjeshtë thotë, emri, mbiemri dhe kontakti administrativ i një zyrtari nuk përbëjnë sasi të dhënash konfidenciale. Në *in extremis* kjo logjikë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të shprehej se “nuk do publikojmë emrat e anëtarëve të komisionit se përbëjnë konfidencialitet”.

përgjegjës në raport me kërkesat dhe nevojat që mund të ketë KQZ-ja si dhe lidhur me çdo çështje të brendshme institucionale i cili afekton procesin zgjedhor.

Lidhur me kërkesën (3) informacion lidhur me listën e organizatave të cilat kishin propozuar kandidatura për BMM dhe kandidaturat e paraqitura prej tyre, përgjigja zyrtare e KQZ, me Nr. 2578/1 Prot. dërguar KVV-së në datë 18.04.2015 përmbante bashkëlidhur shkresat e dërguara nga organizatat që operonin në fushën e mediave ndërkohë që hapësira ku ishin shkruar këto emra ishin fshirë.

Sipas KQZ-së: “referuar gjermës “a”, pika 1 dhe pika 6 e nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014, “për të drejtën e Informimit”, si dhe nenit 10 e vijues të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, në këto shkresa emrat e propozuar janë bërë të palexueshëm, dhe CV e tyre nuk u janë vënë në dispozicion për arsye se përmbajnë të dhëna personale dhe KQZ nuk është e autorizuar për përdorimin e tyre”.

¹⁶² Ligji Nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Neni 10 “Përpunimi për qëllime historike, shkencore ose statistikore”, http://www.inovacioni.gov.al/files/pages_files/ligji_nr_9887_date_10_03_2008_i_ndryshuar_me_nr_48_2012_per_mbrojtjen_.pdf.

¹⁶³ Për më tepër, pika 2 e Nenit 10 parashikon se “Transmetimi i të dhënave sensitive për kërkimet shkencore bëhet vetëm kur ekziston një interes i rëndësishëm publik. Të dhënat personale përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin”. Pavarësisht se emrat e personave që kandidojnë për një pozicion publik nuk mundet të konsiderohen si e dhënë sensitive, nga ana tjetër arsyetimi i KQZ lë shteg për interpretim se roli i vëzhguesve në procesin zgjedhor nuk konsiderohet me interes të rëndësishëm publik.

Pajisja e vëzhguesve me materialet paraprake të mbledhjeve dhe vendimet e KQZ-së
Një aspekt shumë i rëndësishëm i transparencës së punës së KQZ-së dhe veçanërisht lidhur me zhvillimin e mbledhjeve të saj është publikimi në faqen e internetit i materialeve paraprake që do të shqyrtohen në mbledhje¹⁶⁴ dhe më pas publikimi brenda 24 orëve i vendimeve të zbardhura¹⁶⁵ prej KQZ-së.

Ky proces jo gjithmonë ka marrë vëmendjen e duhur nga administrata, justifikuar kjo edhe me ngarkesën e madhe të punës, duke bërë që materialet mos të ishin të plota apo të mungonin fare, por pas ndërhyrjeve dhe kërkesave të vazhdueshme të KVV-së, ky proces është përmirësuar ndjeshëm.

Gjithsesi, pamundësia e pasjes së materialeve paraprake të mbledhjes ka dëmtuar jo pak procesin e monitorimit të mbledhjeve të KQZ nga vëzhguesit e KVV-së.

Gjatë mbledhjeve, anëtarët e KQZ-së si dhe përfaqësuesit e partive kanë në dispozicion këto materiale dhe diskutojnë duke iu referuar atyre, çka e bën në shumë raste pothuajse të pamundur të kuptuarin e thelbit të çështjes që po diskutohet në mungesë të materialit referues.

KVV në datën 20.04.2015 nisi një kërkesë zyrtare KQZ-së ku përveç materialeve paraprake të projekt-akteve të marra në shqyrtim në mbledhjen e datës 07.04.2015, kërkoi edhe regjistrimin audio ose transkriptimin e kësaj mbledhje.

KQZ iu përgjigj KVV-së duke i vënë në dispozicion materialet paraprake të projekt-akteve të shqyrtuar atë mbledhje, përveç materialeve paraprake të Vendimit nr. 88 “Për miratimin e modeleve të kandidimit që do të përdoren në Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015”, duke e justifikuar¹⁶⁶ se ky vendim është në proces ankimimi në Kolegjin Zgjedhor dhe nuk mund të jepet deri në përfundim të tij¹⁶⁷. Ndërkohë lidhur me kërkesën për regjistrimin audio apo transkriptimin e mbledhjes KQZ-ja nuk shprehet fare.

Më datën 24.04.2015, KVV i kërkoi KQZ-së vënien në dispozicion të materialeve paraprake të nëntë mbledhjeve¹⁶⁸ të KQZ-së, pasi ato nuk ishin publikuar paraprakisht në faqen e internetit dhe vëzhguesit e KVV-së në sallën e mbledhjeve nuk ishin pajisur me kopje të tyre.

¹⁶⁴ Neni 19, pika 2 e Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, miratuar me Vendimin nr.95, datë 08.04.2015 të KQZ-së: “2. Në çdo rast së bashku me njoftimin për mbledhjen, në faqen e KQZ-së në internet, publikohen edhe materialet e mbledhjes”.

¹⁶⁵ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. (Ligj Nr.10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr.74/2012]. Neni 24, pika “3. Çdo vendim i KQZ-së zbardhet brenda 24 orëve nga marrja e tij. Jo më pak se dy ekzemplarë origjinalë të vendimit ose, sipas rastit, edhe të udhëzimit të KQZ-së, mbahen në arkivin e KQZ-së. Vendimet publikohen menjëherë në faqen zyrtare të KQZ-së”.

¹⁶⁶ Sipas përgjigjes së KQZ-së me Nr.2939/1Prot, datë 24.04.2015: “Në lidhje me projekt aktin e miratuar me Vendimin Nr. 88, “Për miratimin e modeleve të kandidimit, që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015” dhe dokumentacionin shoqërues të tij, referuar paragrafi dh) i nenit 12, të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke qene se ky vendim është në proces ankimimi në Kolegjin Zgjedhor, dhe dhënia e informacionit mund të shkaktojë një dëm të qartë në barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e tij, nuk mund t’ju jepet deri në përfundimin e procesit gjyqësor”.

¹⁶⁷ Megjithëse ankimimi në Kolegjin Zgjedhor i Vendimit nr. 88 ka përfunduar që më datën 24.04.2015, deri në datën që mbulon ky raport, KQZ-ja nuk i ka dërguar KVV-së materialet paraprake të këtij vendimi, në përgjigje të kërkesës së bërë.

¹⁶⁸ Kërkesa e KVV me Nr. L1501/11K Prot datë 24.04.2015, regjistruar në KQZ me Nr. 3074.Prot, për pajisjen me dokumentat paraprake të projektakteve të marra në shqyrtim në mbledhjet e datave : 8 Prill 2015, 9 Prill 2015, 13 Prill 2015, 14 Prill 2015, 15 Prill 2015, 16 Prill 2015, 21 Prill 2015, 22 Prill 2015 dhe 23 Prill 2015.

Kësaj kërkesë KQZ-ja iu përgjigj me një shkresë të datës 04.05.2015, në të cilën citohej se duke qenë se materiali është voluminoz ai kërkon kohë në përgatitje, ndaj bazuar në pikën 3 të nenit 16 të Ligjit “Për të drejtën e informimit” materiali do të vihej në dispozicion vetëm përkundrejt një pagese prej 7 lekësh për faqe (A4), ndërkohë që disa ditë më parë në komunikimin e KVV-së me Koordinatorin për Informim të KQZ-së ishte rënë dakord që ky material të vihej në dispozicion në versionin elektronik.

Kërkesës së përsëritur të KVV-së, edhe pas kësaj përgjigje, për t’i patur në mënyrë elektronike këto materiale sikundër ishte rënë dakord me Koordinatorin e Informimit, KQZ-ja iu përgjigj se kjo është e pamundur për shkaqe teknike, mbasi pas shqyrtimit të projekt-akteve në mbledhje dhe miratimit të tyre, materialet paraprake nuk ruhen më elektronikisht në databazën e KQZ-së.

Ky arsyetim nuk qëndron aspak, madje është i kundërligjshëm, pasi Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në nenin 19 pikën 3 të saj përcakton detyrimin se “*Materialet e mbledhjes, ruhen në një bazë elektronike të dhënash, për jo më pak se 12 muaj*”.

Kjo sjellje jo ligjore përforcohet më tej me detyrimin që shpreh Ligji për të Drejtën e Informimit për ta vënë këtë informacion në dispozicion në mënyrë elektronike¹⁶⁹.

Pas akreditimit të KVV-së më datën 19 maj, ka një përmirësim të dukshëm në sjelljen ndaj KVV-së dhe ofrimin e materialeve paraprake për mbledhjet në vazhdim.

Por pavarësisht kësaj, KVV është i mendimit dhe nxit KQZ-në të largohet nga kjo qasje jokoherente, e ngurtë dhe arbitrare në interpretimin e ligjit ndaj vëzhguesve vendorë. KQZ-ja duhet të bëjë më shumë për shmangien e pengesave fiktive, e standardeve të ndryshme në trajtimin e palëve të interesuar për procesin (përfaqësues të partive politike, vëzhgues ndërkombëtarë, vëzhgues vendorë).

Dhënia e informacionit të cunguar jo vetëm nuk ndihmon në transparencën e procesit, por është tregues i një të kuptuari të mangët dhe minimizues ndaj rolit të organizatave vendorë të shoqërisë civile, çka bie ndesh me qëndrimin publik të KQZ-së në vlerësim të rolit të këtyre organizatave.

Vëzhgues të pranishëm në monitorimin e deritanishëm të procesit

Deri në datën që mbulon ky raport pranë KQZ-së janë akredituar 34 vëzhgues afatgjatë të misionit të OSBE/ODIHR (akredituar më datën 18.05.2015), 6 vëzhgues afatgjatë të Institutit Demokratik Amerikan (NDI) (akredituar më datën 19.05.2015), si dhe 17 vëzhgues afatgjatë të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV) (akredituar më datën 18.05.2015).

Pavarësisht akreditimit të vonët, përgatitja e këtij procesi zgjedhor është ndjekur në të gjitha elementët e tij nga KVV, i cili është shprehur deri në këtë periudhë me një “Raport Vlerësimi i Situatës Parazgjedhore” (publikuar datë 14.01.2015), me një “Raporti i Parë i Ndërmjetëm i Monitorimit” (publikuar datë 30 Mars 2015), si dhe me 9 Deklarata e Letra te Hapura lidhur me problematikën që duheshin adresuar apo çështje të caktuara për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

¹⁶⁹ Deri në datën që mbulon ky raport, KQZ-ja nuk i ka dërguar KVV-së asnjë nga materialet paraprake të kërkuara zyrtarisht.

Më datën 15-17 Prill 2015 OSBE/ODIHR zhvilloi një Mision Vlerësimi të Nevojave pas ftesës së Shtetit Shqiptar nëpërmjet Delegacionit të tij të përhershëm pranë OSBE-së në Vjenë.

Pas konkluzioneve të arritura, raporti i publikuar¹⁷⁰ në datën 27 Prill nga ky mision rekomandoi vëzhgimin e procesit zgjedhor të 21 Qershorit 2015 nga Misioni i OSBE/ODIHR me një trupë prej 24 vëzhguesish afatgjatë si dhe 250 vëzhguesish afatshkurtër, pa përfshirë këtu trupën drejtuese të misionit të vëzhgimit.

Misioni i vëzhgimit të OSBE/ODIHR u vendos në Shqipëri më datën 19.05.2015.

Ai drejtohet nga Zonja Audrey Glover nga Mbretëria e Bashkuar.

Misioni i deritanishëm përbëhet nga Trupa Drejtuese¹⁷¹ e tij prej 16 vëzhguesish ekspertë nga 11 shtete pjesëmarrëse si dhe nga Trupa e Vëzhguesve Afatgjatë¹⁷² prej 20 vëzhguesish nga 13 shtete pjesëmarrëse.

Ndërkohë, mbledhjet e KQZ-së duke qenë të hapura dhe të lira për tu ndjekur, janë vëzhguar në sallë në mënyrë të pandërprerë vetëm prej Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë dhe OSBE-së.

Për periudhën që mbulon ky raport, këto mbledhje janë ndjekur në sallë në një numër të kufizuar rastesh edhe nga vëzhgues të tjerë vendas si dhe misioni i BE-së.

¹⁷⁰ Shkarkoni raportin e plotë tek: <http://www.osce.org/odihr/elections/albania/153461?download=true> .

¹⁷¹ Listën e Trupës Drejtuese e gjeni tek: <http://www.osce.org/odihr/elections/albania/157546?download=true>

¹⁷² Listën e Vëzhguesve Afatgjatë e gjeni tek: <http://www.osce.org/odihr/elections/albania/158661?download=true>

M. ANKESA DHE APELIME

Data 22/05/2015¹⁷³, shënon nisjen e periudhës së fushatës zgjedhore për zgjedhjet që do mbahen për këshillat dhe drejtuesit e njësive vendore.

Në atë që legjislacioni shqiptar e parashikon si vit të regjimit elektoral, kjo pjesë përbën momentin e ballafaqimit të alternativave, të aktorëve politike ose të pavarur, për drejtimin e ardhshëm të njësive vendore. Kjo vazhdon deri në ditën e votimit, kur procesi rikthehet të jetë administrativ deri në shpalljen e fituesve. Gjithashtu i shoqëruar nga mundësia e aktivizimit të drejtësisë zgjedhore për pretendimet e lindura nga pjesëmarrësit në garim.

Fushata zgjedhore ka nisur me probleme të pazgjidhura përsa i përket administrimit të zgjedhjeve që pritet të mbahen.

Një afat i rëndësishëm që Kodi Zgjedhor parashikon është ai i regjistrimit të kandidatëve për Kryebashkiakë dhe anëtarë të Këshillave Bashkiakë. Partitë politike, koalicionet e partive politike ose grupet e zgjedhësve do të duhej të kishin depozituar, sipas rregullimit që bën *neni 67* i Kodit Zgjedhor, ose në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ose në Komisionin Zonal të Administrimit Zgjedhor, dokumentacionin për kandidatët e propozuar prej tyre deri në datën 04/05/2015¹⁷⁴.

Procesi i regjistrimit të kandidatëve, i cili meriton të theksohet që është për nga natyra thellësisht formal, në mënyrë artificiale është vendosur në *impasse*, një gjendje ngërçi.

Një *impasse* që i ka vënë në stres tre operatorët kryesorë zgjedhorë; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor dhe Kolegji Zgjedhor.

Kjo ka sjellë 22 ankimime në Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si institucion i një gjykimi administrativ dhe rekurse në Kolegjin Zgjedhor si institucion gjyqësor.

E tërë kjo vendimmarrje e dy operatorëve të sipërpërmendur meriton një analizë të hollësishme në vijimësi.

Në momentin e gjendur, edhe për shkak të mungesës së zbardhjes së vendimeve të marra, do evidentojmë vetëm shqetësimet kryesore.

Këto në funksion të një mbarëvajtje sa më pozitive të procesit elektoral në vazhdim.

a) Vendimmarrja e vonuar e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për modelet e kandidimit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 07.04.2015, bazuar në *nenin 72* të Kodit Zgjedhor¹⁷⁵, me *vendimin numër 88* miratoi 16 modelet e kandidimit (dokumentet për regjistrimin e kandidatëve).

Për t'u kujtuar këtu është distanca më pak se një mujore e këtij vendimi nga afati për regjistrimin e kandidatëve të propozuar.

Ndonëse legjislacioni nuk i vendos shtrengim kohor Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për caktuar modelet e kandidimit, një muaj mbetet objektivisht një periudhë e pamjaftueshme.

b) Ndryshimi pa votim i vendimit numër 88 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Për këtë vendim, Partia Socialdemokrate Shqipërisë (PSD) me datë 18.04.2015 dorëzoi padinë në Kolegjin Zgjedhor.

¹⁷³ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. (Ligj Nr.10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr.74/2012]. *Neni 77*, pika 1 “Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjevedhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve”.

¹⁷⁴ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. (Ligj Nr.10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr.74/2012]. *Neni 67* dhe *Neni 69*.

¹⁷⁵ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. (Ligj Nr.10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr.74/2012]. *Neni 72*, “1. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e këtij Kodi dhe sipas formës së përcaktuar në udhëzimet e KQZ-së.”

Sipas padisë, vendimi i shpallur në faqen elektronike disa ditë pas datës 07.04.2015 nuk ishte identik me atë që u vendos në mbledhjen e anëtarëve të Komisionit Qendror Zgjedhor.

Ndryshimi qëndronte në interpretimin që i bëhej *nenit 68* dhe *nenit 70* të Kodit Zgjedhor. Sipas *vendimit numër 88* kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtoheshin nga detyrimi i mbledhjes së nënshkrimeve nëse ishin deputet, kryebashkiakë ose anëtarë të Këshillave Bashkiakë të njëjësive vendore (bashkive) që do të rikandidonin. Duke i lënë kështu detyrimin e mbledhjes së nënshkrimeve atyre kandidatëve që ishin kryebashkiakë ose anëtarë të Këshillave Bashkiakë të atyre njëjësive vendore (komunave) që me “Reformën Territoriale”¹⁷⁶ u shkrinë.

Një dallim që sipas padisë së Partisë Socialdemokrate Shqipërisë nuk ishte i drejtë, jo në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe jo ai i cili u votua në mbledhjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ajo kërkoi pavlefshmërinë absolute të ‘vendimit të ndryshuar’ dhe lënien në fuqi të vendimit që kjo parti pretendonte se ishte votuar në mbledhjen e datës 07.04.2015.

c) Arsyetimi i gabuar i Kolegjit Zgjedhor për ankimin e Partisë Socialdemokrate Shqipërisë
Kolegji Zgjedhor me *vendimin numër 5* të datës 24.04.2015, me një votim 3-2, i rrëzoi të dy objektet e padisë së Partisë Socialdemokrate Shqipërisë. Ndër të tjera, ky vendim i Kolegjit Zgjedhor cedon rëndë në momentin kryesor të arsyetimit të vendimit të saj. Ajo shprehet si më poshtë:

“... Kolegji Zgjedhor vlerëson se interpretimi i gabuar i ligjit nga organi i administratës publike në pjesën arsyetuese të aktit nuk mund të përbëjë shkak pavlefshmërie absolute të aktit administrativ të nxjerrë prej tij, ndërkohë që ajo ç’ka kërkohet në këtë gjykim është pikërisht konstatimi i një pavlefshmërie të tillë të vendimit objekt gjykimi të KQZ-së. ...” (faqe13)

Së pari, *ratio decidendi*, arsyetimi i përdorur në *vendimin numër 88* është i lidhur ngushtë me vendimin. Kështu nuk mund të vlerësohet se ndonëse arsyetimi pjesërisht është i gabuar, vendimi në fund qëndron i saktë.

Së dyti dhe më e rëndësishmja, të dy objektet e padisë të Partisë Socialdemokrate Shqipërisë në fakt nuk godasin arsyetimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por vetë vendimin. Prandaj argumentimi më i rëndësishëm i Kolegjit Zgjedhor është dy herë i gabuar.

d) Denatyrimi dhe standardi i dyfishtë i Kolegjit Zgjedhor

Nëse kalojmë në *vendimin numër 7*, datë 15.05.2015, po të Kolegjit Zgjedhor, shqetësimi përsa i përket drejtësisë zgjedhore rritet.

Edhe në këtë rast padia është e ngritur prej Partisë Socialdemokrate Shqipërisë dhe ka dy objekte; shpallje pjesërisht i pavlefshëm i *vendimit numër 214*, datë 06/05/2015, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e listës së kandidatëve për Këshillin Bashkiak të Durrësit nga Partia Socialdemokrate Shqipërisë.

Vendimi 214 risjell problematikën e shkaktuar prej *vendimit numër 88* të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në këtë akt, kthehet “për plotësim dokumentacioni” kërkesa për të regjistruar listën e kandidatëve për Këshillin Bashkiak të Durrësit nga Partia Socialdemokrate Shqipërisë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i kërkoi kësaj partie mbledhjen e nënshkrimeve të mbështetësve, ndërsa subjekti politik nuk e kishte parë të nevojshme duke argumentuar se ligji nuk ia kërkonte këtë dokumentacion.

Kolegji Zgjedhor i pranoi të dy objektet e padisë, me një votim 4-1. Një pranim që ngre një pikëpyetje të fortë në tërë veprimtarinë e deri asokohshme dhe në vazhdim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor. Përpos kësaj shqetësimi edhe më i madh ka të bëjë me atë që u përmend më sipër, drejtësia zgjedhore.

Së pari, në *vendimin numër 7* Kolegji Zgjedhor përdor një arsytim prej Gjykatë Kushtetuese.

Jo vetëm sjell në vëmendje disa herë vendime të Gjykatës Kushtetuese, por edhe analizat e saj¹⁷⁷. Më tej shkon duke arsyetuar mbi *Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias* ose në rastin më keq gjejmë referenca bibliografike pa kuptim¹⁷⁸.

Kjo sjellje e Kolegjit Zgjedhor mund të motivohet edhe prej *amputimit* që iu bë Gjykatës Kushtetuese në çështjet zgjedhore prej vetë kësaj të fundit me *vendimin numër 53*, datë 07/05/2013¹⁷⁹.

Më së paku kjo është jo natyrale për Kolegjin Zgjedhor, i konstituuar si një pjesë e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Nëse vullneti i legjislatorit do ishte për të patur një Kolegj Zgjedhor si gjykatë ligji mbase do të duhej të ishte ndërtuar si pjesë e Gjykatës Kushtetuese.

Ndërsa në fakt legjislatori në *nenin 155* të Kodit Zgjedhor e kufizon bazën ligjore të Kolegjit Zgjedhor tek vetë Kodi Zgjedhor dhe Kodi i Procedurave Civile për gjykimin e çështjeve në shkallën e parë¹⁸⁰. Me këtë kufizim mund të kuptohet se cili ka qenë vullneti i legjislatorit në konstituimin e kësaj gjykate.

Së dyti, ajo që është më e rëndësishmja, kur ballafaqon *vendimin numër 5* dhe *numër 7* vërehet një papërputhshmëri e madhe në standarde.

Tek i pari trupa e Kolegjit Zgjedhor pretendon se duhet të jetë skrupuloze në gjykimin e saj brenda objektin të padisë¹⁸¹.

Tek vendimi tjetër aspak i largët është tjetër qëndrim. Ndonëse i kërkohet të gjykojë vetëm mbi *vendimin 214* të Komisionit Qendror Zgjedhor, ajo analizon gjerësisht *vendimin numër 88*, (me të drejtë të dy janë të lidhur ngushtësisht me njëri-tjetrin) e vlerëson atë si pavlefshëm dhe me vendimin që merr përsipër praktikisht e godet atë vendim, por pa e bërë të pavlefshëm ligjërisht.

¹⁷⁷Në faqen 13 të *vendimit numër 7*, datë 15/05/2015, të Kolegjit Zgjedhor. “... Nisur nga analiza e hollësishme dhe konstante e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, lidhur me rregullimin ligjor mbi kufëzimin e partive jo parlamentare dhe atyre që kanë të zgjedhur në organet e qeverisjes vendore, në raport me partitë që kanë mandate në këto organe, Kolegji Zgjedhor vlerëson se detyrimi për mbledhjen e nënshkrimeve parashikuar nga neni 68.2 i Kodit Zgjedhor, duhet interpretuar nën frymën e standarteve kushtetuese të elaboruara si më sipër.”

¹⁷⁸Në faqen 12 të *vendimit numër 7*, datë 15/05/2015, të Kolegjit Zgjedhor, gjejmë këtë referencë në gjuhën gjermane: “*Entscheidungen des bundesverfassungsgerichts. Volume 1, pp. 247-248*”. E përkthyer fraza do të thotë “*Vendime të Gjykatës Kushtetuese, Vëllimi 1, faqe 247-248*”. Se për cilën Gjykatë Kushtetuese bëhet fjalë dhe cili është botimi që i referohet nuk mund të kuptohet.

¹⁷⁹Vendimi Nr. 53, datë 07.05.2013 i Gjykatës Kushtetuese: “*Si konkluzion, Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në argumentet e dhëna më sipër, vlerëson njëzëri se pretendimet e kërkuesve Partia Socialiste dhe Rrok Rroku, lidhur me cënimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë proceseve të zhvilluara në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.*”

¹⁸⁰Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. (Ligj Nr.10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr.74/2012]. Neni 155, “1. Në shqyrtimin gjyqësor të kërkespasive për të gjitha veprimet proceduriale që nuk rregullohen nga ky Kod, Kolegji zbaton dispozitat e Kodit të Proedurës Civile për gjykimin e çështjeve në shkallën e parë.”

¹⁸¹Në faqen 12 të *vendimit numër 5*, datë 24/04/2015, të Kolegjit Zgjedhor. “... Sikundër përcaktohet në *nenin 155/1* të Kodit Zgjedhor të ndryshuar në lidhje me *nenin 6* dhe *28* të Kodit të Proedurës Civile, Kolegji Zgjedhor ka detyrimin të shprehet për gjithçka i kërkohet dhe vetëm për atë që i kërkohet, sikundër dhe Brenda kufijve të padisë.”

III. REKOMANDIME

Për Partitë Politike

Të angazhohen për të respektuar totalisht kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe të legjislacionit në fuqi për të kryer një fushatë elektorale dhe një proces zgjedhor sa më të arrirë në zbatim të standardeve më të mira ndërkombëtare.

Të angazhohen për të respektuar autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe për të ofruar një fushatë sa më të denjë, në funksion dhe në interes të qytetarëve, duke u fokusuar në platforma konkrete zhvillimi të cilat të përfshijnë në radhë të parë angazhimin dhe kontributin e përbashkët të forcave politike shqiptare në shërbim të interesit më të mirë të qytetarëve.

Të zhvillojnë një fushatë zgjedhore të moderuar, jo të kushtueshme dhe me programe konkurruese.

Të sigurojnë që të gjithë kandidatët të cilët mbajnë poste apo janë nëpunës civil dhe kandidojnë për kryetar bashkie apo anëtarë të këshillave bashkiakë të japin dorëheqjen nga postet e tyre ose, së paku, të kërkojnë pezullimin nga detyra që mbajnë.

Qoftë partitë politike, qoftë kandidatët në garë të kufizohen në premtime zgjedhore realiste dhe me rëndësi për komunitetin respektiv duke evituar retorikën e përgjithshme politike, sulmet personale dhe veçanërisht gjuhën e urrejtjes.

Të nxisin kandidatët e tyre për anëtarë të këshillave bashkiakë që të jenë më prezentë në media dhe me qytetarët.

T'u bëjnë thirrje strukturave dhe mbështetësve të tyre për të respektuar rigorozisht dispozitat e parashikuara në nenin 88 të Kodit Zgjedhor mbi *“Ndalimin e përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore”*.

Të kenë parasysh jo vetëm moskryerjen apo mosmbështetjen e elementëve të veprave penale të parashikuara në Kreun X të Kodit Penal *“Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”*, por të denoncojnë pranë KQZ-së apo Prokurorisë çdo formë të shfaqjes së këtyre veprave.

Qoftë partitë politike, qoftë kandidatët në garë të marrin seriozisht në konsideratë shmangien apo përjashtimin nga grupi i mbështetësve të tyre të të gjithë individëve, të cilët shfaqin sjellje apo opinione për ushtrimin e çfarëdolloj forme presioni apo dhune ndaj kundërshtarëve politikë, apo për të imponuar qytetarët në orientimin e votës së tyre.

Të respektojnë afatet ligjore në propozimet dhe emërimin e emrave për anëtarë të komisioneve të qendrave të votimit dhe grupeve të numërimit të votave

Të mos i ndërrojnë anëtarët e KZAZ-ve dhe në rast të ndërrimit të marrin përsipër trajnimin e anëtarëve të zëvendësuar si dhe të zëvendësojnë anëtarët e liruar me anëtarë të të njëjtës gjini në mënyrë që të ruhet balanca gjinore në KZAZ deri në përfundim të procesit.

Të marrin masa që të rritin pjesëmarrjen e grave në aktivitetet elektorale të zhvilluara si dhe të trajtojnë me prioritet gjatë fushatës çështje që kanë lidhje me barazinë gjinore, aftësinë e kufizuar, minoritetet si dhe të grupet e tjera vulnerabël.

Të kujdesen që të respektojnë balancën gjinore edhe në komisionet e qendrave të votimit dhe grupet e numërimit të votave, në frymën e rritjes së pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, pavarësisht se ligji zgjedhor nuk e sanksionon një gjë të tillë.

Pavarësisht përcaktimeve që bëhen në Kodin Zgjedhor lidhur me deklarimin dhe auditimin e financimit të fushatave zgjedhore, partitë të angazhohen për të bërë në mënyrë vullnetare publikimin e donacioneve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore përpara ditës së votimit.

Për Prokurorinë

Prokurori i Përgjithshëm të nxisë dhe udhëzojë prokurorët, që të vlerësojnë me seriozitetin maksimal çdo shfaqje të veprave penale lidhur me zgjedhjet, si dhe të vihen në lëvizje ndaj çdo denoncimi publik që mund të transmetohet në media veçanërisht gjatë fushatës elektorale.

Për Median

Pavarësisht se Kodi Zgjedhor nuk e detyron, mediat të angazhohen që në rast të transmetimit të materialeve të gatshme të ofruara nga shtabet elektorale të kandidatëve apo subjekteve zgjedhore të vendosin një njoftim me titra të dukshme në të cilin publiku të njoftohet se materiali i cili po u ofrohet është një material propagandistik i përgatitur nga stafet elektorale të partive dhe jo nga gazetarët respektivë të medias.

Të respektojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor për pasqyrimin e aktiviteteve elektorale në mënyrë sa më të balancuar si dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë edhe kandidatëve që janë jashtë dy koalicioneve të mëdha.

T'i kushtojnë rëndësi njohjes dhe bërjes publike të kandidatëve për anëtarë të Këshillave Bashkiakë si dhe ideve e platformave të tyre.

T'i kushtojnë rëndësi të veçantë pasqyrimin të fushatës së kandidatëve nga gjinia më pak e përfaqësuar, pra të grave kandidate, qoftë për kryetar bashkie qoftë për anëtare të këshillave bashkiakë.

Për KZAZ-të

Anëtarët e KZAZ-ve të respektojnë orarin zyrtar dhe në rast se janë të punësuar në pozicione publike të kërkojnë pezullimin e përkohshëm nga detyra, në përputhje me ligjin, deri në përfundim të shërbimit të tyre si anëtarë të KZAZ-ve.

Të respektohet ceremonialiteti i mbledhjeve të KZAZ-ve.

Të udhëhiqen gjatë përmbushjes së detyrave të tyre vetëm nga ligji dhe interesi i qytetarëve shqiptarë duke tejkuluar interesat e ngushta partiake.

Për Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa që të gjithë personat që vuajnë dënimin në Institucione e Ekzekutimit të Veprave Penale (IEVP) të cilët janë të papërfshirë në lista t'u krijohe mundësia të ushtrojnë të drejtën e votës. KQZ-ja të detyrojë autoritetet përgjegjëse që ta përmbushin detyrimin ligjor për ushtrimin e së drejtës së votës ndaj shtetasve që vuajnë dënimin në IEVP dhe ta mbikqyrë nga afër këtë proces.

Për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve

Të vazhdojë të ushtrojë autoritetin e tij të plotë në zbatim të detyrimit të ligjit për administrimin dhe mbikqyrjen në mënyrë të plotë të të gjithë aspekteve të procesit zgjedhor.

Të investohet për të monitoruar nga afër zhvillimin e fushatës zgjedhore duke vlerësuar çdo indicie të servitur nga media apo subjekt elektoral pranë KQZ-së lidhur me shkelje përgjatë fushatës zgjedhore.

Të vlerësojë dhe të ndjekë nga afër punën e Bordit të Monitorimit të Medias si dhe të rezultateve të punës monitoruese të tyre duke zbatuar dispozitat që parashikon ligji në rast të shkeljes së parimit të barazisë për subjektet zgjedhore.

Të përpiqet të arsyetojë dhe ketë një vendimmarrje jo partizane, konform ligjit dhe në interes të procesit dhe qytetarëve shqiptarë.

Të sigurojë një proces sa më të arrirë të ankimimeve duke shmangur përdorimin e standardeve të dyfishta.

Të mbikqyrë dhe ndjekë nga afër procesin e dhënies së të drejtës së votës për të dënuarit në IEVP apo institucione të tjera të posaçme.

Të mbikqyrë dhe marrë masa që gjatë procesit të liritimit dhe anëtarëve të KZAZ-ve të propozuar nga partitë politike të ruhet deri në përfundim të procesit balanca gjinore në këto komisione.

Të udhëzojë Komisionet në varësi si dhe të angazhohet edhe vetë për të ofruar të gjitha lehtësitë e nevojshme për vëzhguesit vendas për një transparencë sa më të plotë të procesit.

Për policinë e shtetit

Të jetë sa më profesionale, të evidentojë dhe hetojë çdo rast shkeljeje të ligjit apo që i adresohet si dhe të ruajë pavarësinë dhe një rol totalisht të tërhequr përgjatë gjithë procesit zgjedhor, sikur parashikohet në ligj.

IV. AKSIONI I KOALICIONIT TË VËZHguesVE VENDORË

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV) është një bashkim vullnetar organizatash jo qeveritare dhe jo politike thelbi i aktivitetit të cilave është mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i demokracisë në vend, e veçanërisht vëzhgimi i proceseve zgjedhor – aktivitet të cilin që prej vitit 2005 e kanë kryer nën siglën KVV.

Strategjia e veprimit të KVV bazohet në tre shtylla: pavarësi, paanësi dhe objektivitet.

Pas përfundimit të Zgjedhjeve Parlamentare të 23 Qershorit 2013, KVV ka ndjekur nga afër dhe në vazhdimësi situatën politike në vend, në mënyrë të veçantë përgatitjet për Zgjedhjet e ardhshme Lokale të 21 Qershorit 2015 dhe, nëpërmjet prononcimeve publike, shkresave zyrtare apo takimeve të ndryshme, ka shprehur në vazhdimësi shqetësimet e veta lidhur me zhvillimet të cilat potencialisht mund të ndikojnë standardet e këtij procesi.

Pas publikimit të Raportit të Vlerësimit të Situatës Parazgjedhore në 14 Janar 2015 dhe Raportit të Parë të Ndërmjetëm të Monitorimit, në datën 30 Mars 2015, i cili mbulonte periudhën prej 10 Janarit në 26 Mars 2015, ky është Raporti i Dytë i Ndërmjetëm i Monitorimit. Periudha e mbuluar në këtë raport është prej 27 Marsit në 21 Maj 2015.

V. FJALORTH

AMA	Autoriteti i Medias Audiovizive
BMM	Bordi i Monitorimit të Medias
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
GNV	Grup i Numërimit të Votave
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale
KÇLAPDNJ	Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë
KZAZ	Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJ. B.	Njësi Bashkiake
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PD	Partia Demokratike
PR	Partia Republikane
PS	Partia Socialiste
PSD	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë
QV	Qendër Votimi
QVP	Qendër Votimi e Posaçme
RKGJC	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
VNV	Vend i Numërimit të Votave
ZAZ	Zonë e Administrimit Zgjedhor
ZGJC	Zyrat e Gjendjes Civile

SHTOJCA

**QËNDRIMET PUBLIKE TË KOALICIONIT
PËR ÇËSHTJE TË CAKTUARA TË SHPREHURA NËPËRMJET
DEKLARATAVE DHE LETRAVE TË HAPURA**

Shtojca 1

DEKLARATË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mungesë transparence dhe ndryshime të paligjshme të akteve të miratuara më parë

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë në monitorimin e procesit zgjedhor konsideron si thelbësor dhe vendimtar funksionimin dhe sjelljen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) jo vetëm në respekt total të ligjit, por edhe në përmbushje të detyrimit ligjor si një garant i tij.

KQZ-ja i ka të gjitha mundësitë që me përkushtimin dhe profesionalizmin e trupës së anëtarëve si dhe të administratës së vet, të sigurojë një proces të arrirë pavarësisht disavantazheve dhe presioneve që krijohen nga mjedisi apo konfliktualiteti politik.

Në këtë këndvështrim, Koalicioni ka mbështetur dhe nxitur fort KQZ-në që të përmbushë autoritetin e plotë të dhënë nga ligji në përgatitjen dhe administrimin e procesit zgjedhor, duke siguruar mbi të gjitha transparencë të plotë mbi çdo aspekt të përgatitjes së procesit, përfshirë këtu hartimin, diskutimin, miratimin dhe publikimin e akteve nënligjore që ajo miraton apo të aspekteve të tjera përgatitore që ndërmer, duke mos hezituar në asnjë çast për t'i dhënë informacion të plotë e të shpejtë të gjithë aktorëve të interesuar, në zbatim jo vetëm të detyrimeve të Kodit Zgjedhor, por edhe të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Koalicioni në raportet e publikuara¹⁸² ka vënë në dukje se përpos përmirësimeve të vërejtura, në punën e KQZ-së vazhdojnë të mbeten problematike mospublikimi i menjëhershëm dhe i plotë i akteve të miratuara në faqen zyrtare të KQZ-së në internet, si dhe mosvënia në dispozicion e akteve paraprake që do të shqyrtohen në mbledhje, as nëpërmjet faqes së internetit dhe as dorazi në sallën e mbledhjeve, përveçse përfaqësuesve të përhershëm të forcave politike.

Pikërisht një situatë e tillë mungese transparence dha mundësinë që në opinionin publik të kalojë shpejt dhe pa marrë vëmendjen e duhur, megjithë denoncimin publik të një ditë më parë prej një partie joparlamentare, **një akt i paprecedent i KQZ-së, i ndryshimit të përmbajtjes së një vendimi dhe akteve shoqëruese të tij në mënyrë të jashtëligjshme**, pasi ai ishte miratuar dhe publikuar në faqen e internetit.

Bëhet fjalë për Vendimin nr. 88, datë 07. 04.2015 *“Për miratimin e modeleve të kandidatimit, që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015”*

Koalicioni është shprehur disa herë publikisht si dhe iu drejtua zyrtarisht edhe Kuvendit të Shqipërisë që në amendimet e Kodit Zgjedhor të bëra dy javë më parë, të adresonte edhe saktësimin e së drejtës së të zgjedhurve aktualë të pushtetit vendor, për të kandiduar si të pavarur për organet qeverisëse të bashkive të reja pa qenë nevoja për të mbledhur firma mbështetëse, në mënyrë që kjo barrë interpretimi mos t'i mbetej KQZ-së.

¹⁸² Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë *“Raporti i Ndërmjetëm Monitorimi I”*, fq. 15, publikuar datë 30 Mars 2015. Për më shumë tek: <http://www.zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-RaportiNdermjetemMonitorimi-I-ZgjedhjeLokale2015-30Mars2015.pdf>.

Në mbledhjen e datës 7 Prill 2015, KQZ-ja morri në shqyrtim projekt-vendimin “Për miratimin e modeleve të kandidimit, që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015” dhe pas shumë diskutimesh vendosi të miratojë të drejtën e këtyre të zgjedhurve për të kandiduar¹⁸³ pa qenë e nevojshme mbledhja e firmave të votuesve mbështetës, sikundër parashikohet për kandidatët e pavarur që aktualisht nuk kanë mandat si të zgjedhur të pushtetit vendor në bashki apo komunë.

Pas publikimit në faqen zyrtare të KQZ-së në internet në datën 8 prill 2015, **më datën 14 prill në mënyrë abuzive, totalisht të paligjshme dhe të paprecedentë, në faqen zyrtare të KQZ-së bëhen ndryshime në përmbajtjen e vendimit**, si dhe preken 6 nga 15 modelet shoqëruese të këtij vendimi.

Në tekstin e vendimit të miratuar¹⁸⁴ fjalja: “Përjashtohen nga detyrimi i mësipërm kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, nëse janë kryetar bashkie ose komune, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse (sipas ligjit për ndarjen territoriale, do të përfshihen ish komunat dhe bashkitë që tashmë janë njësi administrative përbërëse të bashkisë për të cilën do të kandidohet) ose deputet”, zëvendësohet me fjalinë¹⁸⁵: “Përjashtohen nga detyrimi i mësipërm kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, nëse janë kryetar bashkie, anëtarë të këshillit të bashkisë përkatëse ose deputet”, duke i hequr në këtë mënyrë të zgjedhurve aktualë të drejtën e kandidimit si të pavarur për organet qeverisëse të bashkive të reja pa detyrimin për të mbledhur firma mbështetëse, në kundërshtim me atë çka u siguron Ligji në gërmë dhe në frymë, të drejtë që edhe vetë KQZ-ja e miratoi në mbledhjen e datës 7 prill 2015.

Neni 24 i Kodit Zgjedhor “Vendimmarrja në KQZ”, në pikën 3 të tij përcakton se: “Çdo vendim i KQZ-së zbardhet brenda 24 orëve nga marrja e tij. Jo më pak se dy ekzemplarë origjinalë të vendimit ose, sipas rastit, edhe të udhëzimit të KQZ-së, mbahen në arkivin e KQZ-së. Vendimet publikohen menjëherë në faqen zyrtare të KQZ-së”.

Akti i ndryshimit arbitrar të përmbajtjes së vendimit të publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në internet, pa u rimarrë në shqyrtim dhe pa u miratuar prej saj në seancë plenare, referuar edhe nenit 24/3, nuk mund të konsiderohet si një “gabim teknik”, por është pasqyrim i akteve të ndryshuara edhe në arkivin e KQZ-së, **çka rëndon më tej situatën dhe kompromenton jo vetëm anëtarët e KQZ-së, por edhe administratën e saj dhe në veçanti pozitën e dy Krerëve të KQZ-së si dhe të Sekretarit të Përgjithshëm**, i cili është përgjegjës për publikimin e akteve të KQZ-së (neni 25, pika 4/b e Kodit Zgjedhor).

Koalicioni duke e konsideruar këtë rast si një precedent mjaft të rrezikshëm për ecurinë në vazhdimësi të procesit zgjedhor si dhe të praktikës institucionale të KQZ-së, i kërkon

¹⁸³ Shih diskutimet e bëra gjatë kësaj séance tek artikulli i publikuar në gazetën “Panorama” datë 8 Prill 2015 “Kandidimi pa firma, Lleshi bashkon votën me te majtën” tek: <http://www.panorama.com.al/kandidimi-pa-firma-lleshi-bashkon-voten-me-te-majten>, si dhe tek artikulli i publikuar në gazetën “Shqiptarja.com” të datës 8 Prill 2015 “Kryekomunarët “rrugë” të lirë për të tentuar bashkitë, debate në KQZ” tek: <http://shqiptarja.com/politike/2732/kryekomunarret-rruge-te-lire-per-te-tentuar-bashkite-debate-ne-kqz-283976.html>.

¹⁸⁴ Për më shumë shih kopjen e “fshehur” të versionit origjinal të miratuar të vendimit tek: http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:Ek2iet8C7O0J:www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%25202013/Legjislacioni_2015/VENDIME_2015/VENDIM_88/VENDIM_88.docx+%&cd=2&hl=sq&ct=clnk

¹⁸⁵ Për më shumë shih versionin e ndryshuar të vendimit tek: www2.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/Legjislacioni_2015/VENDIME_2015/VENDIM_88/Vendim_88.docx.

urgjentisht secilit prej anëtarëve të trupës së KQZ-së të shprehë publikisht qëndrimin e tij lidhur me këtë çështje.

KQZ duhet të marrë hapat e duhur sa më parë dhe të rikthejë ligjshmërinë në këtë çështje.

KQZ duhet të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar transparencë maksimale në punën e saj sikundër kërkohet nga ligji, duke ofruar paraprakisht informacion të plotë mbi çdo akt apo hap përgatitor që do të ndërmarrë për procesin zgjedhor, duke publikuar të gjitha materialet në internet dhe duke bërë funksionale shkarkimin e tyre; duke rregulluar cilësinë e transmetimit “live”, veçanërisht të audios, gjatë seancave të mbledhjeve; duke vënë rregull gjatë zhvillimit të seancave si dhe duke shmangur diskutimet pa mikrofon çka e bëjnë transmetimin “live” në internet si dhe regjistrimin elektronik të seancave të pavlefshëm.

Gjithashtu, Koalicioni i kërkon Kuvendit të Shqipërisë, Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavaruara e veçanërisht Komisionit Parlamentar të Ligjeve të marrin seriozisht në shqyrtim rastin dhe të ushtrojnë presionin e duhur pranë KQZ-së me synim parandalimin e tentativave të tilla në të ardhmen të cilat minojnë hapur konceptin e shtetit ligjor dhe të së drejtës, që qytetarët shqiptarë po rreken prej 25 vitesh të ndërtojnë.

Tiranë, më 16 Prill 2015

Shtojca 2

DEKLARATË

Realizimi i standarteve për ecurinë e procesit zgjedhor në periudhën e mbetur deri ditën e zgjedhjeve, kërkon kontributin e të gjithë aktorëve institucionalë si edhe të vetë subjekteve elektorale

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë në vijimësi të misionit të tij për monitorimin e procesit elektoral të 21 Qershorit,

si një grupim organizatash aktive në fushën e ndërtimit të demokracisë, ndërtimit të shtetit ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut,

duke synuar në rradhë të parë dhënien e kontributit për mbështetjen e ecurisë së procesit zgjedhor dhe për arritjen e standarteve më të mira të mundshme për periudhën dhe proceset e mbetura deri në ditën e zgjedhjeve,

shpreh disa konsiderata të tij lidhur me disa aspekte që duhen patur në vëmendje prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si edhe prej aktorëve politikë që konkurojnë apo prej aktorëve të tjerë të përfshirë në realizimin e procesit zgjedhor.

1. Fushata elektorale

Data 4 maj 2015 ishte afati i fundit¹⁸⁶ për regjistrimin e kandidatëve që do të konkurojnë për organet e reja qeverisëse të 61 bashkive.

Depozitimi i kërkesave për regjistrim i kandidatëve të mbështetur prej formacioneve politike apo grupe zgjedhësish, i konsideron tashmë këta kandidatë si “kandidatë zyrtarë” përsa i përket angazhimit të tyre politik, ndërkohë që finalizimi i zyrtarizimit të tyre do të bëhet pas vendimit të marë prej Komisioneve Zgjedhore (KQZ-ja apo KZAZ-të), nëse ato plotësojnë kushtet e parashikuara nga ligji zgjedhor për të qenë kandidatë për organet e qeverisjes vendore.

KVV në disa prononcime të tij ka dënuar fillimin e hershëm të fushatës nga disa kandidatë të dy koalicioneve, atij të mazhorancës "Aleanca për Shqipërinë Europiane" dhe atij të opozitës "Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet".

Pavarësisht se kandidatët nuk ishin ende të zyrtarizuar, fushata e bërë prej tyre ishte e paligjshme jo vetëm për faktin e zhvillimit të parakohshëm të saj, por edhe të elementëve të tjerë (si mbështetja prej zyrtarëve të lartë të qeverisë, të bashkive apo edhe të deputetëve të kuvendit; transmetimi i tyre në disa media në mënyrë të plotë dhe “live” nëpërmjet përdorimit të regjive televizive si dhe logjistika dhe burimet e përdorura, të cilat ndër të tjera duhen patur parasysh prej auditëve dhe KQZ-së në raportete vjetore financiare që do të paraqesin partitë respektive; etj), elementë këto që në total shkelin hapur dhe rëndë barazinë e garës elektorale.

¹⁸⁶ Kodi Zgjedhor parashikon si datë të fundit për regjistrimin e kandidatëve datën 2 Maj 2015, por meqë data 2 dhe 3 përkojnë ditë pushimi, bazuar në Kodin Zgjedhor dhe në Kodin e Procedurave Administrative, kjo datë shtyhet për datën 4 Maj 2015.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë **përgëzon dhe mbështet fort Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me deklarin e bërë publik dje se KQZ angazhohet të ushtrojë në mënyrë të plotë kompetencat që i jep ligji, duke marrë masa ndaj subjekteve elektorale, nëse ato do të kryejnë fushatë elektorale përpara datës së fillimit zyrtar të saj**, si edhe ndaj mediave nëse ato do të transmetojnë këto fushata përpara datës 22 maj, kur edhe fillon zyrtarisht perioda e fushatës elektorale.

Koalicioni i bën thirrje partive politike të respektojnë rigorozisht afatin e përcaktuar në Kodin Zgjedhor për kryerjen e fushatës elektorale prej datës 22 Maj deri më datën 19 Qershor 2015.

Gjithashtu, iu kërkon që t'iu bëjnë thirrje strukturave dhe mbështetësve të tyre për të respektuar rigorozisht dispozitat e parashikuara në nenin 88 të Kodit Zgjedhor mbi “*Ndalimin e përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore*”¹⁸⁷, si dhe të kenë parasysh jo vetëm moskryerjen apo mosmbështetjen e elementëve të veprave penale të parashikuara në Kreun X të Kodit Penal “*Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve*”¹⁸⁸, por edhe të denoncojnë pranë KQZ-së apo Prokurorisë çdo formë të shfaqjes së këtyre veprave.

Partitë politike, nisur nga detyrimi që përcakton Kodi Zgjedhor¹⁸⁹, Ligji “Për Nëpunësin Civil” si dhe morali politik i një gare të barabartë, **duhet të sigurojnë që të gjithë kandidatët të cilët mbajnë poste apo janë nëpunës civil dhe kandidojnë për kryetar bashkie apo anëtarë të këshillave bashkiakë, të japin dorëheqjen nga postet e tyre ose së paku të kërkojnë pezullimin nga detyra që mbajnë**¹⁹⁰.

Duke vlerësuar vendimin e marrë nga tre Televizionet informative (Ora Neës, Neës 24 dhe ABC Neës), Koalicioni i kërkon opinionit publik dhe veçanërisht mediave të tjera në vend që jo vetëm të respektojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe legjislacionit në tërësi lidhur me pasqyrimin dhe informimin mbi fushatat elektorale por, edhe të mbështesin fort publikisht në punën e tij Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në këtë angazhim jo të lehtë, të marrë për herë të parë gjatë katër proceseve zgjedhore të zhvilluara që prej miratimit në vitin 2008 të Kodit Zgjedhor në fuqi.

Koalicioni vlerëson gjithashtu urdhrin e Kryeministrit nr. 67 datë 4 Maj 2015 “*Për marrjen e masave për zbatimin e ndalimit të vënies në përdorim të subjekteve zgjedhore të mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë publike, për Zgjedhjet e Organeve të Pushtetit Vendor të datës 21 Qershor 2015*”, por nga ana tjetër sjell në vëmendje të ministrave të qeverisë se çdo shfaqje publike në krah të kandidatëve në garë e veçanërisht në takime lidhur me çështje, sektorët e të cilave varen prej ministrive të tyre, përbën

¹⁸⁷ Neni 88 i Kodit Zgjedhor mbi përdorimin e aseteve të luajshme dhe të paluajshme të institucioneve shtetërore. (përdorimi i administratës së institucioneve; i nxënësve të shkollave; i marrjes në punë, i pushimit, liritimit, i lëvizjes dhe transferimit në detyrë në institucionet apo entet publike; etj).

¹⁸⁸ Nenet 325 – 332 të Kodit Penal mbi: Pengimin e subjekteve zgjedhore apo të kandidatëve; Dhënien e shpërblimeve apo premtimeve në këmbim të votës apo të (mos)marrjes pjesë në votime; Detyrimin për të marrë pjesë në takimet apo veprimtaritë politike të kandidatëve apo partive politike; Kanosjen apo dhunimin ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje; Pengimin e zgjedhësit; Shkeljen e së drejtës së zgjedhjes lidhur me përfshirjen ose jo në listat e zgjedhësve; etj.

¹⁸⁹ Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008 “*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*”, Neni 63 “*Subjektet zgjedhore dhe kandidatët*”.

¹⁹⁰ Ligji 152/2016, datë 30.05.2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, Neni 37 “*Të drejtat politike*”, pika: “3. Nëpunësi civil ka të drejtën të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra”.

gjithashtu shkelje të barazisë në garë dhe të lirisë së pjesëmarrjes në veprimtari politike të vartësve të vet.

KVV i tërheq vëmendjen Prokurorit të Përgjithshëm, që të nxisë dhe udhëzojë prokurorët, që të vlerësojnë me seriozitetin maksimal çdo shfaqje të veprave penale lidhur me zgjedhjet, si dhe të vihen në lëvizje ndaj çdo denoncimi publik që mund të transmetohet në media veçanërisht gjatë fushatës elektorale (por jo vetëm atëherë), pasi legjislacioni shqiptar është i mjaftueshëm për të dënuar çdo shfaqje që imponon apo rrezikon vullnetin e zgjedhësve.

2. Incidenti ndaj kandidatës së opozitës në Durrës

Ditën e premte, datë 1 maj 2015 rreth orës 18.30, në kohën kur kandidatja e koalicionit opozitar "Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet" znj. Grida Duma ka qenë duke kryer takime me qytetarët në zonën e Shkozetit, dy të rinj që lëviznin me një makinë me një flamur të PS, janë konfliktuar me një nga shoqëruesit e kandidatës, aktivist i Partisë Demokratike¹⁹¹.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë mori kontaktet e nevojshme për investigimin e këtij rasti, duke kontaktuar ndër të tjera edhe me autoritetet e Komisarariatit të Policisë si dhe të Prokurorisë së Durrësit.

Aktualisht çështja është në hetim prej prokurorisë për veprën penale "Dëmtime të tjera me dashje" të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, ndërkohë që të dy palët i kanë bërë kallzim penal njëri-tjetrit.

KVV dënon me forcë këtë incident dhe nxit organet e drejtësisë që ta hetojnë në mënyrë të plotë dhe ta çojnë deri në fund këtë rast, jo vetëm si një detyrim ligjor, por edhe si një garanci më shumë se organet ligjzbatuese të shtetit nuk do të rrinë duarkryq ndaj incidenteve të tilla që prekin dhe dhunojnë të drejtat më elementare që duhet të ushtrojnë zgjedhësit gjatë një procesi zgjedhor.

Koalicioni nxit prokurorinë që pavarësisht artificave që gjejnë palët për të fajësuar njëri-tjetrin apo anashkaluar drejtësinë, të ushtrojë dhe të përdorë të gjitha mekanizmat e duhur për të zbuluar të vërtetën, për ta hetuar në mënyrë të plotë dhe profesionale këtë incident dhe për të çuar sa më parë fajtorët përpara drejtësisë.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë tërheq vëmendjen e opinionit publik dhe veçanërisht të partive politike, se **incidente të tilla apo raste të tjera të përdorimit të presionit apo dhunës nga çdo individ, grupim apo subjekt elektorale duhet të dënohen prerazi dhe në mënyrë të menjëhershme dhe duhet të denoncohen nga vetë ato përpara organeve të policisë dhe prokurorisë.**

¹⁹¹ Ditën e premte, datë 1 maj 2015 rreth orës 18.30, kandidatja e koalicionit opozitar "Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet" znj. Grida Duma ka qenë duke kryer takime me qytetarët në zonën e Shkozetit. Dy të rinj, përkatësisht Xh.K. dhe J.B. që lëviznin në mënyrë të përsëritur rreth vendtakimit me një makinë "Alfa Romeo" ngjyrë gri më targë AA960IR dhe me një flamur të PS, janë konfliktuar me një nga shoqëruesit e kandidatës, aktivistin e Partisë Demokratike, përkatësisht me të riun E.S. të birin e kryetarit të Partisë Demokratike të Durrësit z. O.S. Konflikti degjeneroi në goditje me grushta dhe me sende të forta, prej të cilave E.S. është detyruar të marrë ndihmën e nevojshme mjekësore pranë Spitalit të Durrësit. Një ditë më pas policia ka shoqëruar dy autorët Xh.K dhe J.B, të cilët pas kryerjes së veprimeve të para hetimore prej policisë janë liruar dhe po hetohen në gjendje të lirë.

Partitë politike dhe kandidatët në garë duhet të marrin seriozisht në konsideratë shmangien apo përjashtimin nga grupi i mbështetësve të tyre të të gjithë individëve, të cilët shfaqin sjellje apo opinione për ushtrimin e çfarëdolloj forme presioni apo dhune ndaj kundërshtarëve politikë, apo për të imponuar qytetarët në orientimin e votës së tyre, çka janë sjellje totalisht të kundraligjshme që afektojnë drejtëpërsëdrejti standardet e zhvillimit të zgjedhjeve për të gjithë qytetarët shqiptarë.

Koalicioni vlerëson reagimin e kandidatit të koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane" z. Vangjush Dako në profilin e tij në Facebook, ku e dënon këtë incident, por nga ana tjetër mendon se nuk është e shëndetshme që në të njëjtin reagim distancimi, të bëhen edhe aludime për fajësimin e kundërshtarëve politikë¹⁹².

Çdo lloj forme dhune e shfaqur duhet thjesht të dënohet me forcë dhe t'u kërkoet autoriteteve kompetente që ta zbardhin dhe që përgjegjësit të marrin dënimin e duhur nga drejtësia, duke shmangur çdo notë politizimi apo akuzë politike, të cilat në asnjë rast nuk ndihmojnë as institucionet dhe as mospërsëritjen e këtyre ngjarjeve.

Lidhur me këtë incident, KVV nxit Partinë Socialiste që të dalë publikisht dhe në mënyrë zyrtare për t'u distancuar nga ky incident duke e dënuar atë, si dhe duke i kërkuar institucioneve përgjegjëse të angazhohen pa asnjë ekuivok në zbardhjen e incidentit dhe çuarjen e përgjegjësve përpara drejtësisë.

Ky mesazh duhet të përqafohet dhe të transmetohet po njëllor nga çdo parti politike në rast të shfaqje të çdo incidenti tjetër, në mënyrë që t'iu bëjnë me dije çdo militanti dhe simpatizanti të vet se incidente të tilla apo çdo veprim i kundraligjshëm nuk mund të mbulohet apo anashkalohet prej organeve të drejtësisë për faktin se përdoren si koperturë simbolet e partive.

3. Procesi i hartimit të Listave të Zgjedhësve

Koalicioni ka ndjekur nga afër procesin e shpalljes dhe publikimit të Ekstraktëve të Përbërësve Zgjedhorë në të gjithë vendin përgjatë gjithë periudhës Janar-Prill 2015, dhe ka shprehur në vazhdimësi konsideratat e tij lidhur me këtë proces.

Koalicioni vlerëson se publikimi i të dhënave zyrtare mbi ecurinë e përgatitjes dhe hartimit të listave, veçanërisht lidhur me numrin e pastrimeve në total apo të lëvizjeve të vendbanimeve, ka qenë i pamjaftueshëm pavarësisht përmirësimit të dukshëm të transparencës dhe bashkëpunimit të ofruar lidhur me këtë proces nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) dhe Ministria e Brendshme (MB).

Relacioni i njërit prej auditëve, përkatësisht i z. Armand Teliti, i shqyrtuar në mbledhjen e KQZ-së datë 04.05.2015, ku evidentoheshin lëvizje të konsiderueshme të banorëve nga njësi të tjera vendore në njësitë përbërëse të Bashkisë së re të Durrësit, si dhe mangësitë dhe dyshimet e krijuara lidhur me rregullsinë e dokumentacionit shoqëruar dhe

¹⁹² Në këtë reagim dënohet dhe bëhet distancim nga incidenti: "*Në emër të Aleancës për Shqipërinë Europiane dhe shtabit elektoral të kandidatit të kësaj aleance në qytetin e Durrësit z. Vangjush Dako, shprehim indinjatën tonë të plotë me incidentin e ndodhur midis disa të rinjve. Ne distancohemi plotësisht nga çdo akt dhune apo çdo gjest që devijon nga filozofia jonë pozitive e fushatës dhe e komunikimit dhe sjelljes elektorale. ...*".

Po në të njëjtin reagim bëhen edhe akuza për kundërshtarin politik: "*...Nëse parti politike përdorin flamujt e fushatave si kamuflazh për veprime të dhunshme e për të akuzuar më pas kundërshtarin, ky nuk është problemi ynë. Ne i dënojmë akte të tilla dhe i bëjmë thirrje PD të mos nxisë dhunën dhe konfrontimet fizike. ...*". Për më shumë shih reagimin e datës 2 Maj 2015 tek: <https://www.facebook.com/vangjushdako.dr?ref=ts&fref=ts>.

procedurave të ndjekura lidhur me këto lëvizje, **përbëjnë një rast flagrant tentative manipulimi i cili duhet të hetohet tashmë në mënyrë të plotë dhe profesionale prej prokurorisë.**

Koalicioni thekson se ky fenomen nuk ndodh për herë të parë, madje duhet thënë se veçanërisht për zgjedhjet vendore janë përdorur skema të tilla manipulimi edhe më parë, **por ky rast është i vetmi që provohet zyrtarisht**, shqyrtohet dhe merret seriozisht në konsideratë prej KQZ-së dhe përcillet për hetime të mëtejshme tek organi i Prokurorisë.

KVV konsideron si shumë të rëndësishme mbështetjen e institucioneve në këtë rast për t'i dhënë fund njëherë e mirë kësaj forme manipulimi **duke nxjerrë përpara drejtësisë në përballje të plotë me ligjin jo vetëm të gjithë zyrtarët përgjegjës, por edhe organizatorët e këtyre skemave manipulative pavarësisht postit apo pozicionit politik që ata mund të kenë.**

KVV përgëzon profesionalizimin dhe ekspertizën e Auditit z. Teliti, si dhe përfaqësuesit e forcave politike në KQZ, e veçanërisht përfaqësuesin e Partisë Socialiste, i cili edhe si ish-funksionar i lartë i Ministrisë së Brendshme, mbështeti pa asnjë rezervë hetimin e plotë tekniko-ligjor të gjetjeve të raportit të auditit dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës.

KVV po ashtu përgëzon vullnetin e shprehur të KQZ-së, në përmbushje të detyrimit që i njej ligji, për t'a shqyrtuar këtë raport dhe për t'ia përcjellë organeve të prokurorisë.

Për kohën e mbetur në dispozicion deri në datën e hartimit të listës finale me datën 11 maj, KVV iu kërkon të dy auditëve të shqyrtojnë me profesionalizëm dhe objektivitet çdo rast të ngjashëm apo të tjera veprime të kundraligjshme që mund të jenë bërë gjatë procesit të hartimit të listave, pavarësisht numrit apo peshës reale që ato mund të kenë, për vendosjen e një standardi të ri për goditjen e çdo forme të mundshme tentative manipulimi në përgatitjen e listave të zgjedhësve.

Gjithashtu, KVV shpreh domosdoshmërinë që partitë politike kryesore të shprehen zyrtarisht dhe të mbështesin punën hetimore të Prokurorisë për të çuar deri në fund hetimin dhe nxjerrjen para drejtësisë të të gjithë personave përgjegjës lidhur me këtë çështje, duke ndëshkuar këdo individ pavarësisht peshës politike, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Krijimi i Bordit të Monitorimit të Medias

Kodi Zgjedhor parashikon që më datën 12 Prill ngrihet Bordi i Monitorimit të Medias (BMM), sipas një procedure që nxit përfshirjen e ekspertëve të medias, të propozuar nga organizata të shoqërisë civile, në një proces shumë të rëndësishëm siç është ai i monitorimit të pasqyrimin të fushatës mediatike prej mediave audio-vizive private dhe shtetërore.

KQZ, ndryshe nga zgjedhjet e shkuara parlamentare, nëpërmjet një procesi transparent kërkoi publikisht depozitimimin e kandidaturave për anëtarë të BMM-së nga organizata të shoqërisë civile që operojnë në fushën e medias deri më datën 25 Mars 2015, sipas afatit të parashikuar në ligj.

Aktualisht pranë KQZ-së ka depozituar brenda afatit kandidaturat¹⁹³ e saj vetëm një organizatë ndërkohë që tre të tjera i kanë depozituar ato jashtë këtij afati (nga të cilat njëra nga organizatat nuk legjitimohet pasi nuk është njoftuar zyrtarisht prej KQZ-së duke qenë se nuk operon në fushën e medias).

Në këto kushte, në mënyrë të paprecedent po shkohet në fillimin zyrtar të fushatës elektorale të 22 Majit pa një Bord Monitorimi të Medias.

Koalicioni e konsideron të pamjaftueshëm, rolin dhe veprimtarinë e KQZ-së në këtë drejtim, ndërkohë që kupton hezitimin e propozimeve nga disa OJF të fushës, për shkak të mospasjes së besimit në një proces transparent, të drejtë dhe jo-politik, sikundër në fakt është provuar se ka ndodhur në zgjedhjet e mëparshme.

Në këtë këndvështrim, KVV ka dalë me propozime konkrete ndaj KQZ-së për këtë çështje në Raportin e Parë të Ndërmjetëm të Monitorimit të publikuar më datën 30 Mars 2015, ku i ka rekomanduar KQZ-së se pavarësisht se Kodi Zgjedhor e parashikon si të drejtë eskuzive të çdo anëtari të KQZ-së për të përzgjedhur prej kandidaturave të propozuara, pikërisht për të rritur besimin dhe garantuar një funksionim sa më asnjëanës dhe objektiv të BMM-së, anëtarët e KQZ-së duhet: “të angazhohen për të arsyetuar publikisht vendimin e tyre për përzgjedhjen e anëtarëve të BMM-së apo, që procedura të jetë akoma më transparente, anëtarët të përzgjidhen me short pasi kriteret bazë për kualifikimin e tyre si anëtarë të BMM-së të jenë kontrolluar dhe një përzgjedhje paraprake të jetë kryer”.

Koalicioni nxit KQZ-në të gjejë formën e duhur për të rritur numrin e propozimeve dhe garantuar ngritjen e kësaj strukture sa më parë, përpara fillimit të fushatës zgjedhore.

Tiranë, më 6 Maj 2015

¹⁹³ Nga komunikimi zyrtar me KQZ-në kanë depozituar kandidaturat e tyre këto organizata: 1) “BIRN Albania” (3 kandidatë), propozim i protokolluar në KQZ në datën 26 Shkurt 2015; "Rrjeti i Gazetarëve Shqiptar të Politikës" (1 kandidat), propozim i protokolluar në KQZ në datën 1 Prill 2015; "Forumi i Mendimit të Lirë" (1 kandidat), propozim i protokolluar në KQZ në datën 7 Prill 2015, si dhe “Qendra Vullnetare e Emergjencave Civile” (1 kandidat), propozim i protokolluar në KQZ në 15 Prill 2015. Numri i kandidatëve nuk është totalisht i saktë pasi në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga KQZ-ja janë fshirë emrat e kandidatëve të propozuar, duke e justifikuar si mbrojtje e të dhënave personale, çka është një justifikim i pa bazë dhe jo ligjor.

Kontakt:

i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë

Gerta Meta (Shoqata për Kulturë Demokratike) mob. 0692469393
Rajmonda Prifti (Shoqata për Gratë dhe Fëmijët) mob. 0682152667
Premto Gogo (KRIIK Albania) mob. 0682039297

Tel/fax: + 355 4 2245078;
E-mail: info@zgjedhje.al
Website: www.zgjedhje.al;